

Viti XVI. nr. 2



ISSN 0353/7110


ALTERNATIVA

(SHKSH "MIGJENI")

Revistë për kulturë dhe shkencë



LUBJANË, 2006.



+403668

Alternativa - Revistë për kulturë dhe shkencë

ISSN 0353-7710

Këshilli

botues

ALTERNATIVA

Revistë e SH.K.SH. "Migjeni"

për kulturë dhe shkencë

LUBLANË 2006

Viti XVI. Nr. 2



ISSN 0353-7110

Këshilli
botues

Akademik dr. Tom Berisha
Akademik dr. Aleksander Stipčević
dr. Shaban Sinani
dr. Skender H. Skenderi
Arben Xhaferi
Mr. Afrim Krasniqi
dr. Fadil Maloku
dr. Martin Berishaj
dr. Irena Šumi
dr. Hannah Starman
dr. Milazim Krasniqi

Kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës: **dr. Martin Berishaj**

Adresa: SHKSH "Migjeni" Celovška 177, 1000 Ljubljana,

Email: **kdamigjeni@volja.net**

Dizajni i kopertinës: Albert Shaqiri

Redaksia:

Tahir MALIQAJ, Kryetar i SHKSH "MIGJENI"

Xhavit Shaqiri, Sekretar i SHKSH "MIGJENI"

Alma Bejtullahu,

Mr. Zef Ahmetaj

Mr. Albert Ramaj

Valentin Batalaku

Mr. Dorian Jano

Këtë botim e ndihmojë Ministria për kulturë e R. së Sllovenisë
Alternativa izhaja s finančno pomočjo Ministrstva za kulturo RS



PËRMBAJTJA

Sfidë për elitën politike kosovare	3
Një diskurs i punës kolektive dhe objektivave të shoqatës	5
Nga puna e shkollës shqipe	9
Peterseni në ikje, apo Kosova pa Zot Shtëpie.....	10
DRAMCA MENDIMESH	14
Nacionalizmi në kapërcyell	15
Shqiptarët dhe “pavarësia” e tyre nën Mal të Zi	22
Mbi kombin	26
Definimi i kombit	26
Kuptimi filozofik	27
Kuptimi politik	28
Kuptimi ideologjik.....	28
Tiparet	30
Identiteti.. ..	31
Nënsjetulla e diskursit mbi nacionalizmin.....	34
Ese mbi lirinë.	41
Liria në antikë	41
Liria në mesjetë.....	43
Koha e re dhe e sotmja	44
Liritë në aktet juridike nacionale dhe konventat ndërkombëtare....	47
Partitë politike dhe sfidat e sigurisë: rasti shqiptar.....	49
Populli në peshojë	74
Hijet hebreje në Shqipëri	78
Hebrenjtë në Kosovë.....	83
Gjurmët e para në trojet shqiptare.....	83
Sabbatai Zevi dhe dorëshkrime të Thora-s.....	84
Personalitetet hebraike për kulturën shqiptare.....	85
Hebrenjtë në Shqipëri, një rrëfim më vete	86
Në Kosovë, pak më ndryshe.....	87

Alternativa – Revistë për kulturë dhe shkencë

PËRMBATJA

PESHA E FJALËS.....	90
Identiteti evropian i shqiptarëve.....	91
Çeta e profetneve: tjetërqysh.....	108
Fuqia e fjalës së shkruar.....	126
Mikesha ime sllovene.....	131

Dr. Skender H. Skenderi

Arben Xhafa

Stiže për elitën politike kosovare.....

Një diskutim i punës kolektive dhe objektivitetit të shpirtit.....

Nga puna e shkollës shqipe.....

Peterseni në llogje, apo Kosova pa Zot Shpirtit.....

DRAMA MENDIMESH.....

Nacionalizmi në kërkim.....

Shpirtat dhe "pavarsia" e tyre në Mal.....

Mbi kombin.....

Definimi i kombin.....

Kuptimi filozofik.....

Kuptimi politik.....

Kuptimi ideologjik.....

Tipar.....

Identiteti.....

Nënshtralla e diskutimit mbi nacionalizmin.....

Esë mbi linë.....

Lina në antikë.....

Lina në mesjetë.....

Koha e re dhe e sotme.....

Litë në aktet juridike nacionale dhe konventat ndërkombëtare.....

Partitë politike dhe shërbat e sigurisë: rast i shpirtit.....

Populli në peshe.....

Hijet hebore në shqipëri.....

Hebrenjtë në Kosovë.....

Gjumet e para në trojet shqiptare.....

Sabatat Zevi dhe dorëshkrimet e Thors.....

Personalitetet hebore për kulturën shqiptare.....

Hebrenjtë në shqipëri dhe nënshtralla.....

Në Kosovë.....

SFIDË PËR ELITËN POLITIKE KOSOVARE

Shqiptarët në Slloveni kërkojnë hapje të zyrës së Kosovës!

Tahir Maliqaj*

Ballafaqimet e reja me tkurrjen e territorit të Serbisë pas pavarësimit të Malit të Zi, në prag të definimit të statusit përfundimtarë të Kosovës nga një distancë hapësinore, hapin horizonte të cilave elita politike kosovare duhet tu qaset me seriozitet më të madh. Kjo klasë politike shikuar nga distanca e nevojshme e vrojtimit, nga njëra anë, në veprimet e veta shpalon lehtësinë e papërfillshme të qenies, kurse nga ana tjetër bartë me vete kompleksin mental i cili funksionon brenda suazave të asaj vetëdije e cila është e papërputhshme me synime të qarta të shtetformësisë kosovare. Këtë situatë të cilën e jetojmë tani mundë të definojmë si prag i shpresës për kapërcim të verës së fundit pa status të definuar të Kosovës.

Nisur nga fakti se kosovarët në Slloveni ballafaqohen me probleme të ndryshme: të natyrës administrative, qoftë si mospranim të qenies së tyre si shtetas kosovarë nga zyrtaret slloven (sa u përket dokumenteve të udhëtimit si dhe certifikatat e datëlindjeve të cilat, Ministria e Punëve të Brendshme u ka dërguar të gjithë shqiptarëve nga Kosova që kanë shtetësi sllovene, duke reviduar dhe mosrespektuar deri në palcë emrin Kosovë, por duke e zëvendësuar atë me Serbi dhe Mal i Zi!) kurse nga ana tjetër po atyre çka është më e keqja nuk u përfillen kërkesat e tyre nga ana e vetë elitës politike kosovare për të çel zyrën e Kosovës pranë qeverisë sllovene (të tilla zyre kishte Mali i Zi para se të bëhet shtet). Kjo zyre do të ndihmonte komunikimin në mes qytetarëve shqiptarë dhe zyrtarëve slloven në një anë, kurse në anën tjetër Kosova do të prezantohej në mënyrë sovranë në hapësirën

* Kryetar i Sh.K.Sh. "Migjeni" në Lublanë

politike sllovene. Arsyetimet se gjoja Kosova nuk ka të drejtë për një gjë të tillë “nuk pinë ujë”!

Kjo zyre pas definimit të statusit të sajë mundë të ngritej në shkallë të ambasadës apo përfaqësisë konzulare diplomatike të Kosovës.

Shoqata Migjeni brenda mundësive të veta, me kërkesa dhe sugjerime, vënë tullë në ngrehinën për shtetin e Kosovës.

Në muajin që kaloj në selinë e shoqatës Migjeni u nënshkrua marrëveshja mbi koordinimin e të gjithë shoqatave dhe bashkësive të shoqatave të bashkësive etnike që jetojnë në Slloveni, me qëllim të përmirësimit të statusit të tyre karshi kushtetutës sllovene. Mbështetja që i behet këtij organi është e madhe, qoftë nga shqiptaret e këtushëm qoftë nga organizatat joqeveritare dhe partitë opozitare. Jemi të vetëdijshëm se për të çuar këtë proces përpara duhet zell i madh, mirëpo, duke u mbështetur në kontratat ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar shteti slloven për avancimin e statusit të pakicave konform normave ndërkombëtare shpresojmë se do t’ia mbërrijmë qëllimit.

Numri i parë i Alternativës u mirëprit nga lexuesit. Jemi të bindur se kjo sofër gjithëshqiptare do të sfidojnë klasën politike kosovare e cila është vënë në ballë të kombit dhe të proceseve politike që rrjedhin në Kosovë dhe troje tjera etnike.

NJË DISKURS I PUNËS KOLEKTIVE DHE OBJEKTIVAVE TË SHOQATËS

Xhavit Shaqiri*

Shoqata »MIGJENI« si shoqatë kulturore dhe organizate jofitimprurëse do të jete edhe më tutje e hapur dhe rezistence në vazhdimësinë e punës në drejtim të realizimit të objektivave vjetore dhe periodike.

Ne zbatim të qëllimit dhe objektivave që i ka vene vetes si dhe ne zbatim të ligjeve e konventave, shoqata rezervon të drejtën e ngritjes dhe menaxhimit të mjeteve të tjera të komunikimit përmes gazetës shkencore »ALTERNATIVA« e cila sponzorohet me ndihmën e Ministrisë së Kulturës së Sllovenisë.

Objekti i shoqate në perspektivë është:

1. Rikthimi i traditës së shkëlqyer në kulturë, gazetari dhe humanizëm.
2. Aftësimi dhe trajnimi i grupeve të ndryshme (muzikore, gazetareve dhe njerëzve të medias, menaxhuesëve të brendshëm dhe të jashtëm në fushën e kulturës, ligjërata në fushën e informatikës, gjuhës dhe letërsisë shqipe, botimi dhe promovimi i teksteve të ndryshme në gjuhën shqipe dhe sllovene, organizimi i seminareve dhe takimeve të ndryshme me personalitete të këtyre fushave, brenda dhe jashtë Sllovenisë.
3. Shkëmbimi i eksperiencave me shoqatat simotra në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Mali i zi, Austri, Kroaci, Gjermani, Zvicër, SHBA etj.
4. Promovimi dhe prezantimi i vlerave me të mira të shqiptareve, komunitetit slloven, me qëllim të shkatërrimit të stereotipit për Shqiptarët, të shkaktuar me vite të tëra nga diplomacia serbo-sllave.
5. Te ndihmoje në procesin e integritit të vlerave kulturore përmes revistës shkencore »ALTERNATIVA« si dhe informimi publik i komunitetit shqiptar në Slloveni.
6. Sensibilizimi i opinionit mbarëpublik për problemet që kalon shoqëria shqiptare në përgjithësi.

* Sekretar i ShKSh "Migjeni" në Lublanë

Publikimi i punës së shoqatës »MIGJENI« përmes revistës Alternativa, seminareve, guidave, takimeve, emisioneve etj. të kësaj natyre.

Edhe më tutje mbetet si sfidë kryesore e shoqatës: "Mbrojtja e vlerave kulturore dhe të drejtave të komunitetit shqiptar të Sllovenisë. Për këtë arsye është formuar edhe kordinacioni me pakicat tjera të ex Jugosllavisë, për rikthimin dhe mbrojtjen e interesave kombëtare në fushën e arsimit, kulturës, traditës dhe barazisë së plotë në fushën e punësimit dhe biznesit. Përfaqësues nga ana e shoqatës në këtë koordinacion është kryetari i shoqatës z. Tahir Maliqaj, z. Aziz Gjelowci dhe z. Nasuf Krasniqi.

Shoqata i siguron të ardhurat e saja nga burimet që i njihen drejtpërdrejtë nga ligji dhe nga statuti, por benë shpenzime vetëm për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë, për të cilin është krijuar, si dhe për drejtimin e mirëmbajtjen e pasurisë së tyre. Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit ose e përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e shoqatës prej personave që janë subjekte të statutit ose të aktit të themelimit, përveç detyrimeve në formën e honorarit, shpërblimeve dhe kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të ose, për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të shoqatës. Shoqata në rast të veçanta (vdekja, sëmurja e rëndë), mund të japë ndihmë financiare anëtarëve të saj, personave të jashtëm ose subjekteve të tjera. Ajo mund të japë ndihmë të tilla edhe nga fonde të dhuruara ose të vena në dispozicion kur donatorët kanë përcaktuar shprehimisht një gjë të tillë.

Organi më i lartë drejtues i shoqatës është përcaktuar për zbatim të përpiktë të statutit dhe ligjeve në fuqi, për menaxhimin e fondit dhe mjeteve financiare që i janë dedikuar nga buxheti i shtetit ku vepron. Për projekte të veçanta, shoqata do të siguron financime të pavarura nga Ministria e kulturës.

Shoqata vepron me anën e organeve të veta të parashikuara në ligj, aktin e krijimit dhe në statut, të cilët shprehin vullnetin e saj. Veprimet juridike të kryera nga organet e shoqatës, brenda kompetencave të veta, quhen si të kryera nga vete shoqata.

Organi drejtues, ka marrë përsipër që përmes një raporti me shkrim të raportojë periodikisht në kryesinë e shoqatës për mbarëvajtjen financiare si dhe realizimin e planit vjetor. Shoqata mbanë përgjegjësi vetëm ndaj anëtarëve të saj dhe Ministrisë së Kulturës.

Te ardhurat e realizuara nga anëtarësia e shoqatës janë përdor vetëm për realizimin e veprimtarive që parashikohen shprehimisht në qëllim dhe objektin e veprimtarisë së parashikuar në statutin e saj. Në klubin e shoqatës nuk është lejuar që të zhvillohet veprimtari fitimprurëse.

Burimet e te ardhurave për shoqatën janë kuotizacionet, fondet dhe donacionet e ofruara nga subjekte private ose publike vendas.

Shoqata i ka shpërnda te ardhurat e saja vetëm për pagesën e borxheve të kryesive të mëparshme dhe për kompensime që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të ngjashme me to, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të shoqatës dhe pjesa tjetër shkon për përmbushjen e qëllimit dhe objektit si dhe në raste të veçanta shkon edhe për ndihma financiare për qëllime emergjente si në rastin e luftës në Kosovë, Maqedoni si dhe për ndihma të tjera humanitare.

Me administrimin e pasurisë së shoqatës merret financieri dhe drejtpërdrejt presidenti i shoqatës i cili me Ligjin e aprovuar të shoqatave është përgjegjës edhe me pasurinë e vet personale. Buxheti i shoqatës është miratuar nga mbledhja e përgjithshme e anëtareve. Në lidhje me këtë asnjë herë nuk kemi pasur konflikte interesash në administrimin e fondeve dhe buxhetit. Për këtë duhet të falënderojmë edhe anëtarët e veshëm z. Nasuf Krasniqin, arkëtar dhe z. Xhafer Krasniqin, nënkryetar i shoqatës.

Kushdo që ka vërejtje për punën dhe menaxhimin e mjeteve buxhetore dhe shkeljen e statutit, mund të lajmërohet me shkrim presidencës e cila nga ana e saj e protokollon atë sipas rregullave të parashikuara në rregulloren e brendshme të funksionimit të shoqatës, ose në adresën elektronike shksh.migjeni@volja.net, ose kdamigjeni@volja.net.

Një të arritur shumë të madhe vlerësojmë “Projektin për bashkimin e shoqatës me shoqata të tjera në asociacionin “Lidhja e shoqatave shqiptare në Slloveni”, ku janë zgjedhur bashkërisht organet ekzekutive të shoqatave dhe është miratuar edhe Statuti i Lidhjes së shoqatave.

Anëtarët e shoqatës gjatë kësaj periudhe raportuese kanë respektuar dhe zbatuar me përpikëri statutin, rregulloren e brendshme dhe aktet e tjera që miratojnë organet drejtuese të shoqatës.

Kanë punuar për ngritjen e tyre të gjithanshme profesionale dhe kanë kontribuar për arritjen e qëllimeve të shoqatës, sidomos grupi i këngëve dhe valleve i udhëhequr nga z. Xhavit Hoxha.

Në kohën fundit është dhënë iniciativa nga ana e disa studentëve shqiptar që të formohet **“Forumi i studentëve dhe intelektualëve shqiptar”**

Forumi "Studentët shqiptar në Slloveni" tenton të bashkojë shqiptaret që kanë interes për veprimtari kulturore dhe edukativo arsimore. Janë të shumte ata shqiptarë që merren aktualisht me aktivitetet të ndryshme (në fusha të ndryshme) e që zotërojnë një potencial kulturor të padiskutueshëm. Do të ishte shumë mire sikur ky potencial të vihej edhe në shërbim të bashkëpunimit me shoqatën kulturore shqiptare "MIGJENI". Grupimi i këtij potenciali shqiptar rreth kësaj shoqate dhe forumit në fjalë, do të ndihmojë në arritjen e suksesit të shqiptarëve që merren me veprimtari kulturore kudo që janë në territorin e Sllovenisë. Ky është fillimisht qëllimi kryesor i forumit "Studentët shqiptar në Slloveni"

Ky forum do t'i shërbejë gjithashtu qëllimit të njohjes të veprimtarëve dhe intelektualëve me origjinë shqiptare me njeri tjetrin. Do të behet e mundur në këtë mënyrë krijimi i një grupi të veprimtarëve shqiptarë i cili do të ndihmojë dhe mbështesë veprimtarët kulturor me origjinë shqiptarë kudo që janë në Slloveni dhe më gjerë.

Në këtë forum diskutohen probleme kulturore dhe problemet studenteske, siç është fjala vjen gjetja e mbështetjes financiare për projekte kulturore e shkencore qofte në Slloveni apo edhe në vende të tjera të botës. Do të diskutohen kriteret për botim në revistën kulturore e shkencore "ALTERNATIVA" kryeredaktor i të cilës është z. dr. Martin Berishaj.

Ju ftojme gjithashtu që të na shkruani dhe të kyçeni në sistemin edukativo arsimor e kulturor të shoqatës "Migjeni".

Adresa elektronike:

shksh.migjeni@volja.net

NGA PUNA E SHKOLLËS SHQIPE

Alma Bejtullahu

Mësimi plotësues në gjuhën shqipe ka vazhduar gjatë tërë këtij viti shkollor dhe po merr fund gjatë qershorit. Gjatë muajve të kaluar nxënësit janë marrë jo vetëm me mësim në shkollë por edhe me aktivitete jashtëshkollore..

Kështu gjatë shkurtit nxënësit e kanë vizituar çfaqjen teatrale për fëmijë »Magjistarja e vogël Hillary shkon në operë«, e cila iu ka pëlqyer shumë dhe e ka zgjuar interesimin e vogëlushëve për çfaqje.

Përveç kësaj nxënësit e kanë vizituar edhe ekspozitën e fotografive nga Kosova në bibliotekën Bežigrad, ku ishin ekspozuar pamjet nga natyra e Kosovës si dhe Sllovenisë. Kështu fëmijët patën rastin të shohin bukuritë e Rugovës, Mirushës dhe viseve tjera të Kosovës.

Mësimi në klasë ka vazhduar për çdo javë. Fundin e vitit shkollor nxënësit e kanë rrumbullakësuar me projektin e gazetës së murit, të cilën e kanë mbushur me punimet e tyre.

Mësimi do të vazhdojë edhe vitin tjetër, me ç'rast presim që mësimi të zgjerohet. I ftojmë të gjithë prindërit e interesuar që të mos harrojnë të lajmërohen në shoqatë. Aty do të mbahet edhe mbledhja e prindërve në fillim të shtatorit, ku do të informohen për orarin e mësimi.

Pënda e huazuar e Alternativës

PETERSENI NË IKJE, APO KOSOVA PA ZOT ËHTËPIE

Dr. Milazim Krasniqi

Motivet e Petersenit nuk kanë qenë që të mbrojnë vërtet korrupsionin i h të korruptuarit. Motivet e tij kanë qenë të ruajë qetësinë në Kosovë, më saktë qetësinë makropolitike, për ta çuar Kosovën drejt statusit final. Peterseni ka dashur ta ruajë qetësinë dhe stabilitetin në Kosovë, duke i marrë me të mirë të gjithë, duke u lënë grupeve të interesit fushat e lira të veprimit, duke kalkuluar me secilin e diçkë i mbyllur sytë për shpërdorimet e ordinere të zyrtarëve me paratë publike.

Njoftimi i tij në mesin të OKS-së, "Përfundimi i misionit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKS-së, se do të largohet nga posti në fund të këtij muaji, në shikim të parë duket i papritur. Largimi i tij në fazën e fillojnë negociatat indirekte ndërmjet Prishtinës e Beogradit për statusin e Kosovës, (janë paralajmëruar për muajin korrik), ia heq Petersenit privilegjin që të jetë kryeadministratori i fundit i Kosovës. Ndërsa, këtë privilegj ai e ka dëshiruar, sepse e ka deklaruar vetë. Poashtu, në mesin e qytetarëve të Kosovës mund të shëgjohen shumë zëra që ai të dëshironin që favorin e të qenit kryeadministratori i fundit i Kosovës, t'i takonte Petersenit. Këtë e ilustron edhe popullariteti i lartë që gëzon Peterseni, i cili në këtë aspekt i ka tejkuluar pararendësit e tij, Bernard Kushnerin, Hans Hakerupin, Mihail Shtajnerin e Hari Holkerin. Bile, deklaratat e ditëve të fundit nga kryeadministratori aktual në favor të pavarësisë së Kosovës, si ajo në kanal televiziv Top Chanel, kanë qenë muzika më e mirë për veshët e shqiptarëve të Kosovës. Me deklaratat e tilla, me siguri që popullariteti i tij ka përjetuar ngritje edhe më të madhe. Por, as kjo alenacë me qytetarët shumicë të Kosovës nuk ka qenë argument i mjaftueshëm që ai të mbetet deri në fund të misionit të UNMIK-ut në Kosovë e të ndajë me ta gëzimet e festës, që pritet në ndodh në fund të këtij viti.

Largimi i tij në këtë fazë ka edhe një shkallë rreziku për vetë misionin civil ndërkombëtar në Kosovë. Meqë ky mision ka filluar të përgatitet për largim nga Kosova, ai gjendet në një situatë mjaft të vështirë: nga njëra anë duhet të kryejë obligimet e mëdha të amdotsimit të vendit

e nga ana tjetër, të bëjë gati plaçkat. Kjo situatë e dyzuar mund të prodhojë konfuzion në radhët e këtij misioni, i cili edhe ashtu ka qenë mjaft konfuz gjatë tërë mandatit të vet Mungesa e autoritetit të Petersenit vetëm sa do ta rritë konfuzionin dhe do ta dobësojë autoritetin e këtij misioni. Zërat kritikë si ai i organizatës “Vetëvendosje” për misionin e UNMIK-ut si të dështuar dhe që duhet të largohet menjëherë nga Kosova, mund të rriten. Nëse ata vërtet do të ishin zëra dominues, mund të sillnin situata konfliktualiteti, gjë që nuk është në favor as të statusit e as të bashkëpunimit të mëtejshëm të Kosovës me komunitetin ndërkombëtar. Deklarata e Petersenit, në kulmin e rebelimit të organizatës “Vetëvendosje” se sjelljet e tyre do t’i dëshironi armiq të pavarësisë së Kosovës, pati efekt paralizues tek qytetarët e Kosovës, të cilët nuk u solidarizuan me aktivistët e keqtrajtuar e të burgosur nga policia. Loja e Petersenit me këtë lloj patriotizmi demagogjik, që fle në veshin e shumicës së shqiptarëve, është rezultat i njohurive të tij tashmë të thella për mentalitetin e shqiptarëve dhe përdorimin efikas të “shtosave” që i gëlltisnin lehtë. Dihet poashtu se Peterseni i ka mbrojtur haptas zyrtarët e korruptuar të UNMIK-ut, përkundër raportit shumë kritik që ka publikuar Agjencia për kontrollin e misioneve të OKB-së. Bile, mbrojta që u ka bërë Peterseni zyrtarëve të korruptuar ndërkombëtarë në ndërmarrje publike, ka kaluar kufijtë e mirësjelljes e lere më të abuzimit me mandatin. Prandaj, misioni civil ndërkombëtar mbetet mjaft i zbuluar në këtë fazë delikate, kur pushteti i tij dobësohet, dhe mund të ketë një përfundim jo të kënaqshëm për të korruptuarit. Nuk është e qartë tash për tash se a janë llogaritur këto aspekte, me astin e marrjes së vendimit për largimin e kryeadministratorit të popullarizuar.

Largimi i Soren Jesen Petersenit do të sjellë hendikep të madh edhe për koalicionin qeverisës. Ky koalicion ka qenë nën mbrojtjen e hapët të Petersenit, jashtë çdo lloj veprimi, i cili fakt i ndikimi i Petersenit ka qenë evident në tërë procesin, që nga marrënia qeverisëse, edhe pse që në fillim ka qenë e ditur se ajo formulë nuk do të prodhonte një qeveri kredibile dhe efikase. Edhe po të mos ishte problemi me Tribunalin e Hagës, Ramush Haradinaj nuk do të mund të illogaritej si një person me kredencialet e duhura profesionale për ta drejtuar një qeveri të Kosovës, në rrethanat aq komplekse të varfërisë në rritje, të mungesës së ligjeve, të korrupsionit në rritje, të izolimit ndërkombëtar e të refuzimit të komunitetit serb për t’u integruar në institucionet e reja

të vendit. Mbrojtja që u ka bërë tërë këtë kohë Peterseni drejtuesve të korruptuar e të paaftë, si në nivele komunale e edhe në atë qendror, mund të hyjë në Librin e Ginisit. Peterseni ka thyer edhe vendimet e asambleve komunale për shkarkimin e kryetarëve të komunave, sikundër ka ndodhur me Gjakovën dhe ka kthyer në detyrë drejtues që janë shkarkuar me votim demokratik.

Motivet e Petersenit me siguri që nuk kanë qenë që të mbrojë vërtet korrupsionin dhe të korruptuarit. Motivet e tij kanë qenë të ruajë qetësinë në Kosovë, më saktë qetësinë makropolitike, për ta çuar Kosovën drejt statusit final. Peterseni ka dashur ta ruajë qetësinë dhe stabilitetin në Kosovë, duke i marrë me të mirë të gjithë, duke u lënë grupeve të interesit fushat e lira të veprimit, duke kalkuluar me secilin e duke i mbyllur sytë para shpërdorimeve ordinere të zyrtarëve me paratë publike. Pra, synimi i tij mund të cilësohet si fisnik dhe prokosovar, por jo edhe rezultati, sepse nën ombrellën e synimeve të tilla fisnike, kanë gjetur mbrojtje të korruptuarit dhe horrat e të gjitha llojeve. Kriminalizimi i administratës tashmë është bërë një plagë kanceroze, e cila e rrezikon të ardhmen e tërë shoqërisë së re të Kosovës.

Të gjitha këto struktura, ndërkombëtare dhe vendore, largimi i Petersenit i lë pa avokatin e fuqishëm dhe të motivuar që t'i mbrojë deri në fund. Prandaj, shkaku i largimit të tij duket se gjendet tjetërkund. Arsyetimi me nevojën që t'i bashkohet familjes, është njerëzor, i ligjshëm në çdo kohë. Por, sakrifica e bërë për dy vjet e gjysmë të qëndrimit të Petersenit në rajon, rrëzime ka mundur të zgjatet edhe për katër-pesë muaj, për të gjetur satisfaksionin e plotë, me përfundimin e mandatit, bashkë me pavarësinë e Kosovës, të propaganduar edhe prej tij. Në fakt, largimi i kryeadministratorit ka kohë që është planifikuar në selinë e OKB-së në Nju Jork dhe në qendrat e vendosjes. Një deklaratë e lëshuar nga zëdhënësi i sekretarit të përgjithshëm i OKB-së, ka elemente kundërthënëse në përmbajtjen e saj. Në fillim të saj thuhet se sekretari Kofi Anan, ndien keqardhje për vendimin e largimit të Petersenit nga detyra e tij. Ndërsa, pak më poshtë në deklaratë thuhet se " ka një numër njerëzish që janë intervistuar për postin e PSSP-së, mirëpo nuk mund të flasim ende për këtë punë. Gjithçka është në tavolinë, të shohim se kush do të zgjidhet". Pra, kështu ka deklaruar zëdhënësi i Kofi Ananit, në ditën kur u bë i njohur vendimi i Petersenit për t'u larguar nga detyra në

Kosovë. Atëherë, shtrohet pyetja: kur janë bërë intervistimet me kandidatët e mundshëm, për ta zënë karrigen e Petersenit? Po atë ditë kur ai shpalli se po largohej, apo më herët? Nëse janë bërë më herët, kjo do të thotë se është ditur më herët nga dita kur u kumtua lajmi, që ai po shkonte. Logjikisht, shkaqet e largimit të tij janë më parë politike, të vendimmarrësve, se sa familjare dhe të vetë Petersenit. A ka pasur ndikim në vendimin për largim të kryeadministratorit Petersen kritika e ashpër e kryeprokurores Karla del Ponte, e cila zbrazi akuza të rënda ndaj Petersenit e ndaj UNMIK-ut, për mungesë vullneti për bashkëpunim? Tash për tash kjo nuk mund të dihet, sepse duhet të pritet raportimi i Petersenit në Këshillin e Sigurimit më 20 qershor. Kryeadministratori ka paralajmëruar se do t'u përgjigjet akuzave të Pontes, por duhet pritur e të shihet se me çfarë argumentesh dhe me çfarë toni do të flasë ai për këtë çështje. Sa i përket procesit negociator, largimi i Petersenit nuk do të ketë ndikime direkte në të, sepse ai është në duart e Ahtisarit dhe të Grupit të Kontaktit. Krejt çka do të mungojë në këtë proces, është retorika qetësuese e Petersenit në drejtim të shqiptarëve. Duke u folur mjaft qartë për pavarësi, ai arriti që t'i qetësojë deri në atë masë sa edhe arrestimin brutal të aktivistëve të "Vetëvendosjes" ta paraqesë si vepër patriotike dhe në interes të pavarësisë së Kosovës.

Nga përvoja është e njohur se shumë nga ne shqiptarët më shumë kemi dëshirë të dëgjojmë fjalë të mira, se sa të shohim vepra të mira. Peterseni e ka ditur këtë fshehtësi dhe ka luajtur me kartën e saj. Por, Peterseni do të shkojë e do të harrohet shpejt. Ajo me të cilën do të jetojmë ne një kohë të gjatë, është trashëgimia që ka lënë në qeverisjen e këtij vendi. Për këtë do ta kujtojmë më së shumti Petersenin.

DRAMCA MENDIMESH

NACIONALIZMI NË KAPËRCYELL

Arben Xhaferi

Qytetarët e Malit të Zi votuan në referendum për pavarësinë e Malit të Zi, ndarjen e tyre nga përqafimi i hekurit i Serbisë. Votat shqiptare ishin vendimtare për arritjen e përqindjes që caktoi Unioni Evropian, si kusht për njohjen e pavarësisë. Sërish në skenën historike u manifestua forca mobilizuese dhe determinuese e nacionalizmit. Nacionalizmi malazias ngadhënjeu mbi atë serb, separatizmi mbi unitarizmin. Shumëkush u gëzua për këtë sukses, në mesin e tyre edhe shqiptarët që këtë fitore e perceptojnë si të tyre. Të gjitha hamendësimet tjera, në klimën e krijuar, duken, të paktën të pahijshme.

Për ta arsyetuar gëzimin, përhapen koncepte gjeostrategjike që pohojnë se çështja serbe paska pësuar edhe një goditje të rëndë, se Serbia paska mbetur pa dalje në det, apo pa dalje në ujëra të ngrohta, siç thonë gjeostrategët, se Serbia paska humbur aleatin e fuqishëm dhe besnik, duke harruar se Mali i Zi asnjëherë nuk do të neqë dorë nga aleanca strategjike me Serbinë dhe se asnjëherë nuk mund të jetë më mike me Shqipërinë, me Kroacinë, ose me Bosnjën sesa me Serbinë. Ajo prapë do të ketë dalje në det, porti i Tivarit prapë do t'i plotësojë kërkesat serbe, marrëdhëniet ushtarake, ekonomike, kulturore do të jenë po aq të ngrohta sa më parë. Dallimet do të shfaqen vetëm në dimension të interpretimit të ngjarjeve historike, si pasojë e nevojës për përforsim të argumenteve për ekzistimin e identitetit të veçantë dhe të lashtë, tashmë të kombit malazias. Malazezët, bashkë me ta edhe shqiptarët do të mësojnë se shteti i parë malazias është formuar në vitin 1013, se ka zgjatur 140 vjet, si dinasti e Voisavjleviqëve dhe se qenia kombëtare malaziase buron nga dokleatët (duklininët siç do të thoshin ata) që ne pandehnim se kishin origjinë shqiptare, ashtu si Balshajt, Kuqët. Palbardhajt (Bijelopavliqi) etj. Një pjesë e historisë sonë do të bëhet e tyre, ashtu si i animë e grekëve, e turqve, e serbëve, e maqedonasve. Shteti kur formohet ka nevojë për famë dhe për vlera, apo jo? Grekët kanë vënë zapt mbi

periudhën e antikës, sllavët mbi periudhën e rjesjetës, turqit për pjesën tjetër, ndërkaq qenia shqiptarë, gjithnjë e më shumë po merr trajtën e një të sëmuri paraplegjik që nuk arrin t'i lëvizë gjymtyrët qafë e teposhtë. Do të fillojmë t'i mësojmë të bëmat e një populli tjetër që arriti të bëhet komb, për veçoritë kulturore, për historinë e lavdishme, për personazhet e tyre historike. Interesat, shqetësimet, dilemat, aspiratat, sukseset e tyre do të bëhen më të rëndësishme se interesat tona. Ne edhe me këtë rast u vëmë në pozitë të dhënies dhe jo të marrjes, të subjektit që ka obligime ndaj tjetrit, por jo edhe të drejta. Ky pozicionim i shqiptarëve imponohet si diçka e domosdoshme, determinuese, pa alternativë. Problemet, zakonisht lindin kur fillojmë t'i kërkojmë disa të drejta për vete. Atëherë, nis procesi i kushtëzimeve, i negociatave të lodhshme me ata ndaj të cilëve treguam dashamirësi të pakushtëzuar në procesin e konstituimit të tyre si komb, në procesin e krijimit të shtetit të tyre kombëtar. Në kohën kur Maqedonia pavarësohej, ne pa kushtëzime e mbështetëm këtë projekt, në negociatat e Ohrit, ata parashtruan një varg kushtëzimesh për kërkesat tona elementare, derisa sot e gjithë kjo marrëveshje ka marrë trajtën e përbuzjes së vlerave shqiptare. Pse ne jemi kaq dashamirës me të tjerët dhe ata aq nopranë me ne? Pse kaq shumë kemi mirëkuptim për nacionalizmin e tyre dhe aq neveri për nacionalizmin tonë, pse kauzat e tyre kombëtare na duken normale dhe jona e diskutueshme, pse i japim rëndësi kaq të mëdha variacioneve të tyre dhe e zhvleftësojmë aq shumë specien tonë? Pse neve na duken më të qytetëruara dhe të obligueshme qëndrimet e moderuara kur kemi të bëjmë me çështjen tonë kombëtare dhe nuk na duken të vjetruara qëndrimet radikale të tjerëve? Pse të gjithëve u duket normale, madje edhe vetë shqiptarëve, që për ta fituar të drejtën për pavarësi të Kosovës, duhet të garantojmë edhe kushte të përshtatshme meteorologjike për serbët, ndërkaq kur bëhet fjalë për ne këto garanci as që përmenden? Për këto çështje komplekse nuk mund të jepen përgjigje të thjeshta, njollosëse, sa për ta shfryrë mllefin, por duhet të bëhen analizë të shkoqitura të nocioneve dhe proceseve shoqërore dhe historike.

Natyra e nacionalizmit shqiptar, pa dyshim është reaktiv dhe jo projektues. Ne reagojmë kundër efekteve të nacionalizmave të tjerë. Në dallim nga shqiptarët, serbët, por jo vetëm ata më se një shekull hartojnë projekte, elaborate të studiuara mirë se si t'i shfarosin

shqiptarët, t'i dëbojnë nga vendlindja, t'ua njollosin imazhin, t'u ngjisin bishta, të nxisin përçarjet e brendshme, t'i korruptojnë përfaqësuesit, prijësit e tyre etj. Ata kanë formuar ekipe të specializuara për realizim të objektivave të tilla. Në këto projekte kanë qenë të inkuadruar edhe "ekspertë" malazias, maqedonas etj. Nga ana tjetër shqiptarët nuk kanë projektuar as elaboratin për mbrojtje dhe lë më atë për ndërhyrje në sferat e interesit të popujve të tjerë.

Në opinion shqiptar dominon bindja se nacionalizmi është diçka e tejkaluar, gjithsesi negative, johumane, jo tolerante, paranojake, neurotike, kriminale, neveritëse. Zakonisht atë e ndërlidhin me manifestimet primitive, degutante, irracionale, me krimet, dhunimet, pastrimet etnike. Si antipod i nacionalizmit imponohet kozmopolitizmi, multikulturalizmi; që vetvetiu perceptohen si vlera të padiskutueshme që përhapin dashurinë, tolerancën në mes të njerëzve. Bashkëjetesa, kohabitacioni është një nocion i ri nga arseri i madh i armëve me të cilin luftohet nacionalizmi shqiptar. Por, të gjitha këto nocione të pëlqyeshme humbin shkëlqimin e vet kur duhet të përkufizohen obligimet dhe të drejtat, standardet e integritetit, e bashkëjetesës. Problemet lindin në planin konkret, kur duhet të përkufizohen modalitetet e bashkëjetesës, apo të integritetit. Shpesh herë këto nocione të buta, në të parë altruiste fshehin qëllime të egra dhe egoiste.

Sistemet e bashkëjetesës, të bashkim-vëlazërisht rëndom janë eufemizma që fshehin tendencën e eksploatimit legal, asimilimit të heshtur, përtharjes sistematike të potencialeve ekonomike, kulturore, krijuese të njërës nga palët bashkëjetuese. Në kontekste të këtilla njëri element i bashkëjetesës është aktiv, veprues, projektues, ndërkaq tjetri pasiv, spektator që duartroket, që gëzohet, që mbështet projektet, të bëmat e tjetrit, në relacionet e këtilla njëri është kërkesëtar dhe tjetri plotësues dëshirash etj.

Te shqiptarët eksiton një bindje që s' lë vend as për hamendje se nacionalizmi qenka një fenomen anakronik dhe antievropian. Megjithatë, ngulm dhe pa kurrfarë dileme përhapet bindja se Evropa, popujt e qytetëruar të Evropës bashkohen, ndërkaq popujt primitivë të Ballkanit ndahen, duke krijuar bantustane të vogla, ekonomikisht të paqëndrueshme. Këtë argument e përdorin popuj që kanë ndërtuar shtetet e tyre nacionale në dëm të popujve të tjerë dhe natyrisht nuk dëshirojnë që të heqin dorë nga interesat hegjemonike. Nëse

analizohet me kujdes historia e popujve evropian do të kuptohet qartë se nacionalizmi është shpikje e mendësisë, kulturës dhe sistemit të vlerave evropiane dhe se nacionalizmi nuk është veti e popujve lindorë. Bie fjala në gjuhën arabe, sipas pohimeve të sociologut zviceran, Urs Altermat nuk ekziston fjala e saktë për kombin(nacionin). Ata përdorin nocione të përafërta si bie fjala “sha’b”(popull), “qawn”(fis), “xhins”(lloji) dhe së fundi “umra”. “Al-umma al muhammadiya” (bashkësia e gjithë myslimanëve), “Al-umma al- arabiya”(bashkësia e folësve të gjuhës arabe). Ata për OKB-në e përdorin një togfjalësh interesant “Al-ummam al-muttahida” (Bashkësitë e bashkuara fetare). Sipas gjuhëtarëve fjalët shpiken kur në mendje qartësohen nocionet. Pra, nocioni i kombit (i nacionit), i kombëtarizimit(i nacionalizmit) është shpikur në laboratorin e qytetërimit perëndimor dhe çuditërisht për këtë fenomen ekziston edhe ekuivalenti shqip “komb”.

Shumë fenomene që shpiken në laboratorët e qytetërimit perëndimor huazohen nga kultura e tjera. Në këtë proces të huazimit ndodhin ndryshime, deformime që nuk janë në përputhje me domethënien bazike të nocioneve, të koncepteve, të teorive, të tendencave historike. Sipas sociologut amerikan Benedikt Anderson, i cili, duke analizuar funksionin kompensues të nacionalizmit në shoqërinë moderne, konstaton se rrënjët e nacionalizmit shfaqen që në shekullin e 16-të, kur shfaqen dilemat rreth bindjeve themelore të njeriut të periudhës së Renesancës lidhur me:

- besueshmërinë e të vërtetave të librave të shenjtë;
- bindjen se hierarkia shoqërore ka prejardhje hyjnore dhe me
- barazvlevshmërinë e kohës kozmike me atë historike.

Humbja e besimit në testamentet e shenjta me siguri ka qenë pasojë e dështimit të misionit të inkuizicionit që përpiqej me dhunë t’i imponojë dogmat fetare dhe t’i kontestojë, t’i shpall si herezi të vërtetat shkencore. Galilelo Galileu (1564-1642), euridit i njohur i periudhës së Renesancës, i cili e mbështeti teorinë heliocentrike të Kopernikut para se ta përfshinin flakët deklaroi me bindje të thellë “Eppur si muove” (Megjithatë po lëviz, duke aluduar në rrotullimin e tokës rreth diellit). Guximi moral dhe intelektual i shkencëtarëve të mëdhenj ishte më i fortë se sa dënimet drastike të rojeve të dogmës fetare që më në fund rezultoi me humbjen e besimit në një sistem,

deri më atëherë të padiskutueshëm të vlerave. Qytetari dyshues evropian i kësaj periudhe e ndjeu veten të pasigurt, të humbur. Deri më atëherë ai ishte i edukuar dhe mësuar që të besojë në prejardhjen hyjnore të superstrukturës, ishte mësuar që ndjenjat fisnike të qenies së tij t'i vë në dispozicion të religjionit, të rendit kishtar, prandaj kishat dhe çdo gjë që kishte të bënte me religjionin kishin bukuri mahnitësi. Besimi në Zot i motivonte ata që ta fisnikërojnë veten dhe shoqërinë kështu që bindjet fetare ishin një kolektor i fuqishëm ku stivoheshin vlerat që e bënin kuptimplote jetën dhe ndërveprimin shoqëror. Humbja, apo dyshimi sado i vogël në besueshmërinë e këtyre parimeve aksiomatike krijoi një destabilizim të thellë në planin individual dhe atë shoqëror. Ky shqetësim me gjasë nxiti evropianin kërkimtar të gjejë zëvendësimin për humbjen e sigurisë, të zbulojë vlerën e re që do ta rikthente ndjenjën e sigurisë së humbur dhe kohezionin shoqëror. Pra, fillet e nacionalizmit në Evropë kanë qenë fisnike dhe sublime. Nacionalizmi ishte ndjenja që e fisnikëronte njeriun, individin e vetmuar i cili filloi t'i investojë virtytet e veta në sistemin e ri të vlerave, nacionalizmi u shndërrua në rrufepritës të vlerave, të ndjenjave fisnike, të mirësisë dhe të arsyeshmërisë njerëzore. Ai e gjeti planin e ri shoqëror, relacionin e ri të afërsisë, të qëllimeve dhe të vlerave të përbashkëta për të cilat ishte i gatshëm edhe të flijohet. Shtetet e para nacionale synonin që të ofronin barazinë e plotë të qytetarit i cili deri më atëherë konsiderohej si pronë e monarkut apo të princërve të ndryshëm. Me sloganin “Liri, barazi, vëllazëri” filloi një fazë e re e barazisë së njerëzve, të paktën brenda një shteti të ri. Pra, nacionalizmi në këto fillime solli standardet sipas të cilave garantohej barazia në mes njerëzve, në mes të vëllezërve. Kjo tendencë barazimtare në kuadër të sistemit perëndimor të vlerave do të përfundoj me standardet që garantojnë të drejtat e njeriut që do të jetë faktor kryesor në humanizimin e formacioneve të ndryshme shoqërore, shkaktar i rrënimit të sistemeve të ndryshme despotike, autoritare anekënd botës.

Nacionalizmi e prodhoi kombin, kombi e prodhoi shtetin kombëtar dhe shteti kombëtar e fiku zjarrin mobilizues, veprues të nacionalizmit. Nëse ky konstatim është i saktë, atëherë mund të shpjegohet për se shqiptarët e Shqipërisë janë më pak “nacionalist” sesa shqiptarët e viseve të cilët kanë qenë nën sundimin e nacionalizmave të tjerë, pse shqiptarët e Shqipërisë ndryshe e

perceptojnë Goran Bregoviqin nga vëllezërit e tyre në Kosovë dhe gjetiu.

Nëse një nacionalizëm dështon, atëherë fillon procesi i akulturimit, i përtharjes, i asimilimit dhe njëherësh i bartjes së besnikërisë, së interesimit të qytetarit në koncepte të tjera komunitariste, duke filluar nga ato ideologjike, fetare e deri te ato sportive. Bie fjala dështimi i nacionalizmit arab, i personifikuar në figurën e presidentit nationalist Gamall Abdel Naserit, apo Sadam Huseinit nxori në shesh lëvizjet fetare që propagojnë idetë komunitariste mbi baza fetare, ummetin islam.

Deformitete të misionit fisnik të nacionalizmit shfaqen edhe në shtetet post komuniste ku nacionalizmi shfaqet si ideologji ekskluziviste që në mënyrë patologjike spikat pikat dalluese në mes të njerëzve dhe jo ato bashkuese. Ky koncept i nacionalizmit nuk është në vijë të traditës evropiane të nacionalizmit që kishte mision kompensues, pas humbjes së sigurisë së dikurshme në vlerat e një formacioni feudal shoqëror.

Nacionalizmi i llojit evropian, pra ai që i nxit njerëzit që virtytet e sublime të qenies së tyre të investojnë në një sistem vlerash që i bashkon individët, krijon barazi në mes tyre, që i jep kuptim jetës së tyre është i domosdoshëm për mbijetesën e shqiptarëve. Ky nacionalizëm i llojit fisnikëruës nuk ka të bëjë fare me urrejtjet llojesh të ndryshme patologjike, ksenofobike, por shërben si frymëzim i vazhdueshëm për të prodhuar vlera të përbashkëta shoqërore, barazinë në mes të njerëzve. Ky lloj nacionalizmi frymëzues, fisnikëruës në shoqëritë më të avancuara perëndimore manifestohet në çdo segment të shoqërisë dhe është standard, kusht pa të cilin nuk mundet të funksionojë shteti. Nacionalizmi i këtillë jo vetëm që forcon kohezionin shoqëror, por edhe parandalon deformitetet e ndryshme siç është korrupsioni, nepotizmi, evazioni fiskal dhe abuzimet e ndryshme të pozitës në shoqëri, nacionalizmi i këtillë e rimëkëmb shpirtin e një kombi, nacionalizmi i llojit të rilindësve tanë.

Këtë apologji për nacionalizmin e shoh të udhës ta përfundoj me një rrëfje të vërtetë nga jeta e një të mërguari shqiptar. Ai ishte martuar me një suedeze dhe kishte tre fëmijë të cilëve u kishte dhënë emra shqiptarë. Një ditë, në vitet '80-ta, djali i tij gjashtë vjeçar, Besimi me rrëmbim hyri në shtëpi duke bërë titur "Papa, papa svenska gurka" (Baba, baba trangull suedez!). Babë e bir këmbenin fjalë që s'i kuptoja

unë, aq më pak euforinë e tyre me një trangull të mbështjellë me celofan ku ishte stampuar flamuri suedez. Kërkova shpjegime prej mikut tim kosovar. Ai me një indiferencë m'u përgjigj: "Hiq tyre, ata gëzohen kur arrijnë të prodhojnë madje edhe perime. Gjithkund e vënë flamurin, madje edhe në brekët e tyre".

Nacionalizmi suedez manifestohet jo vetëm në krijimin e shtetit funksional ku suedezi është i mbrojtur, i sigurt, ku i respektohet integriteti dhe dinjiteti individual, por edhe në këto mesele trangujsh. Shtetet kombëtare formohen që pjesëtari i atij kombi (nacioni) të jetojë sa më mirë. Shtetet kombëtare nuk formohen që pjesëtari i atij kombi të jetojnë keq në të.

Pale si do të përfundojë nacionalizmi malazias?

Po ne ku jemi se?

SHQIPTARËT DHE “PAVARËSIA” E TYRE NËN MAL TË ZI

Dr. Milazim Krasniqi

Qëndrimi i sotëm ndaj Malit të Zi dhe shteteve të tjera fqinje e ndaj shteteve, që janë trashëguese të Fuqive të Mëdha të dikurshme të Kongresit të Berlinit, nuk duhet të ndikohet nga objektivat e porealizuara të Lidhjes së Prizrenit dhe nga dëmi që i janë shkaktuar atëherë çështjes shqiptare. E dyta, për shkak të koniukturave të tashme gjeopolitike, duke përfshirë edhe miqësinë me shtetet e dikurshme agresore, nuk duhet t'i ndërrohet përmbajtja e vërtetë Lidhjes së Prizrenit dhe luftërave shqiptare për shtet nacional.

Në ditët kur në Kosovë dhe në botën shqiptare po bëhen përgatitjet përfundimtare për shënimin e 128 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, Mali i Zi rifitoi pavarësinë e vet, të cilën e kishte fituar para njëqind e njëzet e tetë vjetëve, në Kongresin e Berlinit, edhe në dëm të trojeve shqiptare. Por, shqiptarët e vitit 2006 e ndihmuan rifitimin e pavarësisë së shtetit malazet dhe iu gëzuan kësaj pavarësie. Vetë shqiptarët në Mal të Zi, pasardhësit e atyre shqiptarëve që u gjymtuan nga formimi i shtetit malazet në tokat e tyre, votuan masivisht në favor të pavarësisë. Kuotat më të larta të votimit në favor të pavarësisë u shënuan në Ulqin, në qytetin të cilin e patën amputuar nga trungu shqiptar, pikërisht pretendimet territoriale të shtetit malazet. Një kontingjent jo i vogël shqiptarësh erdhën madje edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës që të jepnin kontributin e tyre për fitoren e referendumit malazet për pavarësi. Edhe shqiptarët në Kosovë, në Shqipëri dhe në botën shqiptare, u deklaruan në favor të pavarësisë malazeze, si një zhvillim pozitiv për të ardhmen e tyre dhe të rajonit. Kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, i nënshkroi referendumin malazet, nga Shkodra dha mesazhin e përshëndetjes së rezultatit pozitiv të referendumit, pra nga qyteti historik shqiptar, i cili qe bërë rrafsh me tokë nga agresioni i Malit të Zi, në rrëmujën e luftërave ballkanike.

Çka do të thotë ky entuziazëm shqiptar me pavarësinë e Malit të Zi, këtij shteti që ka qenë njëri nga shkaktarët e tragjedisë shqiptare të para njëqind e njëzetetë vjetëve, të kohës kur u mbajt Kuvendi i

Lidhjes së Prizrenit (dhe Kongresi i Berlinit.) Poashtu, këtij shteti që ishte ftilluesi i Luftës së Parë Ballkanike dhe i agresionit barbar mbi Shkodrën dhe rrethinat e saj, po edhe i pushtimit të egër të një pjese të Rrafshit të Dukagjinit? A mos është ky entuziazëm i shqiptarëve të sotëm, tregues i një harrese, e cila konsiderohet si tepër e rrënjosur në mendjen e tyre politike? Apo është tregues i shkurtpamësisë së tyre të tashme politike? Apo, i të kuptuarit se për këto njëqind e njëzet e tetë vjet, gjërat kanë ndryshuar në planin gjeopolitik dhe ato kanë sjellë të tjera raporte të tjera vlerësime të shqiptarëve edhe për rikthimin e pavarësisë së Malit të Zi?

Pa i prekur kësaj here dy pandehmat e para, është e qartë se fjala vërtet është për ndryshimin e raporteve gjeopolitike në rajon, që kanë sjellë edhe ndryshimin e qëndrimit të shqiptarëve ndaj Malit të Zi. Në fakt, qëndrimi i shqiptarëve në këtë kontekst ka të bëjë me favorin që pritet të rezultojë nga shpërbërja e ish federatës ndërmjet Serbisë e Malit të Zi, e cila ishte armiqësore dhe me pretendime për ta mbajtur Kosovën të lidhur pas qerres së vet. Bile, edhe në Kartën Kushtetuese e cila parashihte mundësinë e ndarjes së këtyre dy republikave ish jugosllave, është vendosur që kontinuiteti shtetëror i ish federatës Serbi-Mali i Zi t'i mbetet Serbisë, me arsyetimin e vetëm se kjo do t'i ndihmojë asaj që të përpiqet ta mbajë Kosovën brenda atij "kontinuiteti shtetëror". Pra, Mali i Zi nuk konsiderohet aq armiqësor sa Serbia dhe kjo paraqet edhe tharmin e ndryshimit të qëndrimit shqiptar ndaj shkëputjes së Malit të Zi, i cili edhe i shkëputur mban për vete tokat shqiptare të aneksuara në kohën e Lidhjes së Prizrenit, i cila si organizatë politiko-ushtarake, ka luftuar me armë në dorë për t'i mbrojtur ato territore shqiptare, nga pushtimi malazez. Kalkulimi politik dhe gjeopolitik elementar është se Mali i Zi i pavarur do të inkuadrohet në Kartën e Adriatikut, ku bëjnë pjesë Kroacia, Shqipëria dhe Maqedonia, me çka do të forcohet brezi bregdetar i Adriatikut, nën influencën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke përjashtuar çfarëdo mundësie të influencës serbo-ruse. Poashtu llogaritet se Mali i Zi si shtet i pavarur do të inkuadrohet më shpejt edhe në strukturën ushtarake Partneriteti për Paqe, e cila i përgatit shtetet ballkanike (të ashtuquajtur Ballkani Perëndimor) për anëtarësim në NATO. Zhvillimi i mëtejshëm parashikon edhe mundësinë anëtarësimit më të shpejtë në strukturat e Bashkimit Evropian dhe në integrimet e gjera eur-atlantike. E kjo ka ndikimin e vet edhe në përshpejtimin e integritetit të

rajonit, duke përfshirë Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë, pra, pjesët kryesore të kombit shqiptar, të cilat filluan të fragmentohen në kohën kur u formua Lidhja e Prizrenit.

Natyrisht, në planin politik, është më se e qartë se mbetja e Serbisë pa një federatë qoftë dhe artificiale, sikundër ishte ajo me Malin e Zi, e bënë shumë më të logjikshme e të pa alternativë edhe pavarësinë e shpejtë të Kosovës.

Kur shikohen këto zhvillime gjeopolitike, të cilat llogaritet se po sjellin favore konkrete edhe për shqiptarët, duke korigjuar diçka nga krimi që u bë ndaj tyre para njëqind e njëzet e tetë vjetëve nga fqinjët malazez, serbë, bullgarë e grekë dhe nga Fuqitë e Mëdha të asaj kohe, shtrohet pyetja: mos janë konsumuar përfundimisht idealet e Lidhjes së Prizrenit? Por, për ta gjetur përgjigjen sa më të plotë, duhet të përkujtohen idealet e saj. Dihet se ideali kryesor i Lidhjes së Prizrenit ishte ruajtja e tërësisë territoriale të tokave shqiptare, kompaktësimi i katër vilajeteve në një njësi administrative dhe administrimi i saj nga vetë shqiptarët, duke nënkuptuar edhe arsimimin në gjuhën shqipe dhe administratën vendore në gjuhën shqipe. Vetëm ky përkujtim i shpejtë, na e bën të qartë se ai ideal që nuk është përmbushur, nuk mund të jetë as i konsumuar. Por, ka ndryshuar konteksti gjeopolitik e bashkë me këtë ka ndryshuar edhe ideali i shqiptarëve në ditët tona. Në këtë aspekt, një përparësi e shqiptarëve është se nuk mbetën peng të kujtimit të hidhur historik, sikundër kanë mbetur fqinjët e tyre serbë, të cilët idealin e vet kombëtar të sotëm, e ndërtojnë mbi të kaluarën mesjetare. Ky anakronizëm i ka bërë që të jenë agresorë kundër fqinjëve të vet në vitet e nëntëdhjetë të shekullit XX, që të konfrontohen edhe me komunitetin ndërkombëtar dhe të mbeten edhe sot të izoluar, për shkak të nostalgjive të vjetra kleronacionaliste dhe fashiste.

Në rastin e shqiptarëve, ndryshimi i aspiratave nacionale në realitetet e reja gjeopolitike, ka rezultuar me ndryshimin pozitiv të qëndrimit të komunitetit ndërkombëtar ndaj tyre. Por, në shqiptarëve na mbetet ta gjejmë ku është vija, nën të cilën ndryshimi nuk bën të prekë. Në këtë aspekt, duhet bërë dy veprime paralele: e para, qëndrimi i sotëm ndaj Malit të Zi dhe shteteve të tjera fqinje e ndaj shteteve që janë trashëguese të Fuqive të Mëdha të dikurshme të Kongresit të Berlinit, nuk duhet të ndikohet nga objektivat e porealizuara të Lidhjes së Prizrenit dhe nga dëmi që i janë shkaktuar atëherë çështjes shqiptare.

E dyta, për shkak të koniukturave të tashme gjeopolitike, duke përfshirë edhe miqësinë me shtetet e dikurshme agresore, nuk duhet t'i ndërrohet përmbajtja e vërtetë Lidhjes së Prizrenit dhe luftërave shqiptare për shtet nacional.

Në të vërtetë këto dy ngatërrime kanë ndodhur shpesh në mendimin politik shqiptar e ndonjëherë edhe në vetë historiografinë shqiptare. Por është e qartë se as mbetja peng në të kaluarën e hidhur nuk ndihmon që të orientohemi në realitetin e sotëm gjeopolitik, sikundër që as harresat e të kaluarës, për t' u rreshtuar në kampet e tashme fitimtare nuk na ndihmojnë që të imponohemi si komb me identitet të qëndrueshëm dhe me kërkesa të qarta e realiste.

Rrethanat për kthjellimin e gjërave janë më se të favorshme në njëqind e njëzet e tetë vjetorin e Lidhjes së Prizrenit, në çka kontribuuar edhe pavarësia e tashme e Malit të Zi. Krejt në kundërshtim me ndikimin që ka pasur pranimii atij shteti, në dëm të shqiptarëve, pikërisht para njëqind e njëzet e tetë vjetëve.

MBI KOMBIN

Mr. Sabri Kiçmari

(Definimi, tiparet dhe identiteti i kombit)

Ideja e hedhur në opinion për të krijuar një komb kosovar ka rizgjuar temperamentin për demonstrim të identitetit kombëtar shqiptar. Hapja e debatit është kuptuar edhe si sfidim ekscesiv dhe reagimet kanë qenë jo gjithherë racionale. Një këndvështrim më racional do të duhej të kishte si pikënisje stërhollimin e të kuptuarit të nocionit komb.

Nocioni komb është një fenomen dinamik historik. Definimet për të dhe rreth tij janë të shumta dhe të ndryshme. Për hir të synimit që përmes këtij punimi të merret pjesë në diskutimin e problematikës së shtruar në qarqet shkencore kosovare, por edhe në ato politike e shoqërore, do të mundohem që të respektoj elasticitetin dhe diferencimin e veçantë terminologjik.

Nocioni komb paraqitet në një larmi kuptimesh dhe tipesh. Ai paraqet nevojën e përgjithshme për identitet dhe bashkësi, për njohje dhe pjesëmarrje. Kjo nevojë është një ndjenjë krejtësisht njerëzore, e cila është më e fortë në situata krizash e luftërash, por edhe në faza globalizimi e fragmentarizimi.

Definimi i kombit

Nocioni „komb“ rrjedh nga gjuha latine „natio“ që ka kuptimin „lindje; prejardhje; „(fis) popull(or)“. Përmes nocionit komb fillimisht përcaktoheshin fiset, pastaj në mesjetë pjesëtarët e një bashkësie të vogël fshatare, në periudhën e kohës së re bashkësitë e njerëzve me pikëpamje të përbashkëta për vlera si historia, kultura dhe gjuha si dhe grupet e njerëzve që e ndjenin përbashkësinë politike me njëri tjetrin në një hapësirë të kufizuar gjeografike, të cilën e bashkëbanonin. Dallohen tri lloj definimesh mbi kombin: definimi filozofik, definimi politik dhe ai ideologjik.

Kuptimi filozofik

Filozofi gjerman Immanuel Kant duke shpjeguar nocionin komb merr parasysh dy tipare kryesore - bashkësinë qytetare të njerëzve dhe prejardhjen e tyre. Sipas Kantit „me fjalën popull (populus) nënkuptohet masa e bashkuar e njerëzve, përderisa ata e përbëjnë një të përbashkët. Ajo masë ose edhe pjesa e saj, e cila përmes prejardhjes së përbashkët e njeh veten të bashkuar në një të tërë qytetare, quhet komb (gens).“¹ John Stuart Mill, një nga përfaqësuesit më eminent të liberalizmit, si askush tjetër, ju kushton rëndësi ndjenjave të ndërsjella të simpatisë në mes njerëzve si element konstitues të kombit: „Një ndjenjë e tillë e bashkimit kombëtar me njëri tjetrin mund të rrjedhë nga arsye të ndryshme. Mund të rrjedhë nga raca dhe prejardhja e njëjtë; përbashkësia e gjuhës dhe religjionit e nxisin këtë në mënyrë vendimtare. Edhe kufijtë gjeografik paraqesin një arsye për paraqitjen e ndjenjës kombëtare. Por, në këtë kuptim, më së shumti ndikon një e kaluar e përbashkët politike: ekzistenca e një historie kombëtare dhe përbashkësia e kujtimeve që rrjedhin nga ajo: ndjenjat kolektive të krenarisë dhe të marres, të gëzimit dhe të vuajtjes, të cilat lidhen me ngjarjet e të kaluarës.“² Kurse një nga përfaqësuesit më eminent të filozofisë politike bashkëkohore Alasdair MacIntyre mbron pikëpamjen se kombi mund të kuptohet si një projekt, „një projekt, i cili është krijuar në një farë mënyre në të kaluarën dhe është zhvilluar në atë mënyrë, përmes të cilës është lindur një bashkësi e caktuar morale, e cila ngre pretendimin për pavarësi politike në format e ndryshme të organizuara dhe të institucionalizuara të shfaqjeve.“³

¹ Kant, Immanuel: „Der Charakter der europäischen Nationen“, në: „Werke 1956“, Völl. 6, f. 658

² Mill, John Stuart: „Betrachtungen über die repräsentative Demokratie“, Paderbon 1971, f. 241

³ MacIntyre, Alasdair: „Ist Patriotismus eine Tugend“, në: Honneth, Axel (Hrg.): „Komunitarismus. Eine Debatte über die moralischen Grundlagen moderner Gesellschaften“, Campus Verlag, Frankfurt/New York 1995, f. 96

Kuptimi politik

Ish kancelari gjerman Willy Brandt si një nga projektuesit e strategjisë së Bashkimit të Gjermanisë shihte në nocionin e kombit si të bashkuara të vërtetën historike dhe vullnetin politik. Sipas Brandtit „kombi përfshin dhe ka kuptim më të gjerë se gjuha dhe kultura e përbashkët, si rregullim shtetëror dhe shoqëror. Kombi formohet mbi bazën e ndjenjës së përbashkësisë së vazhdueshme të njerëzve të një populli.“⁴

Shkencëtari amerikan i politikës Benedict Anderson kombin e definon si bashkësi politike e përfytyruar: „Kombi...është një bashkësi politike - e përfytyrua si e kufizuar dhe sovrane. Ai është i përfytyruar për shkak se anëtarët edhe të vetë kombit më të vogël nuk i njohin shumicën e anëtarëve tjerë, nuk do t'i takojnë kurrë ata ose nuk do të dëgjojë kurrë për ta, por në kokën e secilit ekziston, përfytyrohet bashkësia e tyre.“⁵ Shkencëtari tjetër i politikës Karl Deutsch e redukton nocionin komb në ekzistencën e shtetit: „Komb është një popull që e ka shtetin e vet....Nëse një pjesë e rëndësishme e pjesëtarëve të një populli pretendon drejt pushtetit politik për grupin e tij etnik ose gjuhësor, mund ta emërtojme atë si kombësi. Nëse është arritur pushteti – rëndom përmes sundimit të një aparati të shtetit – e emërtojme atë si komb.“⁶

Kuptimi ideologjik

Teoria marksiste bën pjesë në rrethin e parë të definimit ideologjik mbi kombin. Marksizmin nuk e ka përshkuar një fill unik definues për nocionin komb. Karl Marksi dhe Friedrich Engelsi në „Manifestin e Partisë Komuniste“, duke dashur të vënë primatin mbi klasoren para

⁴ Brandt, Willy: „Fjalë e mbajtur para Bundestagut gjerman mbi „Gjendjen e kombit“, gjendet në: „Protokollet stenografike të legjislaturës së 6. të Bundestagut Gjerman“, Janar 1970, f. 840

⁵ Anderson, Benedict: „Die Erfindung der Nation“, Frankfurt am Main 1988, f.15

⁶ Deutsch, Karl: „Nationenbildung – Nationalstaat – Integration“, Düsseldorf 1972, f.204

kombëtares, patën preferuar një formulim fatal për pasuesit e tyre rreth çështjes kombëtare: „Komunistët qortohen se gjoja duan të zhdukin atdheun, kombësinë. Punëtorët s`kanë atdhe. Nuk mund t`u heqësh atyre një gjë që nuk e kanë.“⁷ Këtë formulim do ta revidonin Lenini dhe Stalini, i pari duke u angazhuar për precizimin e të Drejtës së Kombeve për Vetëvendosje deri në Shkëputje, kurse i dyti përmes njërit nga definimet më të përhapura në proveniencën e lindjes rreth kombit si „një bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar historikisht, që ka lindur në bazë të bashkësisë së gjuhës, territorit, të jetës ekonomike dhe të formimit psikik, që shfaqet në bashkësinë e kulturës.“⁸ Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë në botimin e vitit 1980 të „Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe“⁹ i përmbahen pothuajse krejtësisht definimit të Stalinit mbi kombin. Për çudi edhe një botim i vitit 2002 ka ruajtur të njëjtin formulim. Varianti jugosllav i marksizmit i ka kushtuar më shumë elementeve ideologjike përgjatë definimit të nocionit komb. Kështu sipas Eduard Kardelit kombi definohej si një „komunitet specifik popullor i lidhur në bazë të ndarjes shoqërore të punës të epokës së kapitalizmit, me territor kompakt dhe me kuadër të gjuhës së përbashkët dhe të një afërsie etnike dhe kulturore përgjithësisht.“¹⁰ Në variantin marksist të Republikës Demokratike të Gjermanisë (ish DDR) dalloheshin dy lloj kombesh: kombi socialist dhe ai kapitalist.¹¹ Në të gjitha variantet e marksizmit nuk njihej si tipar i domosdoshëm i kombit ekzistenca e shtetit kombëtar, meqë preferohej bashkëjetesa e shumë kombeve në një shtet federal.

Një variant tjetër radikal ideologjik i të kuptuarit të nocionit komb ishte ai nazifashist. Pikëpamjet e teorisë nazifashiste mbi kombin

⁷ K. Marks – F. Engels: „Vepra të zgjedhura“, Shtëpia Botuese „8 Nëntori“, Tiranë, 1980, f. 40

⁸ Cituar sipas botimit të Fakultetit të shkencave politike dhe juridike të Universitetit të Tiranës: „Materializmi dialektik e historik“, vëll. 2, Tiranë, 1980, f. 374

⁹ Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë: „Fjalor i gjuhës së sotme shqipe“, Tiranë, 1980, f. 852

¹⁰ Cituar sipas botimit të Prof. DR. Ali Dida: „Fillet e sociologjisë“, Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1983, f. 261

¹¹ Kleines politisches Wörterbuch, Berlin 1985, f. 632-633

kishin në përmbajtjen e tyre luftën dhe asgjësimin e kombeve dhe racave të caktuara, ekstremizmin, agresivitetin, ultranacionalizmin dhe asimilimin. Kështu, sipas Adolf Hitlerit shpirti i kombit mund të fitohet vetëm „nëse pranë udhëheqjes së luftës pozitive për qëllimet e veta asgjësohet kundërshtari i këtyre qëllimeve.“¹² Benito Musolini kishte një të kuptuar krejtësisht joshkencor mbi kombin sipas të cilit kombi paraqet „shkallën më të lartë të personalitetit, në qoftë se ai është identik me shtetin. Kombi nuk e krijon shtetin sipas kuptimit të receptit të vjetër natyralist Në të kundërtën! –kombi krijohet nga shteti, i cili i jep popullit vetëdijen për bashkësinë e vetë morale, vullnetin dhe rrjedhimisht edhe ekzistencën e vërtetë.“¹³

Tiparet

Asnjëri nga definimet e lartpërmendura nuk ka arritur të përfshijë të gjitha elementet përbërëse në definimin e kombit. Për të arritur deri të një kuptim shkencor mbi kombin nevojitet respektimi i një shkalle të caktuar elasticiteti dhe diferencimi. Për këtë gjë do t'i ndajmë tiparet dalluese në tipare themelore dhe tipare plotësuese. Në tiparet themelore hyjnë gjuha, kultura, kompaktësia territoriale, prejardhja dhe e kaluara e përbashkët si dhe ndjenja e përbashkësisë. Në tipare plotësuese hyjnë shteti, religjioni dhe jeta ekonomike e përbashkët. Pa plotësimin e tipareve themelore nuk mund të definohet një bashkësi shoqërore si komb. Kurse mungesa e tipareve plotësuese nuk është pengesë për kuadrin e plotësimit të veçorive dalluese të kombit. Rrënjët e kombit janë prejardhja dhe gjuha e përbashkët. Por karakteri i kombit zhvillohet përmes historisë, kulturës dhe letërsisë së përbashkët, pastaj sistemit zakonor dhe atij të së drejtës. Janë të evidentueshme edhe rastet kur kombi është zhvilluar mbi bazën e fesë.

Shprehjet komplementare të komunikimit të një kombi rrjedhin nga tiparet e përbashkëta të anëtarëve të tij, nga të cilat pastaj rrjedh një identitet kolektiv, i cili në të shumtën e rasteve forcohet nga besimi për një prejardhje të përbashkët.

¹² Hitler, Adolf: „Mein Kampf“, München 1936, f. 469

¹³ Musolini, Benito: „Reden und Schriften“, Zürich 1934, f. 89

Pa dyshim se shkalla më e lartë e zhvillimit të identitetit të një kombi është zhvillimi i tij në një bashkësi të qëndrueshme të pavarur shtetërore. Por, ekzistenca e shtetit më vete nuk e determinon ekzistencën e kombit më vete, ashtu si edhe ekzistenca e një shteti nuk e determinon ekzistencën e vetëm një kombi brenda tij. Kombi paraqet fuqi universale politike, kulturore, shpirtërore dhe ekonomike. Procesi i krijimit të kornizës së tij shtetërore vjen si pasojë e rrethanave historike, politike dhe shoqërore brenda hapësirës së tij gjeografike. Kristalizimi i interesave dhe nevojave të tij bëhen në akord me këto rrethana.

Identiteti

Në rrafshin teorik mund të identifikojmë tri aspekte kryesore të identitetit të një kombi:

Aspekti kognitiv – paraqet vetëdijen e individit për identitetin kombëtar, e cila vjen si produkt i procesit të edukimit kombëtar;

Aspekti afektiv – paraqet lidhjen e afërt emocionale me kombin ose atdheun, e cila ndjenjë mund të keqorientohet edhe si ndjenjë armiqësie kundër kombeve tjera;

Aspekti aktiv – paraqet ideologjinë kombëtare, e cila proklamon rëndësinë e kombit pranë vlerave tjera politike në rrugë për realizimin e misionit kombëtar (të bashkimit të kombit, pavarësisë kombëtare, çlirimit, të prosperitetit ekonomik, social etj).

Të gjitha kombet i ndjekin interesat e tyre nacionale. Por interesat nacionale duhet t'i nënshtrohen një kalkulimi racional, larg koncepteve mitike. Shqiptarët e Kosovës si pjesë e kombit shqiptar, në 25 vitet e fundit, janë përcaktuar për kalkulim racional të interesave nacionale. Është reviduar kërkesa për bashkim dhe formimin e shtetit-komb në kërkesën për krijim të shtetit të Kosovës dhe ruajtje të identitetit kombëtar shqiptar.

Rreth përcaktimit të identitetit element shumë i rëndësishëm është ndjenja e qytetarëve. Tek shqiptarët përgjithësisht ndjenja kombëtare është mjaft e fuqishme. Megjithë insistimet shekullore për asimilim dhe ç'kombëtarizim, ai e ka ruajtur të fortë ndjenjën kombëtare. Presioni ndaj tij ishte i madh edhe në shtetin e ish RSFJ-së, në të cilin

LKJ proklamonte si vlerë politike barazinë e kombeve. Por ky ishte vetëm një deklaram politik, kurse në praktikë zbatohet politika e minimalizimit të fuqisë së kombeve. Shteti kuptohet si instrument në dobi të klasës dhe jo të kombit.

Çështja e identitetit kombëtar tek shqiptarët në të gjitha viset e banuara me shqiptarë nuk paraqet problem serioz as teorik, as politik dhe as praktik. Kombi shqiptar i plotëson të gjitha tiparet themelore (gjuhën, kulturën, kompaktësinë territoriale, prejardhjen dhe të kaluarën historike si dhe ndjenjën e përbashkësisë) për të qenë komb i integruar në Bashkimin Evropian. Ai madje i plotëson edhe dy tiparet plotësuese që janë: jeta ekonomike e përbashkët që po gjallërohet gjithnjë e më shumë në raportet ekonomike në mes të Kosovës dhe Shqipërisë dhe veçoritë religjioze, që janë pothuajse identike në Kosovë dhe Shqipëri.

Pikëpamja e ithtarëve të krijimit të kombit të ri kosovar është politike dhe jo shkencore. Ata kanë ngatërruar identitetin shtetëror me identitetin kombëtar, që janë dy kategori krejtësisht të ndryshme. “Kombi kosovar” është një projekt artificial. Si i tillë ai nuk i plotëson as tiparet themelore dhe as ato plotësuese, që do të duhej të ishin të ndryshme nga tiparet e pjesëve tjera të kombit shqiptar. Synimi i tyre është i motivuar krejtësisht politikisht, dhe i pa perspektivë, ashtu siç ishin synimi për krijimin e identitetit kombëtar sovjetik dhe atij jugosllav.

Mr. Ukshin Hotit në kuadër të përsiatjeve teorike rreth identitetit kombëtar me të drejtë ka konstatuar: „Po që se sipas teorive në fjalë, lufta e kombeve për pushtet, fuqi, është imanente në vetë natyrën e kombit, autorët e tyre nuk janë naivë që të mos e dinë se shqiptarët janë komb ashtu si kombet tjera të formuara, dhe se poashtu, është në natyrën e këtij kombi, si edhe te kombet e tjera, synimi për t’u shtetëzuar, për të pasur pushtet dhe për të maksimalizuar fuqinë... Procesi i bashkimit të shqiptarëve është dashur të zhvillohet brenda suazave të proceseve integruese të Evropës...”¹⁴

Pra, mund të konstatojmë se interes i kombit shqiptar nuk është parcializimi, por integrimi. Interes i tij jetik është krijimi i shtetit të Kosovës, krahas Republikës së Shqipërisë, kurse interes i tij strategjik

¹⁴ Hoti, Ukshin: „Filozofia politike e çështjes shqiptare”, Shtëpia botuese ROZAF, Tiranë 1995, f. 31

është integrimi në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Kështu mund të arrihet qëllimi themelor i kombit shqiptar: maksimalizimi i fuqisë ekonomike, politike, kulturore dhe rritja e sigurisë, mirëqenies dhe paqes. Ideja e krijimit të kombit të ri kosovar është e kundërta e këtij synimi. Për pasojë ajo ka reduktimin e fuqisë ekonomike, politike e kulturore dhe zvogëlimin e sigurisë, rrezikimin e mirëqenies dhe paqes. Integrimi hap rrugë edhe për rritjen barazisë dhe drejtësisë. Prandaj ideja për krijimin e një identiteti të ri, artificial, pa plotësimin e tipareve themelore me vetëm ndonjë tipar plotësues, përbën vetëm një tentim të paperspektivë në teori dhe të pazbatueshëm në praktikë.

NËNSJETULLA E DISKURISIT MBI NACIONALIZMIN

Dr. Martin Berishaj

Çka paraqet diskursi nationalist?

A paraqet rrezik real të shoqërisë bashkëkohore apo shtesë “rituale” e elitës udhëheqëse? Përse individët e ndryshëm anojnë nga determinimi nacional, pse dëshirojnë ti përkasin një kombi? Mos është llozi themelor që e “luan” identifikimin e individit frika nga fusha e zbrazët e mospërkatsisë.

Para se të fillojmë të përgjigjemi në këto pyetje të shikojmë, se çka është koncepti “popull” dhe çka është (nëse ka çka të jenë) përmbajtja e tij; sepse “përmbajtja” është ajo substancë që i jep fizionomi “autentike” atij lloj diskursi duke e legjitimuar atë në praktikë të përditshme. Në pyetjet e parashtruara mundë të përgjigjemi në mënyrë pohuese. Diskursi nationalist është i ritualizuar deri në skajshmëri, dhe për atë çështje fati shndërrohet në vazhdueshmëri në mënyrë që ti jap kuptim rastësisë. Shumë pak ka (dhe kishte) aso çështjesh që ishin adekuate sikurse ishte dhe është ideja e kombit. Në politikologji këto lloj bashkësish definoohen si “imagined communities” (bashkësi imagjinuese), sepse edhe përfaqësuesit e kombeve më të vogla nuk mund të njohin të gjithë pjesëtarët e kombit, nuk mundë ti takojnë ata, nuk dëgjojnë për ta - dhe, çdo njeri nga ata në vetvete mban parashikimin e lidhshmërisë në atë bashkësi.

Dekompozimi i fushës shoqërore në individ të atomizuar paraqet korrelacionin e shkatërrimit të shoqërisë në regjistra të posaçme simbolike, të cilët nuk i bashkon asgjësend përpos mosmardhënies në mes tyre. Ajo mosmardhënie, ajo shprasti disesi konsolidon pozitivisht dhe ne të depërton ideja e popullit, e cila është refleks subjektiv i kërkesës për tërësi e cila nuk është e perceptuar.

Refleksi subjektiv paraqet pikën e cila është e përbashkët për individët e atomizuar, sepse çdo njëri në vete dhe njëkohësisht si të tjerët

“ëndërron/imagjinon” tërësinë, të cilës do ti përkiste. Mirëpo, kjo nuk është e tëra. Pas atij hapi të përbashkët individët “njoftohen” në mes veti si pjesëtar apo pjesëtare të shoqërisë së “ëndërruar/imagjinuar”.

Te vendosja e “bashkësisë manifestative” rrol të rëndësishëm kanë strategjitë diskursive të cilat i takojmë në përditshmëri, dhe do të thoja i bajmë nën sjetull. Mundë të pajtohemi me qëndrimin e Andersonit i cili konstaton se “lutjen e mëngjesit e ka zëvendësuar leximi i gazetës në mëngjes”, ku gjuha dhe besimi e përcjellin individin nga djepi deri në vdekje duke kontribuar dukshëm në vetëdijesimin njerëzorë sa i përket përkatësisë së trungut kulturor”. Ngjashëm sikurse që rasa nuk është e shkruar në gjene por në diskurs, ashtu populli/kombi qenjësohet dhe riprodhohet para së gjithash në formë të diskursit.

Këtu shtrohet pyetja me të cilën janë ballafaquar shumë teoreticien në politikologji e që kur shtrohet fiton këtë formë: “si të mundet/gjunjëzohet (të ngadhënjehet) nacionalizmi, kur njëkohësisht premiset e diskursit nationalist në përgjithësi përqafohen nga të gjithë, e poashtu dhe ideja e tij/ mbi të! si e tillë, ku homogjeniteti dhe mbrojtja kundër heterogjeniteti janë plotësisht normale.

Nacionalizmi në vete të vet përmban (ndoshta për disa do të jenë si konstatim cinik!) funksion pozitiv shoqëror sepse integron njerëzit dhe i jep shoqërisë kohezivitet në dukje.

Barbara Ward konstaton se, bashkësia nacionale me ide gati primitive të farefisnisë kishte mundësi të formojnë idenë mbi “ të mirën e përbashkët”

Nacionalizmi si princip organizativ (qoftë dhe si kreativitet) është faktor i rëndësishëm në tre nivele të kërkesave njerëzore, që janë: farefisnia, kohezioni dhe funksioni ekonomik edhe pse autorja cek se ideja e kombit nuk është në tërësi element koheziv i shtetit.¹⁵

Për riprodhimin e nacionalizmit dhe për konstituimin e identitetit nacional nuk është e rëndësishme vetëm “përmbajtja” por poashtu praktika diskursive e cila luan rrol të posaçëm në shprehje, legjitimim

¹⁵ Ward, 1966, fq. 55

dhe kyçjen e nacionalizmit në shoqëri. Rreziku është aq i madh sepse disa individ dhe besojnë se mediumet dhe agjikatorët politik flasin me gjuhë e tolerancës. Ndoshta është e vërtetë se përdorin stil “ të butë” dhe disa me lehtësi e “përkthejnë” në formë “më të egër”.

Pikërisht ato lloj diskursesh nuk janë përdorues inoçent të gjuhës, sepse diktojnë formimin e kognicionit social, i vendosin opinionet, qasjet, paragjykimet dhe “kanalizojnë” perceptimin social. Sidoqoftë, nacionalizmi është i lexueshëm, dhe vet diskursi ka rol të rëndësishëm në procesin ideologjik të prodhimit dhe reproduktimit.¹⁶

Mundë të konstatojmë se nacionalizmi jeton para së gjithash në gjuhë, sepse roli i diskursit nuk është vetëm në realizimin e përdorimit e gjuhës dhe komunikimit. Diskursi është aksion social dhe praktik, poashtu diskursi e “rikujton” se është njëkohësisht dhe fakt sociokulturor, si praktikë ideologjike në proces të definimit të sistemit social dhe strukturës së tij. Diskursi i cili ka tendencë konstituimin e bashkësisë imagjinare siç është kombi duhet njëkohësisht të sigurojë mekanizëm bartës dhe të përgjithësoj përcaktuesit dhe të përcaktuarit si një. Pra, duhet ta kenë strukturën siç janë gjuha dhe shtypi. Kështu vendoset njëkohësisht neutraliteti komunikues e që është refleks i strategjisë retorike, të cilën pozicionohen qytetet e mëdha në të ashq. common places, ku bazohet “mendja e shëndoshë”; në anën tjetër neutraliteti paraqitet si produkt i te kaluarës, e që gjithherë është si produkt i hegjemonisë.

Karakteristikë për at lloj shoqërie të homogjenizuar është poashtu implicite e definuar në koncepte të papërcaktuara para së gjithash në bashkësi të imagjinuara, të paraardhësve, historisë, etnicitetit, religjionit, gjuhës dhe territorit e te cilët janë të prezantuar dhe të perceptuar si normë dhe kusht i harmonisë shoqërore e cila vënë theks në “ bashkësitë natyrore” që kanë të drejtë për vetdeterminim.

Ndërrimi i definicioneve të kombit tregon karakterin ideologjik dhe njëkohësisht vërtetojnë konstatimin se, qenia e kombeve nuk është një e vërtetë te cilën e kemi zbulua njerëzit, por konceptualizimi i botës të cilën e kemi formuar. Për at shkak është poashtu qëndrimi i

¹⁶ Rizman, 1991, fq.33

gabuar se munde të behet distinkcioni në mes nacionalizmit si ideologji dhe nacionalizmit si ndjenjë.

Ndjenja paraqitet parasëgjithash përmes distinkcionit paraprak të drejtpërdrejtë në mes “nesh” dhe “atyreve”, me këtë individët munde të vendosin idenë e dashurisë ndaj kombit “te vet”. Kombin mund ta duam vetëm atëherë kur i përcaktojmë “outsideret” sepse në idenë e vet kombit nuk ka “vetanaksi” transcendentale apo vetbimie. Këtij konstatimi me se miri i përket qëndrimi tautologjik i qëllimshëm i Eric Hobsbawmit në librin Nations et nationalismes depuis 1780, ku konstatohet, se karakteristika themelore e kombit modern dhe krejt asaj që është e lidhur me të është pikërisht moderniteti. Ai poashtu konstatohet se, të gjitha tentativat që kombi të definohet me kriterë objektive janë të dedikuara për mosp sukses.

Shkaku i parë qëndron aty se pavarësisht nga ajo se cilët kriterë apo kombinime kriteresh i përdorim (gjuha, kultura, religjioni, historia dhe territori) është treguar se janë poaq të paqarta si ata (pra kombi) që dëshirojnë ta definojnë.

Shkaku tjetër qëndron aty, se gjithmonë munde të gjenden përjashtimet që nuk paraqesin tendencë nacionale apo që “kombet” reale nuk janë të përshtatshëm për kriterë. Sipas mendimit të tij është thjeshtë e logjikshme, shikuar nga ai aspekt se, entitetet e reja historike të cilat janë ende të brishta dhe të cilat ndërrohen.

Andersoni poashtu i pranon Kombit modernitetin mos të themi popullaritetin duke u shprehur se vetëdija kombëtare është vlera më e pranuar universale në jetën politike të epokës sonë. Përkundër “rritjes” konstatohet se të gjitha bashkësitë të cilat janë më të mëdha sesa bashkësitë fshatare dhe e tejkalojnë kontaktin njerëzor janë të paramenduara. Të gjitha kombet janë të lidhura për truall të vetë duke u rrethuar me kufi, i cili i ndanë nga kombet tjera dhe i diferencon nga ato. Atë kufi munde ta definojmë edhe si ndalesë, e cila, si e tillë zgjon besim (kjo dmth, se kufiri është argument biologjik i pa bazë e që dëshiron të mbulojë “skandalin” që nuk ka “tjerët” nga “tjerët” dhe të gjithë janë të nivelizuar.)

Se është kufiri krejtësisht iluzor dhe paraqet një fetish i cili mbulon mangësitë e argumenteve racionale mund të shohim në dallueshmërinë e Schmidtit në mes mikut dhe armikut, i cili është sipas mendimit të tij kriter politik. “Armiku politik nuk don të thotë se është moralisht i prishur apo estetikisht i keq” cek Schmidt duke

thënë se “ është diçka tjetër, i huaj, dhe për qënjen e tij mjafton se është në një kontekst intensiv ekzistencialisht diçka tjetër dhe i huaj’ . Në pohim të kësaj teze mbi bashkësinë imagjinare shton: “ Armiku, është armik publik sepse çdo gjë që është e lidhur me të dhe me grupacionin të cilit i takon ai, bëhet publike” . I huaji, gjegjësisht tjetri, mundë të jenë si individ anonim, si i panjohur, duke u kushtëzuar me deklarimin formal dhe publik. Poqëse do të takofshim këtë lloj anonimit në situatë konkrete si individ konkret , atributi i tij si armik do të luhatej. Prandaj armiku si i tillë mundë të jenë vetëm si armik, publik si armik imagjinar i bashkësisë imagjinare.

Nëse kthehemi te diskursi mundë të shpalojmë disa karakteristika themelore që paraqiten në deklarime dhe ato deklarime karakterizohen si ideologjike. Një e rëndësishme ideologjike mundë ta karakterizojmë me “ ideologjinë e konsenzit” sepse oratorët shpesh sjellën sikurse krejt populli i njeh “faktet” e tyre të shprehura. Varianti tjetër apo karakteristika tjetër të cilën do të mundeshim ta definojmë si “nenvariantë” e konsenzit është reproduktimi i “neve” dhe i “atyreve”, sepse “ne- ja” konsensuale perceptohet si e vetmja legjitime dhe e vlefshme, kjo është tejet simptomatike, sepse i rrezikohet karshi “tjerëve” dhe për “ta”.

Mekanizmat ideologjike për reproduktimin e identitetit nacional janë poashtu simbole të ndryshme dhe respektabile që publikisht paraqiten pran varrezave dhe përmendoreve të heronjve dhe heroinave të ndryshme. Edhe pse në ato përmendore nuk janë eshtrat e tyre dhe as “shpirtrat e tyre” me të cilët do të mundë të identifikohen individët, ato vende janë të ngarkuara me dëshirë për bashkësi imagjinare, siç është kombi.

Këtu mundë të shohim ngjashmërinë (dhe lidhshmërinë) me mentalitetin fetar (lexo vetëdijen) me vetëdijen nacionale dhe reproduktimin e sajë. Me dobësimin e besimit religjioz nuk është humbur vuajtja të cilën e ka zbutë deri në një masë ai besim. Parajsa u shkatërrua dhe vet fati u paraqit si rastësi , kur lindi nevoja për vendosjen e kontinuitetit tjetër. Këtu nuk behet fjalë që rastit ti jepet domethënia apo kuptimi; kontinuitetin mundë ta kuptojmë si lindje e një “dashurie” të re, sepse kombi dhe pjesëtarët e tij në vete kanë

dashuri për të cilën janë të gatshëm të flijohen. Mirëpo “dashuria” nuk është dashuri klasike ndaj njeriut të cilën e përjetojmë në përditshmëri. Ajo është dashuri ndaj bashkësisë imagjinare që i takojnë njerëzit. Aty është edhe “kushti” për një lloj dashurie të tillë sepse kombin dhe përkatësin ndaj tij nuk mundë të përjetojmë në mënyrë “racionale” por atë mundë të përjetojmë me anë të dashurisë të cilës nuk i nevojiten (gjegjësisht nuk duhet të kenë) argumente racionale. Ernest Gellner, psh. është pyet shpesh, pse dhe si është i mundur identifikimi me atdhe dhe lojalitet ndaj tij në bashkësi anonime¹⁷, pra pikërisht “ai anonimitet paraqet kushtin për dashuri”. Përderi sa do të jenë bashkësia dhe individ në at entitet anonim, aq kohë është e mundur dashuria. Me individ josimpatik konkret dhe të keq do të identifikohemi shumë vështirë apo asesi e jo ta duam atë!. Ky koncept i dashurisë ka të njëjtën domethënie siç e ka koncepti i armiqësisë të Schmidti. Pra në bashkësi imagjinare mundë të lindin si dashuria ashtu dhe armiqësia vetëm në relacion me individ anonim. Dashurin ndaj bashkësisë imagjinare mundë ta shpjegojmë edhe ndryshe. Në të gjitha gjymtyrët natyrore siç është kombi, i cili është i asimiluar me ngjyrën e lëkurës me gjini dhe me kohën e lindjes sonë, e që janë elemente të cilët na janë të dhëna paraprakisht, nuk mundë tu rezistojmë por mundë të përjetojmë vetëm atë gjë të cilën e definojmë si “bukuria e bashkësisë”. Pikërisht për këtë gjë, që nuk mundë ti zgjedhim, ato elemente e marrin funksionin e aurës të paanshmërisë. Për shumicën e njerëzve të thjesht pavarësisht nga përkatësia klasore, thelbi i kombit dhe i identitetit nacional qëndron në faktin se, thelbi i kombit nuk njih interesat, dhe pikërisht ky është shkaku pse qenia nacionale kërkon flijim.¹⁸

Si bëhesh ata, për çka e ke njohtë vetën

¹⁷ Gellner, 1994, fq.62

¹⁸ Këtu mundë të rikujtojmë në të ashq. fetishizmin estetik të cilin si koncept në teorinë e politikologjisë e fut Adorno, 1986: “Çka ka funksion mundë të zëvendësohet, ajo gjë që nuk mundë të zëvendësohet është e pavlefshme” Jofunksionaliteti i qenies nacionale është argumenti themelorë dhe mekanizmi ideologjik i cili zgjon besimin se identiteti nacional është “vlerë” të cilën nuk duhet ta mohojnë individët.

Identiteti nacional është gurthemel i çdo ideologjie nacionale. Sikurse çdo identitet edhe identitetin nacional e përcjell njolla e verbër; pra problemi i përcaktimit të identitetit. Si koncept abstrakt për identitet “ngjitet” dallimi e që në shikim të parë mundë të zgjidhet si i tillë me operacionin e negacionit sipas formulës së njohur $A=A$ dhe $A\neq B$. A siç na e paraqet formula e thjeshtë vet negacioni e kyç në identitet dallimin i cili në harmoni me kritikën e Hegelit Fichtes e bazon identitetin si pafundësi të dobët.

Përcaktimin e identitetit nacional nuk mundë të reduktojmë në formulë të thjeshtë të tipit shqiptari=shqiptari, por na nevojitet matrica që duhet të përbej më shumë elemente.

ESE MBI LIRINË

Mr. Zef Ahmeti

Disa qasje rreth semantikës së lirisë

Fjala *liri* është po aq e vjetër sa edhe vetë njerëzimi. Me krijimin e njeriut të parë nga Hyji hasim në lirinë faktike që i jepet njerëzve të parë (Adamit e Evës) përveç një ndalese të vetme (mollës). Që nga gjeneza e deri më sot koncepti *liri* u zgjerua dhe u zhvillua. U bënë përpjekje për ta shpjeguar e definuar. Kjo fjalë filloi të përdoret në konstelacione të ndryshme shoqërore. Liria si koncept filozofik, teologjik dhe juridik ka qenë temë diskutimi, varësisht nga periudha historike, ku janë dhënë mendime nga mendimtarë të ndryshëm. Ndryshe për lirinë mund të thuhet se ajo si koncept ka fituar një domethënie të gjerë në literaturën filozofike, shoqërore dhe në gjuhën e përditshme. Porse ajo, pra, merr kuptime të ndryshe varësisht nga konteksti. Në kontekstin social kuptojmë lirinë e grupeve të caktuara përballë të tjerave, liria politike ka domethënie se ajo duhet të zbatohet në kushtet e detyrimit, në kuptimin teologjik kuptojmë dallimin mes vullnetit/dëshirës së lirë të njeriut dhe asaj nën mbikëqyrjen e Zotit (ENZYKLOPÄDIE, 1990:157). Dhe kjo nënkupton lirinë nga dy kahje: si liri *nga* diçka dhe liria *për* diçka (HANDWÖRTERBUCH, 2003:360).

Liria në antikë

Historikisht nocioni *liri* ka një traditë të lashtë filozofike (nga antikiteti grek) e që gjatë ecjes së kohës ajo ka marrë shpesh kuptime të ndryshme. Kuptimi fillestar, që ka bazën në antikën greke, kishte karakter politik. Shprehja greke »*Eleutheria*« përcaktonte sjelljet, përkatësisht veprimet, individuale që duhej të ishin në harmoni me normat e bashkësisë. *Autonomia* (gre.: *autonomia*) për grekët e vjetër kishte kuptimin e hyjnizimit të natyrës, përshtatje në normat e natyrës dhe përjashtonte mundësinë e nxjerrjes së normave të reja.

Autonomia kuptohej si e tillë nëse njeriu njihte ligjet e natyrës dhe identifikohet sipas tyre, thënë ndryshe fjala *liri* kishte të bënte vetëm me jetën përbrenda »polis« -it (RITTER, 1972:1065). Koncepti filozofik i lirisë specifikohet në kohën kur bëhet dallimi te sofistët mes »*physis*« dhe »*nomos*«. Këtu është fjala për dallimin që pason në antikën e vonshme të antikitetit grek, ligjit natyror dhe ligjeve nga njerëzit. Ky dallim i sofistëve bënte ndarjen e `individit` nga `bashkësia` përkatësisht nga shteti. (ENZYKLOPÄDIE, 1990:165).

Ngjashmëri kishim edhe te forma Sokrateske e të menduarit ku `liria njerëzore` edhe këtu ende nuk ishte rebeluar kundër rregullimit natyror. Një qasje etiko-politike për nocionin liri e kemi tek Platoni. Sipas tij, `shoqëria` (në kuptimin e miqësisë vër.) ishte forma më e lartë e lirisë njerëzore. Elementet e triadës liri si: njohja dhe dashuria për të mirën, e mira (harmonia) dhe rregulli (drejtësia), ishin ekuivalente. Platoni ishte ai që bëri dallimin e parë mes lirisë së vepruarit (Handlungsfreiheit) dhe lirisë së dëshirës (Willensfreiheit), dallim ky që i mundësoi atij të bëjë dallimin mes `lirisë` dhe `spontanitetit`, pra veprimit racional (ku veprimet janë të lira) dhe veprimeve të padëshirueshme që vijnë si pasojë gabimeve apo edhe zbatimeve nën ndikimin e dhunës.

Shuarja e »polis«-it grek dhe lindja kozmopolizmit të perandorisë romake, që e ndryshonte pozicionin politik dhe shoqërorë të individit, i hapi rrugë të reja nocionit *liri* (ENZYKLOPÄDIE, 1990:165). Ndërsa Aristoteli në vitin 384-322 p. Kr. e definonte lirinë si »jetë, që dikush e dëshiron«. Por, liria në atë kohë ishte e rezervuar vetëm për të ashtuquajturit »qytetar aktiv« (HIRSCHBERGER I, 1998:234). Ndërsa të nënshtruarit – »sipas natyrës« - gratë, fëmijët, skllavet dhe »barbarët«, ishin jashtë këtij rrethi. Megjithatë, me Aristotelin kemi edhe fillet dhe refleksionet e (para)kushteve për lirinë njerëzore individuale, ku tematizohet çështja e lirisë edhe jashtë »polis«-it (WÖRTERBUCH, 1995:365).

Shikuar nga këndi etimologjik fjala liri ka dy kuptime sipas atij romak dhe german (dhe grek). Në latinisht fjala *liber* (të lirët) kuptohet në raport me pozicionin e skllaveve, ndërsa ai german ka të bëjë me përkatësinë e një grupi etnik, që i dallon të lirët nga të huajt (të jashtëmit). Sipas kësaj qasjeje, kuptimi latin ka më tepër domethënie juridike, ndërsa ai german lidhet më tepër me »përkatësinë« etnike (ENZYKLOPÄDIE, 1990:161). Ndërsa fatalizmi (lat. *fatalis*: i (para)përcaktuar nga

fati) e vlerëson lirinë e zgjedhjes si iluzion, sepse, vlerësohet, se fati i njeriut nuk mund të ndikohet nga vendimet njerëzore.

Liria në mesjetë

Në mesjetë, ndikuar nga *etërit e krishterimit*, nocioni *liri* trajtohet në kuadër frymës teologjike, konkretisht dhe kryesisht në raport me mëkatin, faljen, dhe në anën tjetër të mundësisë së njeriut për të vendosur, zgjedhur vetë mes rrugës së drejtë, të vërtetë, që më vonë do të shpërblehej me lirinë hyjnore, dhe të keqes, të mbrapshtës (ENZYKLOPÄDIE, 1990:166). Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re ishin ato që e përshkruan jetën e mesjetës e njëkohësisht edhe konceptin e lirisë. Në Dhiatën e Vjetër liria kishte një peshë të madhe përkatësisht (ç`)lirimi. Nga këtu mësojmë se si Zoti e (ç`)liron popullin e zgjedhur të tij (popullin e izraelit) nga skllavërimi, përderisa në Dhiatën e Re është Shën Pali që e tematizon lirinë si mëshirë të Atit Jezu Krishtit (SCHAPP, 1994:30). Për »*ligjet e lirisë*« flasin psh. Po ashtu letrat e Jakobit. Të jetosh në liri do të thotë të jetosh në dashuri dhe se pushteti i Hyjit është ai që liron njerëzit nga varfëria, sëmundjet, vdekja (WÖRTERBUCH, 1995:365). Në kohën e emëruar si post-biblike pyetja e lirisë fillon të individualizohet dhe fillon një ndarje ku bëhet fjalë për pushtetin Hyjnor dhe lirinë njerëzore (SCHAPP, 1994:42). Një kulminacion i këtij raporti arrihet me *Shën Augustinin* (354-439). Në trajtimet e tij lidhur me burimin e së keqes, ai pranon vullnetin (dëshirën) njerëzore individuale, pra lirinë. Përpjekjet për sintezën e mundësisë që njeriu të zgjedhë vetë dhe (para)përcaktimeve (planifikimeve) hyjnore për të gjitha proceset në botë i ka marrë për të parën herë Shën Augustini (ENZYKLOPÄDIE, 1990:166). Ndërsa *Toma von Akuin* (1225-1274) është përpjekur të ndërmytesojë mes mëshirës Hyjnore dhe lirisë individuale. Duke u mbështetur në Aristotelin dhe Agustinin ai i konsideron rrënjët metafizike të dëshirës së lirë (liria e zgjedhjes) si diçka me të vërtetë njerëzore e përcaktuar për të mirë (e mira e përbashkët »*bonum comune*«). Ai këtu në të vërtetë i jep përparësi mëshirës Hyjnore duke iu përmbajtur qëndrimit se Hyji (Zoti) është vetë burimi i vërtetë i lirisë njerëzore, dhe njëherit, edhe qëllimi i tij (Hyjit) (WÖRTERBUCH, 1995:366). Sipas Tomës, liria e dëshirës nuk ka për qëllim cakun përfundimtar, porse ajo

nënkupton vetëm marrjen e vendimeve për rrugën dhe mjetet drejt cakut (FRANZ, BAUM, KREUTZER, 2003:148).

Më vonë diskutimet orientohen gjithnjë drejt lirisë së *individit*. Në këtë drejtim për vite të tëra kemi pasur një konflikt, polemikë mes *Erasmus-it* (1466-1536) dhe *Luterit* (1483-1546), pra mes katolicizmit dhe protestantizmit. Në veprën e tij »*De libero arbitrio*« (vullneti i lirë), Erasmus e përfaqëson mendimin se njeriu duke u bazuar në alternativat e ndryshme të vepruarit, mund ta zgjedh të mirën me vullnetin e lirë. Më vonë teologjia katolike, në mënyrë gjithnjë e më të theksuar, e bën dallimin mes *lirisë njerëzore* dhe *mëshirës mbinatyrore* (übernatürliche Gnade). Tendenca ishte se reflektimet për lirinë njerëzore teologjia katolike ia kishte lënë ose filozofisë, ose kishte drejtuar kah mësimi kishtar. Ndërsa gjërat ndryshojnë me Koncilin II të Vatikanit ku futet përsëri problematika e lirisë në aspektin teologjik (WÖRTERBUCH, 1995:366).

Koha e re dhe e sotmja

Revolucionet shkencore të shek. XVI. dhe XVII që çuan drejt zgjerimit të njohurive, ndikuan po ashtu edhe në (ri)formulimin e semantikës *liri*. Me këto zhvillime të reja, e sidomos me Renesancën, figura e njeriut përforcohet si kurrë më parë me paramendimin se njeriu është krijesë që vepron në mënyrë autonome (ENZYKLOPÄDIE, 1990:167).

Me Renesancën, përkatësisht pas Renesancës, fillon të paraqitet edhe një frymë tjetër që do merret me çështjen e lirisë. Këtu bëhet fjalë për mendimin politik lidhur me lirinë individuale. Kjo e gjen shprehjen e saj para se gjithash në »*Declaration of independence*« (1776) të ShBA, dhe në deklaratën franceze »*Déclaration des droits de l'homme et du citoyen*« (1789) e që janë dhe vlerësohen si dëshmitë më të rëndësishme, dhe që ne i njohim si dokumentet e para për të drejtat e njeriut. Porse më herët me këtë temë merret edhe *Th. Hobbes* (1588-1649). Për atë, secili njeri nga natyra është i lirë, ndaj ai duhet të bëjë në liri atë që e mendon si të nevojshme. Ai nuk mendon se lufta për të mbijetuar duhet patjetër t'i nënshtrohet një autoriteti absolute, pra t'ju nënshtrohet një shteti. Sepse, sipas tij, liria absolute shpie te një nënshttrim absolut.

Për dallim nga ky, *J. S. Mill* (1806-1873), që merret po ashtu me këtë temë, mendon se pushteti shtetëror është në shërbim të avancimit të lirisë individuale, sovranitetit individual. *J. Locke* (1632-1704) thotë, se liria është e kufizuar nga natyra, pra ndalesës që të tjerët të dëmtohen në të drejtat e tyre themelore për jetë, shëndet, lirinë e lëvizjes dhe pronës. Ai mendon gjithashtu se këto janë të drejta duhet të mbrohen nga shteti. Kështu ai e cekë nevojën e ekzistencës së shtetit, porse duke përjashtuar absolutizmin shtetërorë. Megjithatë, edhe Locke e vlerëson lirinë si të drejtë parashoqërore (WÖRTERBUCH, 1995:366). Racionalistët e shek. XVII mendonin se liria njerëzore me- apo pa paramendim, thjesht është e (para)përcaktuar nga rregullat natyrore ose nga një fuqi e lartë e arsyes. Nga ky kënd e definojnë lirinë si Spinoza poashtu edhe Leibnitz, së pari, si mungesë e dhunës që shpie te e drejta për të vetëvendosur.

Kanti (1724-1804) thotë, se kusht i të gjitha lirive sociale dhe politike është detyra, obligimi për të vepruar në një mënyrë, që të mund të ngrihet në një ligj të përgjithshëm. Ekzistenca e këtyre ligjeve të përgjithshme në arsyen e njeriut shpie drejt një lirie të patjetërsueshme e të zakonshme, një realitet që mund të tematizohet, fundja vetëm në mënyrë reale. Liria e patjetërsueshme individuale, është një liri që u shërben të gjithëve (WÖRTERBUCH, 1995:366). *Kanti* dallon mes »lirisë në kuptimin negativ« (pavarësia nga detyrimet e jashtme) dhe në anën tjetër »lirisë në kuptimin pozitiv«. Ai e nënkuptonte autonominë e arsyes (FRANZ, BAUM, KREUTZER, 2003:148).

Ndërsa *F.A. Smith* (1723-1790) tregon se sa e nevojshme është liria në një shoqëri kapitaliste, se sa mund të ketë përmasa të dimensionit ekonomik dhe që orienton kah ligji, për të vepruar, për të shit-blerë, për të marrë dhe për t'u marrë në detyrë. Liria ngrihet në një kusht për një ekonomi të shëndoshë. *Kurse K. Marx* (1818-1883) shprehet për kërkesën dhe interesin për (ç`lirim. Ai kalon në një ideologji ku mendon se, vetëm atëherë, kur çdo detyrim shoqërorë, dhe me këtë çdo pabarazi shoqërore largohet (zhdukët), atëherë mund të jetë e mundur liria. Kjo sepse liria e njërit është (para)kusht për lirinë e tjetrit

(WÖRTERBUCH, 1995:366).

Empiristët anglez e posaçërisht iluministët (HIRSCHBERGER II, 1998:245) francezë përfaqësonin antitezën që nuk njihte liri tjetër pos asaj të veprimit. Sipas kësaj forme të menduarit, dëshira nuk është e lirë por vetëm liria e të vepruarit që përcaktohej si pasuri (mundësi) e individit, dhe për të

bërë atë çka dëshira e tij (racionale) e kërkon (ENZYKLOPÄDIE, 1990:168). Në diskursin filozofik të shek. XVII-XVIII, të gjitha definicionet e lartpërmendura bëhen përsëri aktuale. Për dallim në këtë periudhë fillohet që definimit të nocionit liri t'i shtohet edhe *elementi* i karakterit *antropologjik*. Në filozofinë ekzistenciale të Sartres liria përkufizohet si diçka ontologjike, si një përcaktim themelor antropologjik i njeriut: njeriu është liri (HANDWÖRTERBUCH, 2003:360).

Filozofia moderne e konceptimit të lirisë krijohet me trajtimin e filozofisë së subjektivitetit që sistemohet sidomos në idealizmin gjerman. Kanti Fichte, Schelling dhe Hegel e formojnë një definicion për lirinë i cili kalon konceptin psikologjiko-politik të empiristëve anglez (ENZYKLOPÄDIE, 1990:168). Për Hobes liria ishte vetëm "*libertas a coactione*" – pra mungesë e detyrimit fizik. Ky koncept mbetet aktual dhe përshkruan gjithë filozofinë empirike që nga Locke deri te Voltaire - pra reduktimi i nocionit liri në vetëm liri të vepruarit »*to act or not to act according as we shall choose will*« siç e precizonte Locke (RITTER, 1972:1090).

Në shekullin XX liria bëhet koncept themelor, ideal e modern. Që nga shek. XVIII luftërat për liri bëhen element i rëndësishëm për proceset historike. Liria, Barazia, Vëllazëria", ishte motoja e revolucionit francez. Në ngjarjet e shekullit XIX, liria është faktor vendimtar në procesin e krijimit të shteteve nacionale, por edhe lëvizjeve tjera si ato të punëtoreve dhe atyre socialiste- liria si qëllim revolucioni (ENZYKLOPÄDIE, 1990:174).

Në vitet e tridhjeta të shek. XX kemi një përkeqësim politik të situatës në Evropë. Sulmet ndaj lirisë dhe demokracisë bëhen gjithnjë e më intensive sa për një kohe kemi pas një valë autoritare, anti-individuele dhe anti-parlamentare. Ndërsa fryma e iluminizmit e revolucionit francez e përjeton krizën e parë serioze. Kurse me metodat anti-liri, anti-parlamentare, përpiquej që të zgjidhte problemet ekonomike e sociale të asaj kohe (KÖLZ, 1993:144). Ndërsa përvojat me LDB bëjnë që Evropa të marrë frymë lirie e demokracie dhe kjo shprehet me nxjerrjen e kushtetutave të shumta që përshkruhen me frymën e liberale dhe demokratike (KÖLZ, 1993:145).

Liritë në aktet juridike nacionale dhe konventat ndërkombëtare

Ne dallojmë mes dy kategorive të lirive dhe të drejtave, ato që i garanton kushtetuta që emërohen si të drejta dhe liri themelore, dhe ato që janë të sanksionuara në aktet ndërkombëtare, që ndryshe quhen edhe si të Drejtat e Njeriut. Përderisa ato në kushtetutat nacionale kanë si adresa qytetarët e shtetit, aktet ndërkombëtare i drejtohen gjithë njerëzve, pa përkufizime, pra kanë karakter universal. Si burim i të drejtave themelore, kryesisht në shtetet nacionale dhe moderne, vlerësohen kushtetutat. Kushtetuta, si akti më i lartë ligjor i një vendi, sanksionon të drejtat themelore të njeriut në dispozita të veçanta (OELINGER, 1999:280). *Sigurimi i të drejtave themelore është trajtuar me vite të tëra si arritje themelore juridike dhe kushtetuese* (SCHMIDT,

UHLMANN, 2001: 224).

Element kryesor i të drejtave themelore është individi. Të drejtat themelore përkufizohen përgjithësisht si të drejta të subjekteve (fizik dhe juridik) të siguruara me kushtetutë (OELINGER, 1999: 280). Fjala është për ato të drejta subjektive që kanë bazë në dispozitat kushtetuese. Këtu dallojmë të drejtat e lirisë (të drejtat themelore liberale), politike (bashkëpjesëmarrja dhe e drejta për bashkëpjesëmarrje në pushtetin shtetëror me të drejtën e pjesëmarrjes në zgjedhje), të drejtat sociale. Në diskutimet dhe praktikën e kohëve të fundit dhe sidomos me kalimin e shtetit të rendit në shtet social bëhet fjalë edhe për implementimin e të drejtave të njeriut edhe në raportet mes personave privatë (FUNK, 1996:311).

Ndërsa elemente të drejtave të njeriut ne i gjejmë qysh në kohën antike. Kjo vlen për idenë e paprekshmërisë së identitetit të secilit individ, solidaritetit njerëzor kozmopolitik, lirisë dhe barazisë së të gjithë njerëzve dhe konceptit të së drejtës natyrore universale (BIEFELD, 1998:25). Liritë (të drejtat) e njeriut e fituan formë me revolucionet e mëdha demokratike në fund të shek. XVIII në Amerikë dhe Francë (BRUGER, 1999:88). Katalogjet e lirisë në kushtetutat nacionale, por edhe në aktet ndërkombëtare, vlerësohen si kodifikim i lirisë (KÖLZ, 1993:151) dhe i të drejtat e lirive. Liritë, si të tilla, nuk mund të shikohen ashtu të izoluara prej njëra-tjetrës, porse në kuadër të ngjashmërive shpirtërore në (si) tërësi. Dhe pas Luftës së Dytë Botërore vlerësohej se liria dhe të drejtat e lirive janë të pandashme (KÖLZ, 1993:151).

Si akte të rëndësishme ndërkombëtare që vlerësohen si bazament i lirive (dhe të drejtave) të njeriut janë: Magna Carta-n, 1215, parlamentarizmi britanik, republika amerikane, 1776, Renaissansa, Humanizmi, Iluminizmi, Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit më 1789, idetë sociale të shekullit XIX, si dhe Lidhjen e Kombeve në shekullin që lamë pas. Por, marshi historik i botës së qytetëruar arriti suksesin më të madh vetëm pas katastrofës ndërkombëtare të shekullit XX - fashizmi, nazizmi, komunizmi - që shkatërroi jetën e Evropës, i kushtoi jetën miliona viktimave të pafajshme, rrezikoi seriozisht qytetërimin mijëvjeçar. Karta e OKB-s, 1945, Marrëveshjet e Helsinkit, Konventa për Mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Kopenhagën dhe Karta e Parisit, 1990, e sidomos Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948. Për të qenë edhe më i saktë dhe origjinal, po i emëroj aktet e rëndësishme që sanksionojnë të drejtat dhe liritë si: *Virginia Bill of Rights (1776)*, *Déclaration des droits de l'homme et du citoyen (1789)*, *Déclaration des droits de l'homme et du citoyen (1793)*, *Constitution du Grand-Duché de Luxembourg (1868)*, *Allgemeine Erklärung der Menschenrechte (Vereinte Nationen, 1948)*, *Convention européenne de sauvegarde des droits de l'homme et des libertés fondamentales (Conseil de l'Europe, 1950)*, *Pacte international relatif aux droits civils et politiques (Nations Unies, 1966)*, *Helsinki Final Act (Conference on Security and Co-operation in Europe [CSCE], 1975)*, *Erklärung über die Beseitigung aller Formen von Intoleranz und Diskriminierung aufgrund der Religion oder der Überzeugung (Vereinte Nationen, 1981)*, *Concluding Document of the Vienna Meeting (Conference on Security and Co-operation in Europe [CSCE], 1989)*, *Grundrechtscharta der Europäischen Union*. Të gjitha këto kanë krijuar atmosferën dhe kanë vënë bazat e një bote të re, të lirë, me drejtësi, pluralizëm dhe demokraci.

PARTITË POLITIKE DHE SFIDAT E SIGURISË: RASTI SHQIPTAR

Mr. Afrim Krasniqi*

Kushtetuta e Republikës dhe Strategjia e Sigurisë Kombëtare (SSK), janë dy dokumentet bazë që përcaktojnë principet, organizimin, vlerat dhe sfidat e të ardhmes për shtetin dhe shoqërinë shqiptare. Në thelbin e tyre ato kanë vetëm një dallim: Kushtetuta është dokument rregullator afatgjatë i shtetit të së drejtës, kurse SSK është platformë me karakter kombëtar, në mbështetje të Kushtetutës dhe në funksion perspektiv. Me një përvojë të shkurtër (Kushtetuta është hartuar më 1998 dhe SSK më 2000 dhe 2004), ato përbëjnë një arritje të rëndësishme për demokracinë shqiptare, por edhe një sfidë të hapur për shtetin dhe shoqërinë. Të mësuar me regjime autoritare që sunduan me dhunë dhe ligje represive, Kushtetuta hap një kapitull të ri historik: ajo hedh themelet e sistemit demokratik dhe është një garanti e madhe për parandalimin e përvojave negative të së kaluarës¹⁹.

Në të njëjtën kohë, SSK vjen në një terren të pashkelur, pas përvojave negative gjysmëshekullore të identifikimit të interesave kombëtare me interesat e diktatorit dhe partisë – shtet. Ajo e zgjeron konceptin e sigurisë, nga modeli komunist i sigurisë ideologjike dhe klasore, në modelin bashkëkohor, ku “siguria” nuk nënkupton vetëm një koncept politik e ushtarak, por që përfshin aspektet e gjithanshme të veprimtarisë së qytetarëve, shtetit demokratik dhe shoqërisë. SSK, ashtu si Strategjia Evropiane e Sigurisë dhe Strategjia e Sigurisë e SHBA, parashohin rreziqe dhe kërcënime të reja për sigurinë, të ndryshme nga koha e Luftës së Ftohtë. Konkretisht, prioritare vlerësohen²⁰ rreziqet politike (shtetet e dështuara, krizat,

* Autori është këshilltar i Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Pikëpamjet e shprehura në këtë studim janë personale dhe nuk shprehin mendimin zyrtar të institucionit ku punon.

¹⁹ Abdiu, Fehmi: “5 vjet Kushtetutë”, Tiranë, 2003.

²⁰ Mbikqyrja parlamentare në fushën e sigurisë, Manual për parlamentarët, nr 5, 2003

paqëndrueshmëria), rreziqet ekonomike (varfëria, disbalanca sociale, pirateria), rreziqe të mjedisit (katastrofat, mungesa e burimeve jetësore), si dhe rreziqe shoqërore (konfliktet, mbipopullimi, krimi, emigrimi, etj). Analiza e faktorëve të mësipërm është kompleks, shumë i gjerë dhe një debat që tejkalon kufijtë e një studimi të kufizuar.

Duke iu përshtatur objektivit kushtetues dhe atij strategjik për një demokraci të konsoliduar, shtet të së drejtës, zhvillim demokratik dhe integruar, do të ndalem në rolin e partive politike në çështjet e sigurisë kombëtare. Kjo temë, ashtu si mjaft të tjera të kësaj fushe, janë lëvruar pak ose aspak në rrethet profesionale dhe akademike shqiptare. Në morinë e botimeve politike në Tiranë, por edhe në Prishtinë, nuk ka asnjë botim që merret konkretisht me këtë temë. Të vetmet trajtesa gjenden kryesisht si pjesë të shkëputura të trajtimit të temave të tjera që lidhen me kushtetutshmërinë dhe sigurinë kombëtare.

Në fakt, Kushtetuta e Shqipërisë i njeh një rol të rëndësishëm dhe thelbësor partive politike. Ajo i kushton partive një nen më vete (neni 9), pika e parë e të cilit përcakton se “partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike”²¹. Pika e dytë e këtij neni vendos kufizimet parimore të ekzistencës dhe aktivitetit të partive politike dhe konkretisht “partitë politike dhe organizatat e tjera, programet dhe veprimtaria e të cilave mbështeten në metoda totalitariste, që nxitin e përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore, si edhe ato me karakter të fshehtë janë të ndaluara sipas ligjit”. Në një nen tjetër (neni 131, pika “d”), Kushtetuta i njeh të drejtën Gjykatës Kushtetuese të vendosë mbi “kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, sipas nenit 9 të kësaj Kushtetute”. Krahas kësaj kërkesë, Kushtetuta u jep edhe një të drejtë të rëndësishme partive politike, të drejtën për të vënë në lëvizje, me kërkesë, Gjykatën Kushtetuese²². Në plotësim të Kushtetutës, ligji “Për partitë politike” hartuar më 1991 dhe rishikuar në vitin 2000 bën përcaktimin ligjor të partive politike. Sipas nenit 1 të këtij ligji “partitë politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të ndikojnë në jetën e

²¹ Kushtetuta e Shqipërisë, neni 9, Tiranë 1998.

²² Kushtetuta e Shqipërisë, neni 134, Tiranë 1998.

vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit”²³. Neni pasardhës vlerëson se “partitë politike marrin pjesë në formimin e vullnetit politik të popullit në të gjitha fushat e jetës publike dhe kryesisht nëpërmjet: ndikimit në krijimin e opinionit publik dhe të edukatës politike; nxitjes së pjesëmarrjes aktive të shtetasve në jetën politike dhe evidencimin e aftësisë të shtetasve për të marrë përsipër përgjegjësi publike; pjesëmarrjes në zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore”. Partitë gjithashtu janë të detyruara “të përdorin vetëm mjete dhe metoda demokratike për arritjen e qëllimeve të tyre”²⁴.

Pikërisht për shkak të rolit dhe funksionit kushtetues dhe ligjor të partive politike në formimin e vullnetit të popullit, ushtrimin e pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ, ndikimit mbi qytetarët dhe shoqërinë, si dhe zhvillimit në tërësi të sistemit demokratik, qëllimet dhe përgjegjësitë e partive politike zënë gjithashtu një vend të rëndësishëm edhe në dokumentin “Strategjia e Sigurisë Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. SSK e miratuar së fundi më 25 nëntor 2004 përmes një konsensusi të plotë të gjitha forcave politike parlamentare, në pikën 28.2 kërkon një rol aktiv të partive politike në sigurimin e stabilitetit politik në vend. Duke e përkufizuar stabilitetin politik, si një “çështje jetike për shoqërinë shqiptare”, SSK paralajmëron rreziqet për destabilitetin dhe thekson se nga “përvoja e deritanishme e demokracisë në Shqipëri provon se destabiliteti politik ka qenë i pranishëm në mjedisin e brendshëm. Ky fenomen rrezikon mosfunksionimin e mirë të institucioneve, mungesën e paqes sociale e të qetësisë publike, mosarritjen e konsensusit politik për çështje shumë të rëndësishme të vendit dhe cenon prestigjin e Shqipërisë në kuadrin ndërkombëtar”²⁵.

Në listën e rreziqeve të tjera të brendshme, të lidhura edhe me aktivitetin dhe përgjegjësitë e partive politike, SSK përcakton edhe përmasat shqetësuese të korrupsionit dhe krimit të organizuar, zhvillimin e pamjaftueshëm ekonomik, emigracionin dhe rrjedhjen e trurit, problemet demografike, pamjaftueshmërinë e burimeve njerëzore të specializuara, si dhe dezinformimin e opinionit publik.

²³ Fletore Zyrtare, Ligji Nr.8580, dt.17.2.2000, “Për partitë politike”, 3/2000.

²⁴ Po aty.

²⁵ Fletore Zyrtare, “Strategjia e Sigurisë Kombëtare e RSH”, dhjetor 2004.

Krahas tyre, tema të tjera thelbësore në sistemin e sigurisë në raport me partitë politike janë roli i parlamentit, forcimi i shtetit ligjor, respekti për të drejtat e njeriut dhe minoritetit, dialogu për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, reforma në Forcat e Armatosura dhe institucionet e tjera të sigurisë, veprimtaria diplomatike, raportet me partnerët ndërkombëtarë, etj. Në përkufizimin e “interesave kombëtare” dhe raportit me pushtetin politik, SSK vlerëson se “pushteti politik e ka për detyrë sublime përcaktimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave kombëtare. Ky angazhim duhet të shoqërohet me kërkimin dhe sigurimin e konsensusit të gjerë nëpërmjet debatit publik. Jo çdo interes kombëtar (me përjashtim të interesave të mbijetesës) mund të jetë edhe interes i përbashkët ose në interes të gjithëve. Në këtë kuptim, unanimiteti për përcaktimin dhe realizimin e interesave kombëtare nuk është domosdoshmëri, por pranimi dhe konsensusi është rregull që duhet zbatuar me konsekuencë në një sistem demokratik”.

Partitë politike përfaqësojnë programet e tyre përmes përfaqësimit në parlamentin dhe në qeverisje, rol që krijon një ndërthurje të përgjegjësive kushtetuese dhe në fushën e sigurisë²⁶. Si të tilla, ato janë direkt të përfshira edhe në përcaktimet e “Kapitullit 4” të SSK, sipas të cilit “institucionet kryesore përgjegjëse në lidhje me çështjet e sigurisë janë Kuvendi, Presidenti dhe Këshilli i Ministrave”²⁷. Në përputhje me Kushtetutën, Kuvendi “është organi i vetëm që miraton ligje në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit”²⁸, si dhe kryen funksionin e “kontrollit demokratik parlamentar” mbi institucionet e sigurisë. Presidenti është “funksionari më i lartë përgjegjës për realizimin e misionit, parimeve dhe objektivave të sigurisë së vendit dhe mbrojtjen e zhvillimin e interesave kombëtare”²⁹ dhe në këtë funksion drejton edhe Këshillin e Sigurimit Kombëtar, një organ kushtetues dhe këshillimor i Presidentit. Institucioni i tretë, Këshilli i Ministrave përfaqëson pushtetin ekzekutiv dhe përgjigjet “për

²⁶ International Democratic Institute, “Political Parties in Albania”, Tiranë, 2005.

²⁷ Fletore Zyrtare, “Strategjia e Sigurisë Kombëtare e RSH”, dhjetor 2004.

²⁸ Po aty.

²⁹ Po aty.

zbatimin e SSK dhe gjendjen e zhvillimit e instrumenteve të sigurisë dhe të burimeve kombëtare”³⁰.

Në thelbin e tyre trajtesa, ndarje dhe përgjegjësi të tilla kushtetuese në rolin e partive politike në fushën e sigurisë kombëtare, gjenden në shumicën e shteteve me sistem politik demokratik të konsoliduar, përfshirë edhe në ish vendet komuniste, tashmë pjesë e integruar në Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Dallimet midis modelit shqiptar dhe atij rajonal e më gjerë, më shumë se në parimet e shkruara gjenden në rrafshin e zbatimit konkret të tyre. Secili vend ka veçoritë dhe tiparet e veçta në zhvillimet politike, rolin e partive politike, institucioneve që ato krijojnë si dhe në renditjen e rreziqeve dhe kërcënimeve për të ardhmen.

Parë nga ky këndvështrim, në dokumentet e SSK të Shqipërisë, Maqedonisë, Kroacisë, Serbisë, por edhe të Bullgarisë dhe Rumanisë ka dallime thelbësore, sidomos përsa i përket klasifikimit të rreziqeve të brendshme dhe sfidave të së ardhmes³¹. Të gjitha shtetet e rajonit ndajnë të njëjtin synim për integrim në NATO dhe BE, për bashkëpunim midis shteteve, treg të lirë, forcim të institucioneve demokratike, respektim të të drejtave të njeriut, etj, por përvojat e 15 viteve të fundit kanë dëshmuar se jo të gjitha vendet iu janë përmbajtur në thelb, në kohë dhe në cilësi këtyre angazhimeve³². Tashmë kur vendin e luftërave etnike në Ballkan e kanë zënë proceset e afirmimit të vlerave demokratike dhe gara për integrim, natyrshëm që në morinë e problemeve në fushën e sigurisë, secili vend ndalet në ato probleme, të cilat do të përbëjnë kryetëmën e sotme dhe të së ardhmes së afërt. Ky zhvillim ndodh edhe në Shqipëri. Duke bërë diferencimin se cilat janë problemet më thelbësore dhe më tipike në Shqipëri në fushën e sigurisë, si dhe cilat janë zhvillimet dhe përgjegjësitë e partive politike në raport me këto probleme, le të ndalemi konkretisht në disa prej tyre.

Shqipëria zyrtarisht nuk ka probleme me integritetin e saj territorial. Kufijtë e saj shtetëror janë të njohur nga shtetet fqinje dhe politika

³⁰ Po aty.

³¹ Logoretti, Rudolf: “The Security of the Balkan Region. The Role of NATO”, Ëienna, 2005.

³² BE: “Ballkani Perëndimor 2004. Asistenca, kohezioni dhe kufijtë e rinj të Europës”. Bruksel. 3.11.2002.

zyrtare shqiptare nuk ushqen asnjë pretendim për rishikimin e tyre³³. Në dukje formal, ky qëndrim shpreh një element me mjaft rëndësi për sistemin e sigurisë në rajon dhe më gjerë. Kjo, pasi Shqipëria, në këndvështrim etnik, është nga të vetmet shtete në botë që në kufijtë e saj tokësorë kufizohet nga banorë të të njëjtës kombësi. Në qëndrimet ndaj fqinjëve, por edhe në politikën e jashtme dhe në çështjen kombëtare nuk ka asnjë dallim midis partive politike parlamentare. Programi i tyre politik është thuajse identik, qëndrimet e qeveri gjatë viteve 1992 e në vazhdim kanë qenë të njëjta, në funksion të roit moderator në rajon. Shqipëria beson në një Kosovë të pavarur, një shtet i dytë demokratik i shqiptarëve në hartën e Evropës së Bashkuar. Shqipëria beson gjithashtu në integritetin e Maqedonisë, njohja e të cilës më 1993 bashkoi të gjithë spektrin politik të Tiranës. Qëndrime konsensuale të partive politike vërehen edhe në aspektet e tjera të SSK, që kanë të bëjnë me integrimin euroatlantik, bashkëpunimin rajonal, miqësinë me vendet fqinje, respektimin e të drejtave të pakicave kombëtare si dhe në sfidën e re globale të luftës ndaj terrorizmit. Kjo e fundit merr një rëndësi të veçantë për Shqipërinë dhe kontributin e saj. Imazhi i saj ndërkombëtar si një vend me shumicë të besimit mysliman, mori një zhvillim të ri në kushtet e përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive në koalicionin kundër terrorizmit ndërkombëtar, shpesh të identifikuar me pa të drejtë si koalicion kundër shteteve të një besimi tjetër fetar nga ai i botës perëndimore. Me një përvojë minimale në operacionet ushtarake në vendet e tjera (Shqipëria kurrë nuk ka sulmuar as pushtuar një shtet tjetër; ajo ka ndihmuar në çlirimin e territoreve të caktuara të Jugosllavisë më 1944; nuk ka pranuar të përfshihet në luftën italo-greke (1940) dhe luftën civile greke (1949); aderoi në Traktatin e Varshavës (1955), nuk mori pjesë në asnjë operacion ushtarak të tij dhe e braktisi atë më 1968, duke qëndruar gjatë gjithë viteve 1968-1991 jashtë pakteve ushtarake të Luftës së Ftohtë), më 1992 qeveria demokratike paraqiti kërkesën zyrtare për anëtarësim në NATO. Duke filluar nga viti 1995 në Bosnje, Shqipëria u përfaqësua për herë të parë në histori me misione paqeruajtëse në kuadër të NATO dhe aleancave perëndimore. Misionit të Bosnjës iu shtua tre vjet më parë edhe dërgimi i trupave paqeruajtëse në Mosul (Irak) dhe më pas edhe në Kabul (Afganistan).

³³ Botimi "Shqiptarët në Ballkan". ISHSN. Tiranë. 2001.

Marrja e përgjegjësisë të tilla natyrshëm ndikon edhe në shtimin e mundësive për cenimin e sigurisë. Trupat shqiptare paqeruajtëse nuk kanë patur incidente serioze në misionet e tyre në tre nga vatrat më të nxehta të konflikteve në botë, por pas ngjarjeve tragjike të muajit mars 2006, kur trupat talebane rrëmbyen dhe ekzekutuan katër shtetas të kombësisë shqiptare, në përgjigje të angazhimit shqiptar në koalicionin kundër terrorizmit. Fakti se të katër personat ishin shtetas të një vendi tjetër, por përcaktues në vendimin e krerëve talebanë ishte kombësia e tyre shqiptare, e bën edhe më direkte aktin kriminal ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve. Kjo ngjarje nuk ndikon në thelbin e angazhimit shqiptar në koalicionin antiterror, por ndërkohë e bën të domosdoshme rritjen e masave të sigurisë për të gjithë shtetasit dhe vetë shtetin shqiptar.

Tej konsensusit politik për çështjet e integritetit, problemeve kombëtare dhe ato të thelbit të politikës së jashtme, në Shqipëri politike të 15 viteve të fundit vërehen gjithashtu edhe qëndrime të dyzuara në zbatimin konkret të angazhimeve. Në fundin të viteve '90, partitë e përdorën hapjen drejt procesit të integritetit nga njëra palë si kapital i saj politik dhe nga pala tjetër si humbje e identitetit kombëtar. Në mesin e viteve '90 partitë kryesore politike iu afruan qëndrimeve në politikën e jashtme, por bënë dallime në qëndrimet ndaj zhvillimeve politike në Prishtinë dhe Beograd, duke krijuar përshtypjen se secila palë u përpoq të përfitojë sa më shumë kapital politik prej zhvillimeve të tilla, pa marrë parasysh interesat strategjike të gjithëpranuara të Shqipërisë. Në fundin e viteve '90 fushata shtetërore kundër elementëve radikale islamike në Shqipëri qëllimisht u përdor si preteks për të dëmtuar imazhin politik të opozitës së djathtë. Zhvillime të tilla u përsëritën edhe pas ngjarjeve tragjike të 11 shtatorit 2001. Të njëjtat qëndrime të me dy standarde janë konstatuar edhe në trajtimin e çështjeve të tjera prioritare të sigurisë, siç janë lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, garantimi i pavarësisë së sistemit të drejtësisë, etj. Në mënyrë të gabuar u imponua një praktikë e gabuar sipas të cilës partitë që ndodheshin në opozitë janë simbol i krimit e korrupsionit apo që drejtuesit e institucioneve kushtetuese e të drejtësisë duheshin shkarkuar për paaftësi e akuza të tjera sa herë kryhej rotacioni politik.

Këto dhe të tjerë shembuj dëshmojnë se në tërësi forcat politike në qeverisje, në jo pak raste, më shumë e kanë keqpërdorur përkrëhjer

masive për integrim dhe orientimin gjithëpopullor. Udhëtimet, sesa e kanë kërkuar, ruajtur dhe zhvilluar atë. Në vende të tjera të lindore, si Çekia, Polonia, Hungaria, Sllovakia, etj, pozita dhe opozita e kanë përdorur konsensusin kombëtar për integrimin si urë lidhëse midis forcave politike rivale, midis institucioneve dhe midis shtetit e qytetarëve. Reformat dhe vendimet më të rëndësishme siç janë reformat kushtetuese, ato në fushën e privatizimit, reformat në sistemin e drejtësisë, në çështjet e pronës, të integritit, etj, janë realizuar përmes një platforme të pranuar, votuar dhe mbështetur nga të gjitha forcat kryesore politike. Kjo mënyrë e civilizuar e përballjes së shtetit dhe shoqërisë me sfidat kryesore të vendit, ka rezultuar e suksesshme dhe ka dhënë efektet e veta brenda një kohe relativisht të shkurtër, ndaj si e tillë, përbën një përvojë mjaft pozitive që duhet ndjekur nga Shqipëria dhe vendet e tjera të Ballkanit perëndimor.

Parë në retrospektivë, zhvillimet e 15 vjetëve të fundit dëshmojnë se ndërmarrja e reformave të gjithanshme demokratike, në tërësinë e tyre, sollën rezultate pozitive për vendin e shoqërinë. Më 1990 Shqipëria ishte një shtet diktatorial. Pas 15 vitesh Shqipëria përfaqëson një demokraci të konsoliduar që pretendon anëtarësimin në NATO brenda dy viteve të ardhshme. Ky ndryshim thelbësor shpreh revolucionin e madh që ka ndodhur gjatë këtyre viteve në sistemin demokratik në vend, përfshirë edhe në raportin e partive politike me institucionet përgjegjëse në fushën e sigurisë. Një vlerësim i tillë pozitiv vlen edhe për parlamentin, i cili ka pësuar ndryshime pozitive në mënyrën e funksionimit të brendshëm të tij, zgjerimin e tematikave të diskutimit, rritjen e transparencës qeveritare ndaj publikut dhe përfaqësimin më të mirë të interesave të qytetarëve³⁴.

Përvoja e vetme shqiptare me sistemin elektoral konkurrues të partive politike ishte shënuar në vitet 1921-1923. Më 1991 kur u zhvilluan zgjedhjet e para politike shumëpartiake asnjë nga protagonistët e partive dhe zgjedhjeve të viteve '20 nuk jetonte më. Më shumë se dy breza qytetarësh kishin lindur dhe u rritën në një sistem politik monopartiak, ku votimi kundër përbënte krim dhe dënohej me 10 vjet burgim. Në këto rrethana ishte e pritshme që zgjedhjet politike dhe parlamentet e para të viteve '90 të shfaqnin mangësi dhe probleme në implementimin e standardeve demokratike të zgjedhjeve dhe jetës

³⁴ Oli Rehn: Fjalim në Parlamentin shqiptar, Tiranë 2005.

parlamentare. Deri në mesin e viteve '90 gjithë vendet ish komuniste shfaqën probleme të tilla, por në fundin e viteve '90 diferenca midis standardeve të aplikuara thellohej nga vendi në vend. Konkretisht Shqipëria shfaqti probleme serioze me zgjedhjet 1996, 1997 dhe më pas 2001. Problemet zgjedhore krijuan institucione politike të atakueshme, dobësoi jetën parlamentare dhe funksionin shoqëror të partive politike, tensionoi gjendjen në vend dhe në disa raste ndikoi në cenimin e stabilitetit politik e kushtetues të vendit³⁵. Partitë politike u treguan të afta të krijonin rreth tyre një rrjet të gjerë strukturash dhe mbështetësish fanatikë, por në tërësi u treguan të paafta për të krijuar standarde demokratike të zgjedhjeve, të debatit politik, të respektit ndaj pakicës dhe të mbajtjes së premtimeve elektorale. Këtyre fenomeneve negative iu shtua edhe tipari tjetër i tranzicionit shqiptar: fakti se partia fituese vazhdimisht u shfaq e njësuar me pushtetin kryesor kushtetues – parlamentin dhe atë ekzekutiv – qeverinë, duke mbajtur gjallë mentalitetin e vjetër të partisë – shtet. Të njëjtat fenomene në periudha të konsiderueshme kohore u shfaqën edhe në vendet e tjera në rajon, përfshirë Kroacinë, Maqedoninë, Rumaninë dhe Bullgarinë, por në Shqipëri ato zgjatën më shumë dhe efektet negative rezultuan të ishin edhe më të mëdha. Pasojë e tyre ishte rritja e pushtetit të partive politike dhe njëkohësisht ulja e mbështetjes së tyre elektorale; rritja e pakënaqësisë së qytetarëve nga politika dhe njëkohësisht ulja e përqindjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhje.

Nëse marrim kompetencat kushtetuese të parlamentit (neni 170 i Kushtetutës), rezulton se megjithë krizat politike të viteve 1991, 1997 dhe problemet e qeverisjes më 1995, 1996, 2003 parlamenti nuk ka arritur të ofrojë zgjidhje politike. Në të gjitha rastet zgjidhjet janë gjetur jashtë parlamentit, kurse vetë ai është përdorur për thellimin e krizave dhe më pas për legjitimimin e zgjidhjeve të ofruara nga jashtë. Parlamenti nuk ka patur sukses as në hartimin e projektit kushtetues (1994 dhe 1998), në reformimin e institucioneve kushtetuese (propozimet kanë ardhur gjithnjë nga qeveria), në kontrollin e ligjshmërisë në vend (nuk ka një strukturë dhe komision që ndjek zbatimin e ligjeve) apo në zgjidhjen e krizave të besimit të qeverisë

³⁵ Krasniqi, Afrim: "Burimet e konfliktit Politik në Shqipëri", "Politika & Shoqëria". ISPS. Tiranë, 2002.

(nuk ka patur asnjë rast mosbesimi ndaj qeverive). Është theksohet gjithashtu se për shkak të moskuptimit si duhet të rolit të parlamentit si institucioni kryesor kushtetues në vend, dhe mbivendosjes së rolit të partive kundrejt parlamentit, ka ndodhur që zhvillimet pozitive të ngritjes së 20 komisioneve Ad Hoc për hetimi parlamentar në çështje të ndryshme, të përfundojnë gjithnjë me raporte të dyzuara që japin konkluzione të kundërta. Duke patur një parlament me legjitimitet të cunuar, të pafuqishëm për të kontrolluar ekzekutivin dhe me një rendiment të ulët politik, iu la hapësirë krijimit të një oligarkie të re politike që kontrollonte njëherësh partitë politike, legjislativin, ekzekutivin dhe një pjesë të institucioneve kryesore kushtetuese³⁶. Pjesë e mentalitetit oligarkik është kërkesa e parë e çdo mazhorance të re parlamentare për të iniciuar ndryshime nominale në krye të shumicës së pushteteve të tjera dhe institucioneve kushtetuese.

Ligji “Për partitë politike” (2000) ndalon përdorimin e mjeteve jodemokratike në aktivitetin e partive politike. Kushtetuta dhe ligji dënojnë gjithashtu ndjekjen e politikave ekstremiste që krijojnë cenim të rendit kushtetues, stabilitetit të vendit, të jetës së qytetarëve dhe pronës private. Këto parime të njohura dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në sistemin e sigurisë kombëtare, jo gjithnjë janë respektuar nga partitë politike. Momentet më kulmore u shënuan më 1991, 1997 dhe 1998. Në rastin e parë ish komunistët, në përpjekje për të mbajtur nën kontroll jetën politike dhe zgjedhjet e para shumëpartiake në vend, krijuan përplasje sociale dhe nxitën elementë të përplasjes civile. Në shkurt 1991, tre muaj pas lejimit të pluralizmit politik dhe një muaj përpara zgjedhjeve të para parlamentare, shoqata e njohur si “Vullnetarët e Enverit” u mbështet nga ushtarakët fanatikë, drejtuesit e shtetit, policia sekrete dhe pjesa më e madhe e policisë popullore. Në konfrontimet e para më 21-23 shkurt 1991 në Tiranë u vranë disa civilë të pafajshëm. Viktima civile pati edhe në qytete të tjera, si në Shkodër, Korçë, Kavajë, Elbasan, Durrës, Vlorë, etj. Qëndrimet konfliktuale të komunistëve i nxitën demokratët që menjëherë pas ardhjes në pushtet më 1992, të miratojnë ligjin për nxjerrjen jashtë ligjit të Partisë Komuniste.

Stabiliteti politik dhe ecuria demokratike e vendit u vunë në shënjestër edhe në momente të veçuara të viteve 1992-1996. Konkretisht, më

³⁶ Po aty.

1993 u arrestua udhëheqësi i opozitës, akt që u prit me protesta masive të grupimeve opozitare ish komuniste. Më 1994 kundërshtarët e regjimit demokratik ia dolën të bllokojnë projektin për Kushtetutën e re, kur në referendum ata fituan një përqindje më të lartë sesa përkrahësit e projektit. Elementë të tensionimit të jetës politike u konstatuan më 1994-1995 me rastin e vrasjes në kufirin jugor të rojeve kufitare shqiptare si dhe arrestimit të katër politikanëve minoritarë grekë, të akuzuar për veprimtari kriminale dhe terroriste ndaj Shqipërisë. Pas krizës së zgjedhjeve (1996) të kritikuar nga vëzhguesit ndërkombëtar (OSBE), opozita bojkotoi parlamentin dhe shpalli protesta, duke e zhvendosur krizën nga institucionet në rrugë. Por kriza më e madhe politike dhe sociale ndodhi në muajt e parë të vitit 1997. Ajo goditi ashpër themelet e sigurisë kombëtare dhe shënoi kthim pas në proceset demokratike, zhvillimin ekonomik, përparimin e vendit dhe integrimin euroatlantik të tij³⁷. Pretekst i krizës ishin falimentimi i disa firmave – piramida të fajdeve, dy prej të cilave u drejtuan nga kryetarë të dy partive politike. Krahas dhunës, kaosit dhe rënies së autoritetit të shtetit, mëse një milion armë u grabitën nga depot ushtarake dhe kaluan në duart e pakontrolluara të civilëve, kryesisht të grupeve dhe bandave kriminale. Në raste të tilla të krizës së rëndë politike dhe ekonomike, partitë politike numbën rasti të ofrojnë zgjidhje konkrete dhe të parandalojnë më të keqen. Ato, me vetëdije, u bënë pjesë e rezistencës ose e agresivitetit absurd, duke rendur më shumë pas pushtetit politik sesa ndaj vlerave të demokracisë.

Një moment tjetër kritik për sigurinë kombëtare dhe jetën politike në raport me të, ishte 12 shtatori 1998, kur pranë selisë së PD u ekzekutua deputeti Azem Hajdari, udhëheqësi kryesor i protestave antikomuniste për rrëzimin e sistemit komunist në dhjetor 1990. Vrasja tensionoi klimën politike në vend dhe reagimi pas vrasjes solli largimin e qeverisë, si dhe rikthimin e skenave dramatike të marsit 1997. Në këtë mënyrë, shteti dhe institucionet e tij, përfshirë edhe institucionet e sigurisë, të sapongritura nga hiri i 1997, morën një goditje tjetër të madhe, për të cilën përgjegjësia kryesore bie mbi vetë partitë politike kryesore dhe udhëheqësit e tyre.

³⁷ Krasniqi, Afrim: "Rënia e demokracisë", Tiranë 1998.

Moment kritik për sistemin kombëtar të sigurisë ishte edhe viti 1999, kohë në të cilën u zhvillua ajo që tashmë njihet si Lufta e Kosovës. Ashtu siç pritej, Shqipëria hapi dyert për rreth një milion refugjatë kosovarë të dëbuar me dhunë nga ushtria pushtuese serbe në Kosovë. Për një vend me 3 milion banorë permanentë, me ekonomi të varfër, shtet ligjor të dobët dhe të sapodalë nga kriza e thellë e viteve 1997-1998 përballimi i një shifre kaq të lartë të refugjatëve të luftës ishte një sakrificë jashtë mundësive. Vullneti i jashtëzakonshëm i qytetarëve dhe ndihma e menjëhershme ndërkombëtare evituan shndërrimin e gjendjes në katastrofë humanitare. Vlen të theksohet se për herë të parë në historinë 15 vjeçare të pluralizmit politik, partitë politike, sidomos të opozitës, hoqën dorë nga aksionet politike dhe deklaruan mbështetjen pa rezerva për kryeministrin dhe qeverinë e spektrit tjetër politik. Në këtë qëndrim, krahas ndjenjës së lartë kombëtare, ndikoi në një masë jo të vogël edhe mësimi që politika mori nga ngjarjet e viteve 1997-98.

Zhvillime problematike u shënuan edhe në vitet 2001-2003, fillimisht për shkak të problemeve zgjedhore dhe më pas luftën së brendshme politike për pushtet brenda mazhorancës së majtë. Brenda një viti u ndërruan tre kabinete qeveritare dhe Shqipëria humbi rreth dy vjet në progresin e saj drejt Marrëveshjes së Asociim – Stabilizimit me Bashkimin Europian.

Në ligjin mbi partitë politike 1991 dhe ndryshuar në vitin 2000 përcaktohet ndalimi i “forcimit të partive politike mbi baza fetare, etnike dhe krahinore”³⁸. Fryma e këtij parimi të rëndësishëm është përfshirë edhe në Kushtetutën e Shqipërisë, miratuar me referendum në tetor 1998. Neni 9, pika 2 i Kushtetutës përcakton se “partitë politike dhe organizatat e tjera, programet dhe veprimtaria e të cilave mbështeten në metoda totalitariste, që nxitin e përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike ... janë të ndaluara, sipas ligjit”³⁹. Në ndryshim nga kufizimi ligjor dhe më vonë fryma e kushtetutës, gjatë 15 viteve të veprimit të ligjit janë konstatuar raste të kapërcimit të dukshëm të tij.

³⁸ Fletore Zyrtare, Ligji Nr.8580, dt.17.2.2000, “Për partitë politike”, 3/2000.

³⁹ Kushtetuta e Shqipërisë, neni 9, Tiranë 1998.

Konkretisht, në qershor 1991 politika shqiptare u përfaqësua në tryezën me shefin e Departamentit të Shtetit me disa parti politike, midis të cilave edhe Bashkimi Kristian dhe Islam, një parti me profil të qartë fetar. Ky moment shënoi daljen e parë dhe të fundit të kësaj partie në publik. Më 1992 u regjistruan në gjykatë partitë e para me theks fetar dhe etnik, ku më kryesoret prej tyre ishin Partia Demokristiane dhe Omonia (PBDNJ), e para përfaqësuese kryesisht e bashkësisë katolike dhe e dyta përfaqësuese e minoritetit grek në Shqipëri. Zyrtarisht dy partitë deklaruan se përfaqësojnë të gjithë qytetarët dhe shtrirja e tyre është kombëtare. Më 1992 organizata "Omonia" nuk lejua të konkurrojë si subjekt elektoral për shkak të natyrës së saj etnike, por presioni ndërkombëtar detyroi autoritetet shqiptare që dy javë më pas të miratojnë zëvendësimin e "Omonia"-s me një parti të re, Bashkimi për të Drejtat e Njeriut⁴⁰. Në vitet e mëpasshme, sidomos gjatë gjysmës së dytë të viteve '90 dhe viteve të fundit u panë përpjekje të tjera publike për krijimin e partive mbi baza etnike dhe fetare. Edhe në zgjedhjet parlamentare (2005) konkurruan në zgjedhje dy parti të reja, Partia e Drejtësisë e orientuar drejt besimit fetar islam dhe një partie e pakicës maqedone në Shqipëri⁴¹. Dalja e tyre në jetën publike, sidomos e partisë mbi baza fetare, shkaktoi debat publik dhe nxiti autoritetet e gjykatës të rishikojnë vendimin. Drejtuesi i saj, një udhëheqës fetar lokal, deklaroi se nuk ka lidhje midis angazhimit të tij fetar dhe politik, gjë që bindi autoritetet të lejojnë krijimin e partisë dhe konkurrimin e saj në zgjedhje.

Tradicionalisht Shqipëria përbën një rast ideal të bashkëjetesës dhe harmonisë fetare. Kjo traditë e çmuar është ruajtur dhe forcuar gjatë monarkisë, diktaturës dhe më pas edhe tranzicionit demokratik⁴². Përpjekjet e veçuara për të përdorur përkatësitë fetare për interesa politike dhe për pasojë, ndarje të vendit mbi baza fetare, fatmirësisht kanë rezultuar të dështuara. Më 1913 Shqipëria me shumicë myslimane mirëpriti një princ gjerman të krishterë⁴³. Më 1914-15 një lëvizje me karakter fetar dhe kriminal mori fund me ekzekutimin e

⁴⁰ IDA / IRA: "Albania electoral reports", Tiranë, 1992.

⁴¹ KQZ: Buletini i zgjedhjeve, Tiranë, dhjetor 2005.

⁴² Kadare, Ismail: Fjala në simpoziumin "Mbi harmoninë fetare: rasti shqiptar", Tiranë, dhjetor 2003.

⁴³ Amstrong. D. Heaton. "Gjashtë muaj mbretëri: Shqipëria 1914". ISHSN. Tiranë 2001.

organizatorëve. Gjatë monarkistë mbreti Zog megjithë reformat e thella në ndarjen e fesë nga shteti dhe reformimin e besimeve fetare, në një rast përdori masa ndëshkuese ndaj grupeve të ndryshme fetare (rasti i shkollave katolike dhe disa priftërinjve në Shkodër) për të dhënë mesazhe force ndaj Italisë dhe fqinjëve të tjerë⁴⁴. Lufta e Dytë Botërore në tërësi nuk krijoi raporte preferenciale midis trupave pushtuese dhe besimeve fetare, por pas luftës regjimi i ri komunist ndërmori fushata represive kryesisht ndaj komunitetit katolik dhe Kishës Katolike. Represioni vijoi në të gjitha aspektet (kufizimin e burimeve të financimit të komuniteteve fetare, arrestimin dhe denigrimin e drejtuesve fetarë, bllokimin e lidhjeve ndërkombëtare, sekuestrimin e literaturës fetare, mbylljen e shkollave dhe seminareve) dhe më 1967 nxjerrjen jashtë ligji të besimit fetar, mbylljen e të gjitha objekteve fetare dhe dënimin me 10 burg të predikimit fetar⁴⁵.

Në vitet '90 tranzicioni politik u shoqërua edhe me tranzicionin e besimit. Në disa raste u shfaqën përpjekje për të krijuar konflikt fetar përmes konfliktit politik. Shenja të tilla u shfaqën pas anëtarësimit të Shqipërisë në Konferencën Islamike (1992) si dhe me futjen në Shqipëri të dhjetëra organizatave humanitare nga vende të ndryshme të botës, përfshirë edhe vendet islamike. Politikanët mbajtën nën kontroll ambiciet dhe nismat ndarëse fetare të personave ose grupeve të caktuara, qoftë edhe duke bërë marrëveshje të heshtur. Kështu, në qytetin e Shkodrës gjithnjë u ruajt një raport i balancuar midis numrit të deputetëve katolikë e myslimanë, si dhe në mënyrë periodike kryetarë të bashkisë u zgjodhën përfaqësues nga secili besim. Raste të tilla u shënuan edhe në qytete të tjera ku përkatësia fetare është e balancuar. Ndërkohë një studim i realizuar më 2005 në tre partitë kryesore politike, PD, PS dhe LSI rezultoi⁴⁶ se nga grupet dominuese fetare tek demokratët ishin besimtarët myslimanë e katolikë, tek socialistët ateistët, myslimanët dhe ortodoksit, si dhe tek Lëvizja Socialiste për Integrim kryesonin besimtarët bektashinj. Të njëjtat përfundime rezultojnë edhe në analizën e përkatësisë fetare të individëve anëtarë të organeve të larta të këtyre partive, megjithëse në familjet e tyre, ashtu si në pjesën më të madhe të familjeve

⁴⁴ Sëire, Joseph: "Shqiperia, ngritja e nje mbretërie", Tiranë 2005.

⁴⁵ U.S. Library of Congress. Albania - A Country Study.

⁴⁶ Balla, Jonida: "Tipare të partive politike", FSHS, Tiranë 2005.

shqiptare, për shkak të martesave, janë krijuar identitete të përziera fetare.

Nga ana tjetër në momentet kyçe të zhvillimeve politike, siç ishin ndryshimet e vitit 1990, kriza e vitit 1991, kriza e vitit 1997, gjendja për shkak të Luftës së Kosovës më 1999, etj, komunitetet fetare shfaqën bashkëpunim dhe vullnet të fortë për të ndikuar bashkërisht në kapërcimin e krizave dhe në dhënien e mesazheve pozitive për të gjithë besimtarët e tyre. Në tërësinë e tyre, të gjitha komunitetet fetare përfaqësojnë linja reformatore dhe liberale, që respektojnë besimin tjetër dhe që mbi të gjitha besimet vendosin interesat e mëdha kombëtare, ashtu siç kishte frymëzuar dhe shprehur rreth një shekull më parë Vaso Pasha “feja e shqiptarit është shqiptaria”. Në përfundim vlen të theksohet se pavarësisht problemeve të shfaqura në momente dhe kohë të caktuara, ato kanë mbetur të veçuara dhe në tërësi partitë politike dhe komunitetet fetare kanë shfaqur partneritet, respekt dhe bashkëpunim të ndërsjellët, duke i kontribuar forcimit real të demokracisë dhe vlerave më të mira të shoqërisë⁴⁷.

Instituti i Statistikave (INSTAT) raporton se popullsia e Shqipërisë është 3-3.1 milion banorë⁴⁸, ndërkohë që burimet ndërkombëtare raportojnë për 710 mijë emigrantë shqiptarë në vendet e tjera⁴⁹. Në dokumentin “Strategjia kombëtare për emigracionin” hartuar nga qeveria shqiptare dhe IOM theksohet⁵⁰ se nga shifrat e mësipërme nuk janë përfundimtare pasi numri duhet të jetë më i lartë. Konkretisht raportohet se në Greqi jetojnë rreth 600 mijë shqiptarë, në Itali 250 mijë, në SHBA 150 mijë, në Britani 50 mijë, në Gjermani 15 mijë, në Kanada 11.5 mijë si dhe më pak në Turqi, Belgjikë, Francë, Zvicër dhe vende të tjera. Kjo pjesë e konsiderueshme e qytetarëve shqiptarë vazhdon të mbetet jashtë vendimmarrjes politike, gjë që e cenon sistemin e sigurisë dhe nëse nuk merr zgjidhje afatgjatë, ndikon në dobësimin e saj. Për shkak të saj rëndësie vlen të analizohet raporti midis partive politike dhe komuniteteve shqiptare në botë, si pjesë e rëndësishme e sistemit kombëtar të sigurisë. Në analizën 15 vjeçare të

⁴⁷ Konkluzione e Simpoziumit “Mbi harmoninë fetare: rasti shqiptar”, Tiranë, dhjetor 2003.

⁴⁸ INSTAT. “Raport mbi popullësinë”, Tiranë 2005.

⁴⁹ Papanagos, Harry / Sanfey, Peter: “Intention to emigrate in transition countries: The case of Albania”, in *Journal of Population Economics*, 2001.

⁵⁰ IOM / EU: “Strategjia kombëtare për emigracionin”, Tiranë 2005.

këtyre raporteve konstatohen dy tipare: ndërgjegjësimi në sritje për nevojën e reformimit të sistemit elektoral dhe përfshirjen e emigrantëve në votime si dhe për pasojë, nevoja për shtrirjen e aktivitetit të partive politike në të gjitha qendrat kryesore të komuniteteve shqiptare në botë.

Në këtë funksion, vitin e kaluar (2005) disa parti politike, përfshirë PD tashmë në pushtet, promovuan nevojën e përfshirjes së emigracionit shqiptar në botë në votimet parlamentare. Ideja e tyre u përkrah masivisht nga shoqatat e emigrantëve dhe grupet kulturore, por nuk gjeti zbatim. PS dhe aleatët e tyre në qeveri u treguan skeptikë ndaj kësaj ideje, ndërkohë që nga e majta, mjaft aktive u tregua LSI, e cila organizoi manifestime të mëdha elektorale në Gjermani dhe Greqi. Zgjedhjet parlamentare u mbajtën më 3 korrik 2005 dhe natyrshëm emigrantët nuk patën mundësi të marrin pjesë, megjithëse ata u përpoqën të ndikojnë në fushatën elektorale përmes deklaramit të mbështetjes për forca të caktuara politike.

Pjesëmarrja e tyre në votime u pengua nga disa faktorë objektivë, të cilët nuk u morën parasysh në debatin politik e publik, dhe që ende nuk kanë marrë një përgjigje përfundimtare. Konkretisht, pjesëmarrja e emigracionit në zgjedhje pengohet nga sistemi elektoral. Nga praktikat e vendeve të tjera është e qartë se emigracioni mund të përfshihet në votime vetëm në rastet e një sistemi zgjedhor proporcional. Qytetarët shqiptarë në vende të ndryshme e kanë të lehtë të votojnë subjektin politik dhe njëherësh thuajse të pamundur të votojnë kandidatët në sistemin mazhoritar. Vështirësi tjetër objektive është mungesa e të dhënave të sakta për emigracionin shqiptar. Të dhënat zyrtare të shteteve mikpritëse nuk përputhen me gjendjen reale, pasi është e qartë se numri i emigrantëve në këto vende është disa herë më i lartë. Një pjesë e madhe e tyre nuk janë regjistruar me identitetin e tyre të vërtetë, të tjerë kanë emigruar në mënyrë të paligjshme dhe nuk figurojnë në listat zyrtare, dhe një pjesë më e vogël e tyre janë regjistruar si qytetarë të Kosovës. Mungesa e një regjistri të saktë të emigrantëve shqiptarë në botë, e bën të pamundur ushtrimin e të drejtës së tyre kushtetuese të votës.

Faktor pengues gjithashtu është “parimi amerikan” i mishëruar në mënyrë të tërthortë edhe në legjislacionin shqiptar, sipas të cilit e drejta e votës vlen për të gjithë ata shtetas që janë taksapagues të rregullt të shtetit të tij. Shtetasit shqiptarë në vende të tjera nuk kanë

mundësi objektive për të paguar taksa personale në Shqipëri dhe si të tillë, formalisht janë të përjashtuar nga e drejta e vendimmarrjes përmes votës. Ky faktor ndikon pavarësisht se burimet zyrtare pranojnë se të ardhurat e siguruara nga dërgesat financiare të emigracionit zënë 1/6 e PBB dhe ato në total janë disa herë më të larta sesa ndihma e huaj që Shqipëria ka përfituar gjatë 15 viteve të fundit⁵¹. Pavarësisht nga kjo prurje jetike për ekonominë shqiptare, vetë shqiptarët emigrantë zyrtarisht nuk rezultojnë si pagues të taksave, megjithatë ata figurojnë në Listat zyrtare të Zgjedhësve në Shqipëri dhe nëse ditën e votimit ndodhen pranë familjes, i kanë të gjitha të drejtat dhe mundësitë të marrin pjesë në votime.

Sinjali i vetëm i rishikimit të kësaj politike është përpjekja serioze e ndërmarrë nga Bashkimi Evropian dhe Organizata Botërore e Migracionit (IOM) për të hartuar adresarin e saktë të shqiptarëve në botë, me synimin që në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009 ata të kenë mundësi të marrin pjesë në votime. Arritja e këtij synimi do të shënonte një pikë historike kthese në politikën dhe shoqërinë shqiptare. Shumëkush beson se shqiptarët “evropiane”, tashmë të integruar në shoqëritë demokratike perëndimore, do të ishin një kontingjent vendimtar elektoral për reformimin edhe të partive politike dhe politikbërjes në Shqipëri. Ky projekt vjen në kohën kur çështja e emigracionit në shtete të ndryshme si Greqia, Italia dhe vende të tjera ka pësuar reformime të thella. Konkretisht Italia dhe Greqia kanë iniciuar reformimin e sistemit të zgjedhjeve, duke lejuar emigrantët që plotësojnë disa kritere të arsyeshme, të marrin pjesë në strukturat e partive politike, madje edhe në votimet lokale. Partitë tilla si PASOK (Partia Socialiste në opozitë në Greqi) e kanë avancuar idenë e tyre për hapje ndaj emigrantëve, duke zgjedhur përfaqësues të tyre edhe në organet qendrore të partisë. Shembuj të tillë gjenden edhe në Itali, sidomos në partitë rajonale dhe në grupet qytetare që konkurrojnë në zgjedhjet lokale.

Lidhur me tiparin e dytë, prirjen e partive për zgjerim të aktivitetit politik në qendrat kryesore të emigracionit, problemi paraqitet sa ligjor aq edhe politik. Ligji për partitë politike në nenin 14 të tij thekson se “shtetasit e huaj që nuk kanë banim të përhershëm në Shqipëri nuk mund të marrin pjesë në formimin e një partie dhe as të jenë anëtar të

⁵¹ Po aty.

saj”⁵². Në kushtet e dyshtetësisë së lejuar nga shteti shqiptar dhe ekzistencës së emigracionit të vjetër dhe të ri, një dispozitë e tillë krijon probleme në zbatimin e saj. Gjatë 15 viteve kanë qenë jo të pakta rastet kur partitë politike, madje edhe ato që kanë patur mazhorancë parlamentare, kanë shpërndarë karta anëtarësimi për qytetarë dhe politikanë të huaj, të cilët i përjashton amendamenti i mësipërm. Rasti më i bujshëm është anëtarësimi publik në PS i ish kryeministrit italian Betino Craxi (1993).

E njëjta logjikë është ndjekur edhe në zbatimin e përcaktimit kushtetues dhe ligjor⁵³ për ndalimin e partive politike të krijuara jashtë Republikës së Shqipërisë (neni 7) apo e përcaktimit se “veprimtaria e partive politike mund të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose në disa njësi të ndarjes administrative territoriale të vendit”, (neni 5), pra vetëm brenda territorit të vendit. Në fakt, ndryshe nga kufizimi ligjor, në jetën politike shqiptare ekzistojnë disa parti politike të krijuara në shtete të ndryshme, kryesisht në SHBA, Belgjikë, Francë apo Itali, të cilat më pas kanë hapur zyrat përfaqësuese në Tiranë dhe me kalimin e kohës janë regjistruar si subjekte politike konkurruese në zgjedhje parlamentare dhe lokale. Lidhur me kufizimin e dytë, gjendja paraqitet e njëjtë. Në fushatën elektorale të vitit 1997 Fatos Nano, udhëheqës historik i Partisë Socialiste dhe disa herë kryeministër, zhvilloi një miting elektorale në Athinë. Ky aktivitet, përbën rastin e parë të një mitingu të një udhëheqësi politik dhe partive politike shqiptare në një shtet tjetër. Shembulli i Nanos u ndjek vite më pas edhe nga udhëheqësit e tjerë politik, përfshirë udhëheqësin historik të Partisë Demokratike, ish Presidentin Berisha. Gjithashtu gjatë viteve të fundit partitë kryesore politike në mazhorancë dhe në opozitë e kanë injoruar këtë kufizim ligjor, duke e shtrirë aktivitetin e tyre në vende të tjera. Partia Demokratike (PD) në qeveri kanë degë të tyre në SHBA, Belgjikë, Gjermani, Greqi dhe Itali. Partia Socialiste (PS) gjithashtu ka krijuar degë aktive në Greqi, Itali dhe vende të tjera. Së fundi ajo organizoi zgjedhje mbi bazë të parimit “një anëtar – një votë” në Athinë. Edhe parti më të reja politike si Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) kanë krijuar degë në disa vende

⁵² Fletore Zyrtare, Ligji Nr.8580, dt.17.2.2000, “Për partitë politike”, 3/2000.

⁵³ Po aty.

perëndimore. Modeli i krijimit të strukturave partiake në kënet e tjera është importuar nga Kosova, dhe kryesisht nga përvoja e organizimit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Deri më 1999 asnjë parti politike e Shqipërisë nuk kishte degë apo struktura në shtetet e tjera. Shqiptarët atje ishin integruar dhe e zhvillonin aktivitetin e tyre politik në kuadër të Lidhjes Demokratike të Kosovës ose partive të tjera politike kosovare.

Krahas zhvillimit të këtyre dy fenomeneve të rëndësishme në raportet midis partive politike dhe komuniteteve shqiptare në botë, janë konstatuar gjithashtu tipare negative; siç janë përpjekjet e organizuara për importimin e votës në favor të partive dhe kandidatëve të veçantë. Rasti i votimeve në Himarë apo disa zona të tjera kryesisht jugore, ku në prag të ditës së votimit, nga Greqia vijnë disa qindra e mijëra emigrantë të organizuar me mjete udhëtimi falas, me qëllimin publik për të votuar për kandidatët e Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, subjekt i njohur si parti e minoritetit grek. Përdorimi i mjeteve shtetërore (shteteve fqinje) dhe burimeve financiare për sigurimin e votave masive për parti dhe Kandidatë të caktuar, jo vetëm që bie në kundërshtim me ligjin, por edhe ka krijuar vazhdimisht tensione politike në vend. Për shkak të interpretimit politik si marrëdhënie midis dy shteteve, këto tensione janë shndërruar më pas në objekt kritikash dhe kundërshtish midis Shqipërisë dhe Greqisë, gjë që natyrshëm ka ndikuar edhe në sistemin e sigurisë kombëtare.

Një tipar tjetër thelbësor që e dallon realitetin shqiptar nga ai i shumicës së vendeve ish komuniste, por edhe që edhe me nxitjen e partive politike ndikon dukshëm në sistemin e sigurisë është reforma e papërfunduar e pronësisë së tokës. Kushtetuta (neni 41) si dhe Strategjia e Sigurisë Kombëtare (pika 51) vlerësojnë shenjtërinë e pronës dhe theksojnë se “ndërtimi i shoqërisë civile demokratike ka në themel respektin për njeriun e pronën”. Me zgjidhjen e çështjes së pronësisë mbi tokën lidhet zhvillimi ekonomik i vendit, ndarja me pasojat negative të së kaluarës, eliminimi i konflikteve sociale dhe rritja e nivelit të sigurisë për të ardhmen. Megjithatë problemi i pronave nuk ka marrë ende një zgjidhje të plotë dhe të drejtë.

Më 1945-1946 regjimi komunist shpronësoi pronarët e mëdhenj të tokave, rreth 200 familje, dhe ua shpërndau pronën në shifër

proporcionale rreth 150 mijë familjeve të tjera⁵⁴. Vetë pronarët nuk përfituan tokë, pasuria e tyre u sekuestrua dhe një pjesë e madhe e tyre përfundoi në burgje ose në kampet e internimit. Nën thirrjet për barazi regjimi krijoi një hendek të madh ideologjik e historik midis shumicës pa tokë, e cila me vendim qeverie u bë pronare, si dhe pakicës së pasur, e cila me vendim qeverie u shpronësua tërësisht. Reforma agrare u shoqërua me shtetëzimin e ndërmarrjeve private, investimeve të huaja si dhe të kapitalit të çmuar qarkullues, për të vijuar më pas me modelin stalinist të kolektivizimit të plotë të bujqësisë. Në korrik 1991 parlamenti pluralist miratoi me konsensus të plotë ligjin 7501 “Për tokën”, sipas të cilit, e gjithë popullsia fshatare bëhej përfituese, pronare ose shfrytëzuese e një mase të caktuar të tokave shtetërore dhe atyre të shtetëzuara⁵⁵. Me këtë ligj u arrit që përkohësisht të fillonte zhvillimi i tregut privat dhe të evitoheshin konfliktet sociale midis grupeve të ndryshme të popullsisë. Reforma e tokës qëndroi tabu deri më 1998, kur Shqipëria miratoi Kushtetutën e parë të periudhës demokratike. Kushtetuta sanksionon të drejtën e pronësisë, dhe ngarkoi parlamentin për nxjerrjen brenda tre viteve të ardhshme të ligjeve për rregullimin e çështjes së pronësisë. Parlamenti e përmbushi pjesërisht detyrën e tij gjashtë vjet më vonë, më 2004, kur mazhoranca e majtë miratoi Ligjin për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave. Në ndryshim nga ligji i vitit 1991, ai i vitit 2004 nuk siguroi konsensusin politik midis pozitës dhe opozitës. Për pasojë, mazhoranca e djathtë e ardhur në pushtet në korrik 2005 nisi menjëherë punën për një variant tjetër të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave. Krahas tij, më 2004 socialistët hartuan ligjin për legalizimet e banesave pa leje, të cilat përfaqësojnë rreth 150 mijë familje, të cilat gjatë 15 viteve të tranzicionit kishin migruar nga zonat e varfra në drejtim të periferisë së qyteteve të mëdha. Vetëm në Tiranë, për shkak të migrimit më 2005 rezulton se popullsia është shtuar me 300% në krahasim me 1992⁵⁶. Ligji gjithashtu nuk mori pëlqimin e opozitës së djathtë, e cila tashmë në qeveri, ka paraqitur një ligj tjetër për legalizimet. Në këtë mënyrë, dosja e kthimit dhe e kompensimit të pronës private të konfiskuar nga regjimi më 1945-46,

⁵⁴ ASH: “Reforma agrare 1945-46”, Tiranë 1965.

⁵⁵ Fletore Zyrtare 1991.

⁵⁶ Burimi: Instat 2005.

si dhe e legalizimit të ndërtimeve masive pa leje të kryera gjatë 15 viteve të fundit, vazhdon të mbetet e hapur, edhe pse ato mbeten dominuese në gjyqet civile, si dhe në kritikën e Bashkimit Evropian drejtuar Shqipërisë⁵⁷. Partitë politike kryesore, në nxitura nga interesa elektorale të momentit (1991, 1998 dhe 2004, 2005) më shumë sesa një zgjidhje të drejtë dhe afatgjatë janë përpjekur të gjejnë zgjidhje populiste, gjë që në vijimësi ka dëmtuar kapacitetet ekonomike dhe shanset e zhvillimit real të vendit.

Krahas pronësisë së tokës dhe legalizimeve në aktualitetin shqiptar shfaqen edhe probleme të tjera të mprehta, që lidhen me aspektin ekonomik të sigurisë kombëtare. Ndër më kryesoret është niveli i lartë i papunësisë, si dhe hendeku i zhvillimit ekonomik midis zonave të ndryshme të vendit⁵⁸. Pjesa më e varfër mbetet zona veriore në kufij me Kosovën dhe Malin e Zi, e cila gjatë viteve 1993-1996 u godit edhe nga konfliktet e përgjithshme në rajon si dhe nga embargo ekonomike e OKB ndaj Jugosllavisë.

I lidhur me faktorët e mësipërm dhe i theksuar në çdo raport ndërkombëtar për Shqipërinë dhe rajonin, problem shqetësues për sigurinë dhe demokracinë vijon të mbetet niveli i krimit të organizuar dhe korrupsionit. Lufta ndaj këtyre fenomeneve penguese për reformat dhe përparimin e vendit, zë një vend të rëndësishëm në prioritetet afatshkurtra dhe afatgjatë të Strategjisë së Sigurimit Kombëtar. Krizat sociale dhe politike në vend, dobësitë në zbatimin e vendosur të ligjit, klima e tensionuar në rajon gjatë një dekade, rritja e bashkëpunimit midis klaneve kriminale rajonale, etj, ndikuan në stimulimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Fillimisht (1991) krimi ishte dominues, më pas në mesin e viteve '90 abuzimi me pushtetin dhe aktet korruptive morën një zhvillim të madh. Më 1997 kriza e përgjithshme solli lulëzimin e krimit të organizuar dhe trafikëve, kurse në 4-5 vitet e fundit skandalet e korrupsionit dhe i abuzimit me detyrat shtetërore u bënë lajmi i përditshëm i medias. Aq shqetësues i bë ky fenomen, sa që në zgjedhjet e fundit parlamentare fitoi premtimi politik për luftë të ashpër ndaj korrupsionit.

Krimi i organizuar dhe korrupsioni mbeten rrezik për sigurinë dhe progresin, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për rajonin. Kjo u

⁵⁷ BE: Raport mbi Shqipërinë", 2004 / 2005.

⁵⁸ PNUD: Zhvillimi ekonomik dhe objektivat e mijëvjeçarit", Tiranë 2004.

dëshmuar në deklaratën përfundimtare të Samitit të Selanikut ku u theksua⁵⁹ se “krimi i organizuar dhe korrupsioni përbëjnë një pengesë reale të stabilitetit demokratik, shtetit ligjor, zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit të shoqërisë civile në rajon, si dhe një burim shqetësimesh të rënda për BE-në. Luftimi i tyre përbën një prioritet madhor” si dhe deklarimin e shefit të sigurisë së BE, Javier Solana, sipas të cilit⁶⁰, “krimi i organizuar është një pengesë për progresin e vendeve të rajonit dhe një rrezik për sigurinë e të gjithëve në këtu. Thjeshtë, ai duhet të ndalohet”. Në fakt, Shqipëria shënoi progres të madh në ndalimin e trafikut klandestin detar, por tragjedia në det në janar 2005 e 18 personave tregoi se bllokimi është i sforcuar dhe i përkohshëm. Vlen të theksohet se iniciativa e shteteve rajonale dhe e shteteve sponsorizuese (Gjermani, Itali, Greqi dhe Turqi) për ngritjen në qytetin e Vlorës (Shqipëri) të një qendre koordinimi në luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore dhe krimit ekonomik, u.. rezultoi një dështim. Vendet donatorë nuk u pajtuan rreth personelit, investimeve dhe sferës së veprimit, vendet e rajonit e panë atë si një privilegj për shtetin ku ndodhej, ndaj të gjithë të ndarë dhe më pas së bashku, ndihmuan në mbylljen e saj.

Një nga katër funksionet bazë të partive politike është rekrutimi i personave, të cilët prezantohen tek zgjedhësit dhe marrin poste politike në qeveri, parlament dhe institucione qendrore e lokale. Ato shprehin dhe formojnë shpresa dhe kërkesa publike për grupet dhe forcat shoqërore në sistemin politik, si dhe duke vendosur lidhje mes qytetarëve, grupeve shoqërore dhe sistemit politik, partitë politike ndihmojnë sanksionimin e rendit politik në vetëdijen e qytetarëve dhe grupeve shoqërore⁶¹. Në modelet e demokracive perëndimore pasoja e vetme negative e ushtrimit të këtyre funksioneve është rreziku i burokratizimit të partive dhe ftohja e elektoratit me to. Në demokracitë e reja ish komuniste aplikimi i funksionit rekrutues dhe përfaqësues bën dallim dhe në ndonjë vend, si Shqipëria dhe rajoni i Evropës Juglindore (duke përjashtuar Greqinë), pasojat negative i kanë sjellë një kosto të lartë procesit demokratik.

⁵⁹ BE: Deklarata përfundimtare, Samiti i Selanikut, Qershor 2002.

⁶⁰ Solana, Javier; BBC, Intervistë, 26.11.2002.

⁶¹ Sutor, Bernhard; nga “Politik. Ein Studienbuch zur politischen Bildung”, Paderborn 1994.

Në SSK partive politike u adresohet detyrimi për të ndërtuar institucione të besueshme demokratike, për zhvillimin e reformave modernizuese, për transparencë, stabilitet dhe normalitet në funksionimin e institucionet e sigurisë. Duke përjashtuar institucionet politike, në rend të parë dalin institucionet e tjera kushtetuese dhe ligjore, siç janë Policia e Shtetit, Ushtria, Shërbimi Sekret, gjykatat, shërbimin diplomatik etj, të cilat së bashku përbëjnë mekanizimin praktik të veprimtarisë së një shteti. Gjatë periudhës komuniste këto institucione ishin “armë besnike e tyre kundër armiqve të brendshëm dhe të jashtëm”, pra mekanizma të dhunës ideologjike të partisë – shtet me objekt kryesor “garantimin e rolit udhëheqës të Partisë së Punës, ruajtjen e shtetit të diktaturës së proletariatit, si dhe të fitoreve të socializmit”⁶². Për këto organe, objektivi kryesor i punës nuk ishin elementët kriminalë, vrasësit ordinerë, trafiket e ndryshme apo aktet korruptive, por individët dhe grupet që ushqenin kritika dhe pakënaqësi ndaj partisë – shtet dhe regjimit në fuqi. Vlen të theksohet fakti se në Shqipërinë komuniste nuk pati asnjë të dënuar me vdekje, të pushkatuar ose të varur në litar për veprën e krimit ndaj personet, ndërkohë që në rastin më të fundit, në tetor 1989 në qytetin verior të Kukësit u ekzekutua me varje në litar mësuesi disident Havzi Nela, i akuzuar për agjitacion e propagandë kundër regjimit, tentativë arratisje dhe synime terrori ndaj udhëheqësve të lartë komunistë. Ndër vite drejtuesit e institucioneve të sigurisë emëroheshin nga Byroja Politike, organi më i lartë i regjimit dhe i Partisë së Punës së Shqipërisë. Zakonisht drejtues të shërbimit sekret, ushtrisë dhe policisë ishin kandidatë ose anëtarë të Byrosë Politike, pra njerëzit më të besuar të diktatorit Hoxha. Me anë të këtyre instrumenteve besnike dhe të pamëshirshme, Hoxha ia doli ndër vite të eliminojë jo vetëm kritikët dhe rivalët politikë jashtë partisë, por edhe të gjithë bashkëpunëtorët e pabindur ose dyshues brenda saj. Pjesë e eliminimeve ishte edhe kryeministri më jetë gjatë në Evropën Lindore, Mehmet Shehu, i cili e drejtoi vendin midis viteve 1953-1981, si dhe drejtuesi shumëvjeçar i policisë dhe sigurimit të shtetit, Kadri Hazbiu (1949-1982). Në tërësi Hoxha, pasi përdori kundër njeri tjetrit, ekzekutoi të gjithë shefat e sigurimit në MPB, në ushtri dhe në

⁶² Platforma e Sigurimit të Shtetit dhe Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, KQ, Tiranë 1976.

shërbimin e jashtëm. Të njëjtin fat pësuan gjashtë nga shtatë ministrat e Brendshëm.

Megjithë reformimin e thellë ligjor, organizativ dhe metodik, deri 2-3 vitet e fundit nuk është pretenduar nga askush pavarësia reale politike e këtyre institucione themelore në fushën e sigurisë. Partitë vazhdimisht i mbajtën nën kontroll të plotë këto sektorë, dhe në tejkalim të ligjit i lejuan ato të bëhen pjesë e tyre në fushata elektorale dhe në luftën politike. Për më tepër, fillimisht demokratët dhe më pas socialistët emëruan në polici, shërbimin sekret, drejtësi dhe diplomaci, militantët e tyre më fanatikë.

Megjithëse interesat e vendit dhe përpjekjet për forcimin e shtetit të së drejtës kërkonin që në këto sektorë strategjike të kishte stabilitet pune dhe karriere, larg militantizmit dhe shërbimeve partiake, përvoja shqiptare mbetet unike në drejtim të kundërt. Konkretisht⁶³, gjatë viteve 1991-2006 Shqipëria ka ndërruar 19 Ministra të Brendshëm dhe 10 Ministra Mbrojtjeje dhe 8 Ministra të Jashtëm. Në aspektin statistikor kjo do të thotë një Ministër të Brendshëm në çdo 9 muaj. Vetëm gjatë viteve 1997-2005 kur në Shqipëri qeverisi e njëjta parti politike (PS), lufta e brendshme politike imponoi ndërrimin e 10 ministrave të Brendshëm, të cilët të krahasuar në të njëjtën periudhë, janë dy herë më shumë se Maqedonia, Sllovenia, Bullgaria, Çekia, tre herë më shumë se Mali i Zi, Serbia dhe Kroacia apo pesë herë më shumë se Gjermania⁶⁴. Rasti shqiptar bëhet edhe më shqetësues kur konstatohet se ndonëse të gjithë ministrat e Brendshëm kanë qenë politikanë karriere dhe kanë vijuar të jenë aktiv në partitë politike, asnjë prej tyre nuk është rizgjedhur në detyrë. Me ndërrimin e ministrave janë ndërruar edhe drejtorët e Përgjithshëm të Policisë, si dhe drejtuesit kryesorë në rrethe. Krahas policisë Shqipëria mban “rekord” me tre Prokurorë të Përgjithshëm të shkarkuar për abuzim me detyrën (1991, 1992 dhe 2002), si dhe me faktin se nga tre shefat e shërbimit sekret (1991-2002), një u burgos, një doli në gjyq dhe me presion politik i shpëtoi burgut dhe i treti nën akuzë të rënda emigroi familjarisht jashtë vendit. Shifra të tilla alarmante janë regjistruar edhe në Ushtri. Vetëm një nga 5-6 gjeneralët e vitit 1991 mbeti në

⁶³ Të dhënat janë marrë nga histoiku zyrtar në institucionet përkatëse.

⁶⁴ Krahasimet janë bërë gjithashtu nga burimet zyrtare të shteteve përkatëse.

shërbim më 1993, ndërkohë që asnjë nga 10 gjeneralët e vitit 1996 nuk ishte më në shërbim në fundin e dhjetorit 1997.

Vitet e fundit institucionet e mësipërme duket se kanë kapërcyer fazën e tranzicionit dhe po hyjnë në një fazë të pakthyeshme pavarësie dhe konsolidimi. Rotacioni politik i vitit 2005, në tërësi, e ka pranuar këtë tendencë të re, gjë që përbën një garanci që edhe në të ardhmen partitë politike të distancohen gjithnjë e më shumë nga institucionet strategjike të sigurisë. Kjo e bën të domosdoshëm edhe korrigjimin e politikave të partive politike ndaj këtyre institucioneve si dhe gradualisht heqjen e monopolit të tyre në emërimet, drejtimin dhe kontrollin e institucioneve ekzekutive të sigurisë.

POPULLI NË PESHOJË

Valentin Batalaku

Në rrethanat kur po zhvillohen negociatat ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve është krijuar një situatë paradoksale - situata e pritjes. Nuk është aq e rëndësishme forma, me rëndësi është të krijohet një koncept i ri unik për grupin negociator; diçka që është me përmbajtje dhe e kapshme për banorët e Kosovës, për proceset politike që tashmë kanë filluar. A duhet t'i ndryshojmë botëkuptimet tona për vetveten, para se të na ndryshojnë ndërkombëtarët? A duhet bartësit e faktorëve politik të angazhohen për diçka që është dinamike, e mëvetësishme apo t'i huazojmë kuturu klisjetë e tejkaluara të disa këshillëdhënësve, të cilët tashmë janë të konsumuar profesionalisht dhe moralisht? A duhet ta harxhojmë energjinë duke i përdorur frazat politike dhe idetë romantike?!

Koha kalon në mënyrë marramendëse, çdo gjë është në lëvizje, në zhvillim e në transformim të përhershëm dhe të pandalshëm. Asgjë nuk qëndron statike, asgjë nuk është absolute, asgjë nuk është ideale dhe e përkryer, asgjë nuk ka të dhënë njëherë e përgjithmonë prandaj edhe shoqëria kosovare gërshetohet me të kaluarën, të tashmen dhe me të ardhmen.

Pikërisht në këtë fazë nuk është për tu çuditur, kur në një anë Grupi i Kontaktit ia dorëzon Prishtinës planin prej 13 standardeve prioritare, e cila ka të bëjë me kthimin e të zhvendosurve, sigurinë, zgjedhjen e çështjeve pronësore që do të garantojë kthimin e pakicave në pronat e tyre, pastaj me sanimin e plotë të dëmeve si pasojë e ngjarjeve të marsit të vitit 2004 si dhe me zbatimin e ligjit. Kryeministrit Agim Çeku i mbeten 5 kurse Kryetarit të Kuvendit të Kosovës Kolë Berisha 8 standarde që t'i plotësojnë gjatë 4-6 muajve të ardhshëm.

Ndërsa, në anën tjetër Kryeadministratori Petersen paralajmëron largimin e tij nga Kosova. A mos është kjo një sinkronizim nga prapavija e qendrave të vendosjes ndërkombëtare, duke përfshirë kohëve të fundit edhe deklaratat e bëra nga ana e kryeprokurores së Tribunalit të Hagës, Karla del Ponte për mosbashkëpunim të UNMIK-ut me prokurorë të këtij tribunali? Përse në këtë fazë të proceseve bien

në anakronizëm veprimet e bashkësisë ndërkombëtare me atë vendore?

Në këto rrethana të reja vërehen disa procese integruese dhe dezintegruese, ku gërshetohen njëra me tjetrën, krijohet njëfarë interakcioni racional ose irracional në mes tyre. Bashkimi bën fuqinë-thotë fjala e urtë popullore. Por bashkimi bëhet nga shkaqe, interesa dhe rrethana të caktuara objektive dhe subjektive të individëve, faktorëve vendor politik dhe atyre të huaj ndërkombëtar. Ky integrim po nga rrethana e shkaqe të caktuara brenda saj riprodhon dezintegrimit-ndarjen. Mirëpo, për fat të mirë ende ekzistojnë njerëz që e kuptojnë kauzën e njëmendësisë së re që tashmë ka lindur, ku secili duhet të angazhohet në atë drejtim ku energjia të fokusohet në drejtim të filozofisë bashkëqeverisëse dhe natyrisht duke u respektuar parimet demokratike.

Kryeministri Çeku prej strukturave të përkohshme shtetërore politiko-ekonomike pret energji pozitive e jo konfliktuese. Po që se nuk respektohen rregullat më minimale të lojës dhe të ndërveprimit politik dhe atë ekonomik, atëherë nuk duhet të çuditemi kur na tërheqin vërejtjen ndërkombëtarët me punën joefikase të Qeverisë. Koha muhabetëve dhe thashethemeve ka kaluar. Mungesa e qeverisjes efektive, indiferenca ndaj të drejtave dhe përgjegjësisë të tyre qytetare, mospjesëmarrja e kuadrove profesionale në mënyrë aktive në sferën e ekonomisë, zgjidhja formale propagandistike dhe jo strukturore e çështjeve qendrore dhe lokale do të jenë faktorë dhe gjeneratorë që do të rrezikonin realizimin e atyre qëllimeve madhore që ka premtuar Kryeministri para Parlamentit të Kosovës. Kryeministri Çeku tashmë ka futur një dinamizëm në establishmentin e strukturave qeverisëse e përkrahur edhe nga mediat vendore dhe të huaja.

Incidenti ndërmjet policisë së UNMIK-ut dhe banorëve të Krushës së Vogël tregon, se është krijuar një situatë paradoksale, ku stabiliteti ekonomik për banorët serb të Kosovës do të ishte më e favorshme se sa banorëve shqiptar, të cilëve as që i dëgjohet zëri, lere më të kërkojnë ngritjen dhe përmirësimin e kushteve jetësore, financiare dhe dëmshpërblimin material dhe moral. Vizitat që i kanë bërë përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare qyteteve dhe fshatrave në Kosovë kanë qenë uniformuese me një shabllonizëm administrues, duke mos pasur parasysh specifikat dhe situatat që kanë ndodhur gjatë luftës?!

Mesa duket këto janë taktizime dhe lojëra serbe, për ti përforcuar pozitat e tyre negociuese, apo edhe diçka tjetër! Lideri i Listës Serbe për Kosovë Oliver Ivanović paralajmëron kthimin e serbëve në Kuvendin e Kosovës, ndërsa në anën tjetër pjesëtarët e njësisë speciale të SHPK-së, pas bllokimit të rrugës “Luan Haradinaj” dhe selisë së UNMIK-ut në Prishtinë, kanë rrahur dhe larguar nga rruga aktivistët e lëvizjes “Vetëvendosje”. Në Krushë të Vogël u lënduan 30 gra, burra dhe fëmijë, ndërsa, Kryeministri Çeku prononcohet para opinionit kosovar se protestat janë të panevojshme në kohën kur UNMIK-u është duke shkuar nga Kosova. Për çdo vit, koha e shkuarjes së UNMIK-ut ka qenë viti i ardhshëm. Popullin shumicë të Kosovës e ka kaplua sindromi i pritjes!

Çështjet politike që u eksploruan më lartë janë të ndërlidhura organikisht me zgjidhjen e çështjeve ekonomike. Siç dihet, para lufte ekonomia kosovare ka qenë e dirigjueme nga strukturat e atëhershme partiake, ku shumë pak është njohur lama e logjistikës dhe ekonomisë distributive. Fatkeqësisht edhe pas lufte vazhdon edhe më tej praktika e vjetër, ku tërë potenciali i huaj kadrovik po koncentrohet në atë se si konsumatorët kosovarë të përgatiten-dashurohen në prodhimet dhe shërbimet që ofrohen nga shtetet të cilët ata i përfaqësojnë. Të rinjtë dhe elita intelektuale kosovare tashmë e dinë se ato kohëra janë histori.

Për shkak të teknologjisë së re informative konsumatorët e tanishëm dëshirojnë çdo gjë dhe atë tani. Pra, po lind një ekonomi e tejngarkuar. Rezistenca po zëvendësohet me atë që është tërheqëse. A janë të përgatitur biznesmenët e ndërmarrjeve të vogla ekonomike në Kosovë me sfidat që do të përballohen në të ardhmen, atëherë kur do të vendoset statusi përfundimtar i Kosovës? Firmat e suksesshme këto sfida i njohin mirë, sepse i aplikojnë metodat e teknologjisë informative në veprimtarinë dhe afarizmin e tyre punues. Firmat prodhuese në Kosovë mund të mbijetojnë, vetëm nëse i përballojnë tregjet në atë mënyrë, ku do të ishin në gjendje t'i zvogëlojnë shpenzimet e transaksioneve.

Në shikim të parë, kjo ndoshta duket banale, mirëpo, si po doket ekonomia kosovare po i përngjan meteorologjisë. Kur duhet të prognozohet perspektiva ekonomike e Kosovës, ekonomistët dhe meteorologët kanë shumë çka të përbashkët. Kjo mund të krahasohet sikurse me klimën atmosferike. Temperatura dikton se çfarë duhet

mbathur njerëzit. Nëse jashtë është shumë ftohët, rrallë mund ta gjesh ndokënd duke shëtitur me pantallona të shkurtra. Ndoshta ndokush do të dilte jashtë, mirëpo nuk do të kishte kuptim. Informatat për ekonominë dhe afarizmin janë ato, çka janë temperatura dhe klima për meteorologjinë. Temperatura mund të jetë e lartë dhe e ulët. Informacionet mund të jenë me bollëk ose të pakta. Temperatura përcakton dhe dikton, se çka është më së miri të vishet. Informatat përcaktojnë, si dhe sa më efektivisht të organizohet tregtia dhe veprimtaritë tjera ekonomike.

Në përgjithësi, shpenzimet e afarizmit i shkakton mungesa e informatave (diçka nuk njohim) ose shpërndarja asimetrike e informatave (dimë ma tepër ose më pak, se sa të tjerët). Kur ka shumë informata dhe të shpërndara në mënyrë të njëtrajtshme, atëherë i fitojmë pazaret dhe dallaverxhitë. Dhe e kundërta kur ka pak informata dhe të shpërndara në mënyrë të jonjëtrajtshme krijohen organizatat, firmat, hierarkitë. Natyrisht këto forma organizative nuk lindin vetvetiu. Disa njerëz edhe më tutje do ti mbathnin gëzofët në kohë të nxehtë, ndërsa të tjerët nëpër borë do të shëtisnin me pantallona të shkurtra. Kështu me kohë disa organizata punuese, të cilat nuk i përshtaten trendëve informative, do të zhduken, sepse do t'i tejkalojnë konkurrentët me modelet organizative efikase. Koha e tregjeve uniformuese dhe imituuese është tejkaluar. Dikur në të kaluarën e lashtë po të njëjtën mënyrë janë zhdukur edhe dinozaurët. Nga ky vëzhgim që u theksua më lartë ndikimi i internetit në ekonominë kosovare është i njëjtë sikurse ngrohja e ajrit në klimën. Kosovën kohëve të fundit po e vërshojnë misionarët-teoricienët guru nga shtetet e ndryshme të botës me do farë projekte, ku po krijohet një përshtypje, se në Kosovë është krijuar një xhungël informatash, ku tregjet tashmë kanë filluar t'i tejkalojnë hierarkitë institucionale. Shembulli më i freskët është se SHPK-ja para disa ditësh ka ndërhyrë në disa lokale në Kosovë, ku ushtrohej biznesi "me zejen më të vjetër në botë". Pra, amoraliteti dhe sindromi i pritjes po e dikton kahen e veprimit të strukturave të përkohshme qeverisëse. Çdo fëmijë tashmë e ka kuptuar se demokracia brenda strukturave partiake dhe qeverisëse në Kosovë ka dështuar. Jemi ngopur me fjalime. Tash është koha të mbahen fjalët.

HIJET HEBREJE NË SHQIPËRI*

Mergim Korça

Duke ju referuar drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave Shqiptare z. Shaban Sinani, në shkrimin e vet z. Englantina Nasi për “Koha e Jonë”, thekson se, në asnjë vend tjetër, hebrenjtë nuk janë mbrojtur si në Shqipëri. Por tregon edhe detaje nga vendosja e tyre në vendin tonë, si dhe kushtet që e bënë të mundur atë. “Shumë hebrenj, përveç atyre që e kishin deklaruar rezidencën e tyre në Shqipëri, kanë ardhur duke u paraqitur si të krishterë apo myslimanë, me pasaportë shqiptare në Tiranë dhe Tetovë dhe konvertimi i tyre nuk është bërë as nga kishat e as nga xhamitë, por nga prefektë dhe nënprefektë. Përshembull, Saltiel - mbiemër i njohur hebré, e kanë bërë Sali. Po kështu, njihet historia e një Davidi që është bërë Daut nga një nënprefekt. Në Shqipëri ka pasur rreth 3 mijë “hebrenj” pohon Sinani.

Duke i analizuar këto pohime mendoj se, me ndonjë kujtim personal shtuar këtyre, edhe duke i u referuar dokumenteve të kohës e duke i kujtuar zotit Shaban Sinani se i bashkuar edhe vullneti i tij i mirë për t’u shërbyer të vërtetave historike, për vetë përgjegjësini që ai mbulon, si duket ka ardhur koha që ato të dalin në dritën e diellit ashtu siç kanë qenë. Zoti Shaban Sinani me guxim shkencëtari të drejtpeshuar pohon faktin se si “... konvertimi i shumë hebrenjve nuk është bërë as nga kishat e as nga xhamitë, por nga prefektë dhe nënprefektë ...” Kjo dritare e re e hapur më mbush me shpresë se ky shkencëtar mbase e ka kuptuar se me kalimin e dhjetëvjeçarëve do të jetë në nderin e tij që emri t’i përmendet si një hulumtues i cili duke i lënë në një anë dhe duke u rënë hasha bindjeve të tija të dikurshme, ka rishkruar të vërtetat historike. Vijmë konkretisht tek ndihma modeste që unë, një qytetar i thjeshtë, mund t’i jap zotit Sinani. ... e mbaj mend mirë sikur të ishte dje. Vjen një ditë në shtëpinë tonë miku i familjes dhe kryeministri i Shqipërisë, Mustafa Merlika Kruja dhe porsa hyn i thotë t’im eti, (i cili sapo ishte kthyer nga një inspektim i përgjithshëm i shkollave në Kosovë), a kishte pasur kontakt me ndonjë mësues ose

* nisur nga një pohim i z. Shaban Sinani lidhur me hebrenjtë

profesor hebré dhe ç'dinte t'i thosh më gjerë për hebrejtë e Kosovës. Babai i tha se miku i tyre i përbashkët z. Iljaz Agushi, (atëkohë ministër i Punëve botore), nëpërmjet vëllait të tij z. Isuf Agushi, e kishte paraqitur me një profesor hebré që kishte qenë dishepull i profesor Norbert Joklit dhe i cili kërkonte ndihmë që mundësisht t'a emëronin profesor të gjuhës shqipe në Gjimnazin e Prishtinës. Mbasi biseduan gjerë edhe gjatë lidhur me mikun e përbashkët, profesor Joklin, e mbaj mend se profesori hebré filloi nga puna. Kaq diti t'i thosh babai lidhur me kontakte me hebrejtë në Kosovë. Atëherë Mustafa Merlika Kruja i tha babait se duhej të merrnin masa urgjente për t'u ardhur në ndihmë hebrejve në Kosovë. I telefonuan ministrit të Punëve të Brendshme z. Mark Gjonmarkaj si edhe sekretarit të përgjithshëm të Kryeministrit, z. Engjëll Çoba dhe e lanë të mbledheshin menjëherë në zyrën e Kryeministrit.

Mbas disa ditësh mësova se Mark Gjonmarkaj kishte dërguar në krye të një ekipi të tërë prefektësh, nënprefektësh si edhe nëpunësish të besuar të Ministrisë së Brendshme, duke mobilizuar edhe të gjithë autobusët e shoqërisë S.A.T.A., zotin Engjëll Çoba në Prishtinë si i plotfuqishëm të pajiste me dokumente shqiptare si edhe me emra shqiptarë sa më shumë hebrejtë që t'ishte e mundur e t'i transferonte në Shqipëri.

Kaq kujtimet e mia. Megjithatë në asnjë mënyrë nuk pretendoj që këto kujtime z. Sh.Sinani t'i marrë si të vërteta historike. Por, nisur nga këto kujtime, mendoj se z. Sinani e ka mundësinë që në dokumentet arkivore t'ia gjejë fillin urdhrit me të cilin kryeministri Mustafa Merlika Kruja u dha rrugë atyre veprimeve pro-hebreje. Ai urdhër, pa as më të voglën mëdyshje, ka qenë pasuar edhe nga urdhra të nënshkruar e lëshuar edhe nga ministri i Punëve të Brendshme, Mark Gjonmarkaj. Besoj se me këto kujtime, bëhet edhe më i besueshëm pohimi i z. Shaban Sinani se si "... konvertimi i shumë hebrejve nuk është bërë as nga kishat e as nga xhamitë, por nga prefektë dhe nënprefektë ...". Në vijim mendoj se z. Sinani, për pozicionimin e tij shumë pozitiv që ka marrë lidhur me çështjen e shpëtimit të jetëve të hebrejve në Shqipërinë e viteve 1942 - 1944, do t'i shërbejë shumë si pikë referimi edhe pohimi i bërë nga Mëkëmbësi i Mbretit, z. Francesco Jacomoni, në faqet 288-289 të librit të tij titulluar : La politica dell'Italia in Albania (Politika e Italisë në Shqipëri) me botues Cappelli Editore botuar më 31 maj 1965, ku autori pohon tekstualisht : "Një demonstrim nga ana e

Mustafa Krujës i asaj që ishte -burnia- e tij, d.m.th. aftësia për t'i përballuar situatat me guxim si edhe zemërgjerësi, e pata pak kohë mbasi ai kishte marrë përsipër Kryesinë e Këshillit Ministror. Ishte paraqitur tek ai konsulli i përgjithshëm i Gjermanisë dhe i kishte paraqitur një notë verbale me të cilën qeveria naziste kërkonte dorëzimin e mbi treqind hebrenjve që, refugjatë nga Jugosllavia, kishin gjetur strehim në Shqipëri. Komanda ushtarake gjermane e Beogradit kishte dhënë njoftime të sakta lidhur me emrat si edhe vendet se ku ishin strehuar ata në Kosovën Shqiptare. Mustafa Kruja erdhi të më merrte lejen t'i linim të patrazuar në Shqipëri. Në Shqipëri në fakt nuk kishte asnjë këmbë ushtari gjerman që të mund t'i identifikonin. Megjithatë ramë n'ujdi që refugjatët hebrenj të transferoheshin menjëherë në zonën e Gjirokastrës e cila kufizohej me zonën greke, të okupuar nga trupat italiane. Ata do të pajiseshin me pasaporta shqiptare me emër fallso dhe, po të paraqitej nevoja, do të ndihmoheshin edhe materialisht. Këto masa do t'i lejonin Mustafa Krujës t'i përgjigjej mbas disa ditëve konsullit të përgjithshëm të Gjermanisë se si të gjitha hetimet e kryera në Kosovë lidhur me listat emërore kishin rezultuar negative. Roma nuk u njoftua zyrtarisht lidhur me këto zhvillime, por privatisht u informua drejtori i përgjithshëm i çështjeve rezervate, ministri fuqiplotë Vidau. Ai ishte njeri me zemër të gjerë dhe nëpërmjet tij mundësuam nëpërmjet përfaqësive tona jashtë shtetit, t'i pajisim hebrenjtë gjermanë, bohemë, polakë, ungerezë dhe rumunë me pasaporta shqiptare. Atyre u krijohet mundësia t'u shmangeshin persekutimeve raciale duke i drejtuar Shqipërisë." Lidhur me qëndrimin e mbajtur nga ana e kryeministrit Mustafa Merlika Kruja për shpëtimin e hebrenjve nga thonjtë e ndjekësve të tyre nazistë në Kosovë, dua të sjell edhe një dokument tjetër i cili pohon të njëjtën gjë nga një drejtim krejt i ndryshëm. Autori Harvey Sarnier në librin e tij me titull "Shpëtimi në Shqipëri" sjell kujtimet e pjesëtarit të familjes Naftali i cili kujton "... gjermanët ushtruan trysni ndaj italianëve (në Kosovë) që të arrestoheshin hebrenjtë e kështu u arrestua edhe familja e ime. Pastaj ne qemë dëshmitarë dhe pamë sjelljet e përsosura të shqiptarëve. Një grup gjykatësish shqiptarë erdhën me misionin që ne të na transportonin drejtë jugut për në Shqipëri. Ata e bënë këtë veprim të na i shpëtonin jetët tona dhe na transferuan në qytetin e Kavajës..." Mendoj se me këto kujtime si edhe dokumente që paraqita, në qoftë

... nga një pohim i z. Shaban Sinan, lidhur me hebrenjtë

se do të bashkohet edhe vullneti i mirë i z.Sh.Sinani, do të nxirren dokumenta arkivale që të vihet në dukje një kontribut sa njerëzor e gjithashtu edhe i guximshëm i vetë Kryeministrit Mustafa Merlika Kruja si edhe i gjithë ekipit qeveritar që ai drejtonte lidhur me trajtimin e problemit hebrenjtë në Shqipëri. Në vazhdim, përgjatë kësaj hullie, duhet vënë në dukje edhe kontributi i Këshillit të Naltë të Regjencës në mbrojtje të hebrenjve. Ngelën duke e gjykuar Patër Antonin se ka dalë në një fotografi duke pritur në takim gjeneralin gjerman Fitstum. E pastaj ? Kjo fotografi vërtetoka tradhëtin'e tij ? Po teksti se ç'i ka thënë atij gjeneralit në atë takim Patër Antoni, pse nuk shkruhet ? Ai që takimi ku Patër Antoni i kujtoi gjeneralit Fitstum se marrëveshja me Reichun, nëpërmjet të plotfuqishmit për Ballkanin, Neubacherit, ishte që trupat gjermane do t'a kishin territorin shqiptar vetëm si urë kalimi për në Greqi, pa i cenuar dhe pa ndërhyrë në çështjet e brendshme shqiptare ! Vetëm tridhjetë fjalë janë këto. Për gjysmë shekulli rresht këto tridhjetë fjalë kurrë nuk u zunë në gojë. Por këto tridhjetë fjalë sanksionuan, veç të tjerave, paprekshmërinë e qytetarëve izraelitë në territorin shqiptar ! Vetëm në Shqipëri edhe në Danimarkë, falë këmbënguljes së Këshillit të Lartë të Regjencës Shqiptare dhe Mbretërisë së Danimarkës, u vendos kjo marrëveshje midis Gjermanisë dhe këtyre dy shteteve sovraane. E ne mburremi si komb, dhe me plot të drejtë, për fatin e izraelitëve në Shqipëri ku asnjë prej tyre nuk u cenua. Por një pjesë të kësaj merite e ka edhe Patër Anton Harapi, si pjesëtar i Regjencës, së bashku me tre kolegët e tjerë anëtarë të saj, që regjimi diktatorial i pushkatoi e si pasojë "u harruan" edhe bëmat e tyre njerëzore edhe patriotike ! Edhe këto fakte kam shpresë se z. Sh.Sinani, duke e kuptuar se është në nderin e tij t'i qëmtojë edhe t'i nxjerrë në dritë, do t'a sqarojnë akoma më mirë se sa edhe si i ka ndihmuar Shqipëria hebrenjtë që të shpëtonte sa më shumë syresh nga holokausti ! Deri tashti u fol lidhur me qëndrimin zyrtar të administratës shtetërore shqiptare në ndihmë të hebrenjve, gjë e cila deri më sot ka pas kaluar padrejtësisht dhe krejtësisht në heshtje. Domsodo, në këtë kuadër, nuk mund të mos vlerësohet edhe kontributi i jashtëzakonshëm njerëzor edhe shpirtgjerë i dhënë nga familje të shumta shqiptare, emri i të cilave është shkruar në lapidarin e Kopshtit të Yad Vashem-it. Tregime të tilla i kam dëgjuar nga goja e miqve të mij Shaban edhe i biri Hilmi Hoxha, i cili ka qenë nga miqtë e mijë më të ngushtë, m'i kanë treguar Shpresa edhe i shoqi Metin Ruli,

se si edhe i ati i Shpresës i ndjeri Ali Kuçi, pushkatuar nga regjimi diktatorial, kishin strehuar familje hebrejsh. Histori të tilla ndihme njerëzore të pakufishme ndaj hebrenjve m'i kanë treguar edhe nga familja e nderuar krutane e Veselve, ajo gjirokastrite e Budove e të tjerë që nuk është vendi të trajtohen sot përgjatë këtij shkrimi. Dua ta veçoj në këtë kuadër tregimin që më ka pas bërë i ndjeri prof. Marko Menahem, i cili ishte strehuar nga familja e dëgjuar elbasanase Nosi, së cilës ai ia dinte për nder shpëtimin e jetës së tij. E ai, (Menahemi), e theksonte se i ndjeri patrioti Lef Nosi n'atë kohë mbulonte postin e Anëtarit të Këshillit të Regjencës, gjë për të cilën edhe u pushkatua në vazhdim nga diktatura. E kuptoj se duhet shumë kuraje civile si edhe ndershmëri që të pranohet se plejada e intelektualëve patriotë si Mustafa Merlika Kruja me gjithë misat e qeverisë së kryesuar prej tij e gjithashtu edhe Patër Anton Harapi me bashkëregjentët shokë të tij, kanë vepruar si më sipër lidhur me shpëtimin e hebrenjve në Shqipëri. Kjo sepse përgjatë të gjithë periudhës diktaturës së kuqe jo që këto të vërteta u mohuan por edhe vetë autorët e ndihmës hebrenjve, me që antikomunistë u cilësuan tradhtarë edhe u pushkatuan e u persekutuan nga pushteti komunist. Por e vërteta është e vërtetë dhe është në nderin e atij që e nxjerr në shesh. Në rastin konkret, po i thelloi hulumtimet dhe t'i nxjerrë të plota në dritën e diellit këto të vërteta, do të jetë në nderin e z. Shaban Sinani një veprim i tillë.

HEBRENJTË NË KOSOVË

Mr. Albert Ramaj

Historia e hebrenjve të Kosovës nuk është e ngjashme me atë të Shqipërisë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore ka raste individuale të ndihmës dhe të mbrojtjes së hebrenjve në Kosovë, por njëkohësisht është e vërtetë e pamohueshme se Waffen-SS Divizioni fashist shqiptar “Skënderbeu” (“Skanderbeg”), i përbërë kryesisht nga kosovarët, dërgoi në kampin nazist Bergen-Belsen afër Hannover-it rreth 500 hebrenj. Kjo është një e vërtetë që nuk duhet të na frikësojë...

Gjurmët e para në trojet shqiptare

Prej shekullit të shtatë pas Krishtit mund të gjenden gjurmë e hebrenjve në Shqipëri. Këtë e kanë argumentuar edhe hulumtimi që ishte bërë para dy vitesh në Sarandë. Sipas dy profesorëve hulumtues nga Izraeli, Ehyd Netzer e Gideon Foerster, në bashkëpunim me Institutin Arkeologjik në Tiranë, në krye me prof. Muzafer Korkutin, erdhën deri te përfundimi se bazilika e Sarandës, e ndërtuar në shekullin VI, më parë ishte një sinagogë. Duhet të theksojmë se në rajon ka gjurmë edhe më të hershme të pranisë së hebrenjve, sikur që është sinagoga në Shtip (sot Maqedoni), që daton prej shekullit II, si dhe disa monumente mbivarrore të shekullit IV të hebrenjve në Mal të Zi. Këtu kemi të bëjmë me hebrenj “romaniot”, që ishin në këto troje në atë kohë. Në Shkup është ndërtuar sinagoga qysh në vitin 1361, në Durrës ka shenja të popullimit të hebrenjve qysh në vitin 1281 dhe në Kosovë qysh më 1442 janë të argumentuara gjurmët, sikur ato në Novobërdë. Kurse në Shqipërinë e Jugut, pikërisht në Janinë, mund të gjinden shenjat e popullatës hebraike qysh në shekullin e XII. Ardhasakët e parë hebrenj, që i cekëm deri më tani, duhet të kishin

ardhur nga bashkësia e vjetër hebraike e Selanikut. Judenjtë sefarikishin ardhur në territorin e Perandorisë Otomane nga ishulli Iberik në vitin 1492 dhe në fillim të shekullit të XVI. Përmes qyteteve bregdetare Durrës dhe Vlorë, ata erdhën edhe në Berat dhe Elbasan. Ata kanë lënë edhe gjurmë arkeologjike dhe historike në këto vende. Sipas autorit Schukalla, është më se i sigurt se politika antihebreje e Papës Palit IV (1555-1565) i detyroi ata të gjenin vendstrehim në Shqipëri.

Sabbatai Zevi dhe dorëshkrime të Thora-s

Pseudomesia mistik i hebrenjve, Sabbatai Zevi, kishte kaluar ditët e fundit të jetës së vet në Shqipëri. Ai kishte jetuar në ekzil në Ulqin dhe Berat. Ka dy teori për varrin e tij, njëra thotë se është i varrosur në Berat, kurse tjetra thotë se eshtrat e tij pushojnë në Ulqin. Ai ka vdekur më 1673 dhe varri i tij është në Ulqin, e jo në Berat.

Është më rëndësi të theksohet se kishte disa dorëshkrime jashtëzakonisht të vlefshme në Vlorë, që ishin ruajtur më shumë se 500 vite, deri në vitin 1930, kur ato pa kurrfarë gjurme dhe në mënyrë tinëzare u shmangen nga Shqipëria. Këto dorëshkrime ishin pjesë të Thora-s, konkretisht Sefar Thora. Vlora, gjatë viteve 1519-1520, ishte bërë një lloj qendre në rajon. Kështu, në vitet e lartpërmendura, në Vlorë kishte 609 shtëpi të hebrenjve. Sinagoga ishte deri gjatë Luftës së Parë Botërore, kur edhe u shkatërrua.

Më 1910, xhonturqit bënë një regjistrim të popullatës në vilajetin e Janinës. Në bazë të këtij regjistrimi, në këtë vilajet jetonin 5077 hebrenj, në Manastir 6497, në Kosovë 3171. Bashkësitë më të mëdha hebraike ishin në Manastir, me 6435 frymë, Janinë me 4373, Shkup me 2327 dhe Prevezë me 431 hebrenj. Të gjitha këto vende ishin jashtë kufijve të Shqipërisë së sotme. Në vitin 1930 është bërë në Shqipëri regjistrimi i popullsisë dhe zyrtarisht, këtë vit, ishin të deklaruar vetëm 204 hebrenj. Bashkësitë hebraike janë të njohura zyrtarisht si bashkësi në Shqipëri, më 2 prill 1937.

Personalitetet hebraike për kulturën shqiptare

Kishte disa personalitete hebraike që i kishin shërbyer kulturës, politikës dhe jetës publike shqiptare, siç është rasti i Aleksandër Moisiu, aktorit të njohur vjenez, që luajti në Burgtheater të Vjenës. Duhet cekur këtu se edhe presidenti i sotëm i Shqipërisë, Alfred Moisiu është po ashtu i të njëjtës familje Moisiu, sikur kushëriri i tij Aleksandri, kështu që, rrjedhimisht, edhe presidenti Moisiu është me prejardhje hebraike. Aktori i njohur i filmit gjermano-austriak Komisar Rex Gideon Burkhard është stërnipi i Aleksandër Moisiut, kështu që edhe ai është me prejardhje hebre.

Kishte hulumtues shumë të njohur, që kishin prejardhje hebraike dhe që kishin kontribuar shumë për historinë, kulturën, politikën dhe në përgjithësi për popullin shqiptar. Duhet të cekim së pari Norbert Jokl nga Vjena. Ai ishte shkencëtar i kalibrit të lartë dhe ishte hebre. Më 1942 gestapot e morën Jokl dhe e dërguan në ndonjë kamp të përqendrimit, kështu që as sot e kësaj dite nuk dihet fati i tij se si kishte përfunduar. Me vete Jokli kishte marrë edhe manuskriptin e fjalorit të porsapërfunduar etimologjik të gjuhës shqipe, një punë me shumë vlerë që u zhduk përgjithmonë. Milan Sufflay ishte hebre nga Kroacia. Ai ishte një ndër njohësit më të mirë i të gjitha kohërave historisë mesjetare shqiptare. Ai kishte publikuar disa vepra dhe shumë artikuj (edhe një roman) mbi historinë e mesjetës shqiptare. Ndër veprat kryesore të tij janë edhe "Acta Albaniae I, II". Kurse "Acta Albaniae III" dëshironte ta kryente, por nuk ia lejonin kushtet financiare. Parlamenti shqiptar, duke vlerësuar veprat e Milan Sufflay-t, e ndihmoi financiarisht atë. Më 1930 Parlamenti ia deponoi 75.000 franga ari Shufflay-t në një konto private te Banque Commerciale de Bale a Zurich të Zvicrës. Vlera e sotme e kësaj shume duhet të jetë rreth 4 milion dollarë amerikanë. Pas pak kohe, Shufflay vritet nga nacionalistët serbë në Zagreb, kështu që këto para mbetën edhe sot e kësaj dite në këtë bankë dhe nuk iu kthyen Shqipërisë.

Nuk duhet lënë anësh as Leo Frenlich me veprën e tij që tërë botës ia bëri të ditur për gjendjen e rëndë të popullit shqiptar më 1912-13, që botoi në Vjenë me titull "Albaniens Golgotha" (Golgota shqiptare). Ai ishte po ashtu hebre.

Këtu duhet të përmendim edhe përkthyesin e njohur Robert Schwarz, që jetoi në Shqipëri dhe me veprat e tija të përkthyer në gjuhën shqipe dha një kontribut jashtëzakonisht të madh për kulturën shqiptare.

Hebrenjtë në Shqipëri, një rrëfim më vete

Disa vende të Evropës qysh më 1933 kishin ligje antisemite. Shqipëria po ashtu e kishte një ligj të tillë, por autoritetet dhe populli shqiptar nuk e vuri në veprim atë. Ky ligj ishte diçka në lidhje me udhëtimin e hebrenjve nga vendet tjera në Shqipëri. Shqipëria, siç u dëshmuar më vonë, ishte një vend ku hebrenjtë mund të gjenin strehim të sigurt. Asnjë hebre vendor në Shqipëri nuk iu dorëzua autoriteteve naziste, porse kishte shumë prej tyre që kishin ardhur për t'u strehuar nga vendet e tjera të Evropës. Autorë të ndryshëm e kanë hulumtuar këtë fenomen dhe kanë i kanë kërkuar shkaqet dhe arsyet e një fenomeni të këtillë. Sipas tyre, kjo gjë ka të bëjë me fjalën e dhënë, pra me Besën. Kurse në aspektin politik pse nuk u dorëzuan hebrenjtë në ndonjë kamp të përqendrimit, janë të ndryshme, por mbi të gjitha meritën më të madhe e ka politika e Mbretit Zog në Shqipërinë e asaj kohe.

Është interesant fakti se ambasada shqiptare në Berlin kishte lëshuar viza deri më 1938 për hebrenjtë që dëshironin të gjenin strehim në Shqipëri. Kjo për vendet evropiane ishte e pamundur, të ndodhte ende në këtë vit diçka e tillë. Kështu, në Shqipëri kishin ardhur hebrenj nga shumë vende, për t'iu shmangur nazistëve. Kishin ardhur nga Gjermania, Austria, Jugosllavia, Rumania, Bullgaria, Egjipti, Anglia, Polonia, Turqia etj. Kishte edhe hebrenj prominent që kishin ardhur në Shqipëri, sikur prof. Stanislav Zuber, shkrimtari dr. Leo Mathia apo Joli Jakob. Dr. Finer, profesor në Londër, kishte kërkuar të vinte në Shqipëri, me përcjelljen e John Walter, i biri i drejtorit të gazetës "Times". Qëllimi i ardhjes së tyre ishte që të merrnin më shumë informata për mundësinë e ardhjes së hebrenjve në Shqipëri. Sipas Shaban Sinanit, në këtë kohë duhet ta kishte vizituar Shqipërinë edhe Albert Einstein. Si dëshmi për këto ngjarje në Shqipëri, kohëve të fundit janë shkruar disa libri, siç është libri i Harvey Sarnet me titull „Rescue in Albania: One hundred percent of Jews in Albania rescued from Holocaust“ (California, 1997). Një libër tjetër është i Johanna Neumann, me titull

„Via Albania“ në gjuhën angleze, në gjermanisht është e njohur me këtë titull „Umweg über Albanien“, në të cilin përshkruhet udhëtimi dhe qëndrimi i saj në Shqipëri, nga Hamburgu i Gjermanisë. Është interesant fakti se Shqipëria, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore kishte më shumë hebrenj, sesa në fillimin e saj. Hebrejtë nga Shqipëria iu drejtuan edhe Papës Piut XII për ndihmë.

Pas Luftës së Dytë Botërore judenjët ikën nga Shqipëria dhe shkuan në drejtim të atyre vendeve prej nga kishin ardhur, apo në SHBA, duke marrë më vete edhe një numër të hebrenjve vendas. Ndërsa, pas rënies së komunizmit, nga Shqipëria për në Izrael janë shpërngulur edhe rreth 300 hebrenjtë e fundit. Këtë e ka ndihmuar qeveria izraelite, në dhjetor të vitit 1900 dhe maj 1991. Kjo shpërngulje është edhe fundi i historisë së popullatës hebraike në Shqipëri.

Në librin e saj “Arratisje përmes Ballkanit”, Irene Grunbaum, që gëzoi mbrojtjen shqiptare gjatë luftës, shkruan: *“Lamtumirë Shqipëri. Ti më dhe kaq shumë mikpritje, mbrojtje, miq dhe aventurë. Lamtumirë Shqipëri. Një ditë do t’i tregoj botës sa të guximshëm, të pa frikë, të fortë e besnikë janë bijtë e tu; se si vdekja e djalli nuk mund t’i frikësojë ata. Po të jetë e nevojshme unë do të tregoj se si mbrojtën ata një refugjate e nuk lejuan që ajo të dëmtohej, edhe në se një gjë e tillë do të thoshte humbje e jetës së tyre. Dyert e vendit tënd të vogël mbetën të hapura, Shqipëri. Autoritetet e tua mbyllën sytë, kur qe e domosdoshme për t’i dhënë njerëzve të varfër e të persekutuar edhe një mundësi për t’i mbijetuar më të tmerrshmes së të gjitha luftërave. Shqipëri, ne ja dolëm të mbijetojmë ndaj rrethimit për hir të humanizmit tënd. Të falënderojmë ty.”*

Në Kosovë, pak më ndryshe

Duhet të theksojmë një fakt, se hebrenjtë në Kosovë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, për fat të keq, nuk kishin kaluar sikur në Shqipëri. Disa autorë shqiptarë janë të mendimit se në Kosovë hebrenjtë ishin të mbrojtur nga ana shqiptare dhe nuk iu kishin dorëzuar nazistëve. Së pari, duhet cekur faktin se bashkësitë hebraike në Kosovë ishin më shumë të lidhur me popullatën serbe dhe këto bashkësi, jo vetëm në Prishtinë por edhe në Prizren apo gjetiu në Kosovë. Në shkrimet që bëhen në media, theksohet se hebrenjtë në Kosovë janë tradhtuar nga

serbët, siç ishte organizatën fashiste serbe me emrin "Zbor", apo edhe ndonjë teori tjetër që mund të ndërlidhet me serbët dhe me përgjegjësinë e tyre për deportimin e hebrenjve nga Kosova në ndonjë kamp përqendrimi. Duhet të jemi shumë të qartë në këtë pikë, se për deportimin e hebrenjve në kampe të përqendrimit është përgjegjës Waffen-SS Divizioni shqiptar „Skënderbeu” (“Skanderbeg”) dhe kësaj të vërtete nuk kemi përse t’i frikësohemi. Hebrenjtë e Kosovës, që kishte lidhje të mira me shqiptarët e Shqipërisë, u strehuan në Shqipëri. Po të qëndronte teoria se hebrenjtë e Kosovës ishin të sigurt, si ndodhi që ata të iknin në Shqipëri. Ka pasur edhe raste të veçanta, por në përgjithësi hebrenjtë kanë kaluar keq në Kosovë.

Më 1941 shumë hebrenj erdhën nga Kroacia e Serbia dhe kërkuan strehim në Kosovë. Në fillim janë pritur mirë. Duhet përmendur faktin se edhe në administratën e Prishtinës në atë kohë kishte persona që u jepnin hebrenjve dokumente false, vetëm të shpëtonin jetën e tyre. Këtu duhet cekur sekretarin e Bashkisë së Prishtinës në atë kohë, Preng Ulin. Po ashtu, kishte edhe njerëz të autoriteteve lokale në Prishtinë, që kërkuan nga komanda italiane që të ndihmohen hebrenjtë të iknin në Shqipëri, për të shpëtuar jetën. Disa prej tyre arritën të shkonin në Shqipëri dhe u vendosën në Berat, një grup rreth 100 syresh, rreth 80 në Pezë, në prill të vitit 1942, dhe korrik 1992 rreth 100 u nxorën nga burgu i Prishtinës dhe u dërguan në Kavajë, Krujë e Burrel. Duhet të dallojmë një gjë, se popullata shqiptare në Kosovë kishte mbrojtur hebrenjtë, por ishte aty edhe Waffen-SS Divizioni fashist shqiptar “Skënderbeu” („Skangerbeg“), që në mënyrë të organizuar kishte tubuar hebrenjtë dhe i kishte dorëzuar te gjermanët. Për këtë divizion, që përbëhej nga shqiptarët, heshtin të gjithë autorët tanë. Ky divizion, në prill të vitit 1944, arrestoi rreth 300 hebrenj dhe i dërgoi në Prishtinë, prej nga u dërguan në kampin e përqendrimit në Gjermani, në Bergen-Belsen afër Hannover-it. Më vonë u dërgua edhe një grup tjetër, përsëri nga divizioni nazist "Skënderbeu" ("Skanderbeg"). Gjithsej duhet të jenë dërguar rreth 500 hebrenj nga Kosova në kampin e përqendrimit Bergen-Belsen. Rreth 100 prej tyre kanë mbijetuar. Për këtë akt, duhet t’u kërkohet falje hebrenjve për atë që kanë përjetuar në Kosovë.

Literatura: EVROPIAN I SHQIPTARËVE

ELSIE Robert, Handbuch zur albanischen Volkskultur, Wiesbaden 2002

KOHL Christine von, Albanien, München 2003.

LIOLIN Arthur, Of Albanians and Jews in: Illyria, New York, Februar 1995.

SCHUKALLA K. J., Nationale Minderheiten in Albanien. In: Albanien. Göttingen 1993. S.514-516.

SINANI, in Gazeta Shqiptare 26 Januar 2004. und www.albanisches-institut.ch

SCHMIDT-NEKE Michael. Albanien-ein sicherer Zufluchtsort? in: Solidarität und Hilfe für Juden während der NS-Zeit. (Reihe Solidarität und Hilfe; Bd.3). Hg. Benz W. und Wetzek J. Berlin, 1999. 247-270.

LIOLIN Arthur, Of Albanians and Jews in: Illyria, New York, February 1995.

SARNER, Harvey. Rescue in Albania: One hundred percent of Jews in Albania rescued from Holocaust“, Cathedral City, California, 1997.

PLAKU Z., “Hebrejtë nga Kosova 2 vjet në shtëpinë time, Isuf Qolja”, in: Gazeta Shqiptare, 12.III. 2004.

FISCHER, Bernd J., The Jews of Albania during the Zogist and Second World War Periods (Hebrejtë e Shqipërisë gjatë periudhës zogiste dhe luftës së Dytë Botërore. in: www.albanisches-institut.ch

NEUMANN J., Umweg über Albanien, Bochum 2003

BREMER Jörg, Die Heimkehr der albanischen Juden nach Israel. in: FAZ, 8.5 1991,106, S. 5.

PESHA E FJALËS

që përbehet nga shqiptarët, hebrejtë të gjithë autorët tanë. Ky detyrë në prill të vitit 1941, arrestoi rreth 100 hebrenj dhe i dërgoi në Prishtinë, prej nga u dërguan në kampin e përqendrimit në Gornje në Bergen-Belsen afër Hannover-it. Më vonë u dërgua edhe një grup tjetër, përseri nga divizioni nazist "Skenderbeu" ("Skanderbeg"). Gjithësej duhet të jenë dërguar rreth 300 hebrenj nga Kosova në kampin e përqendrimit Bergen-Belsen. Rreth 100 prej tyre mbijetuan. Për këtë akt, duhet t'u kërkohet fajësi hebrenjve për atë që kanë përjetuar në Kosovë.

IDENTITETI EVROPIAN I SHQIPTARËVE

ISMAIL KADARE

Sprovë

1
Në shkurt të vitit 2006, kryekomisioneri i Këshillit të Evropës, Baroso, fluturoi me avion për në Tiranë, për nënshkrimin e Marrëveshjes së Shqipërisë së vogël me kontinentin e madh evropian. Disa vite më parë fjala “marrëveshje” e përdorur për Evropën, do të ishte fatale në Shqipëri, madje aq fort, saqë do të çonte në burg ose në pushkatim cilindo. Për Evropën ishte e përshtatshme vetëm një fjalë, ajo e kundërta me marrëveshjen, pra “mosmarrëveshja”. Mosmarrëveshje e plotë, e palodhshme, e përjetshme. Ky ishte urdhri numër një i kohës. Programi i pandryshueshëm komunist. Thënë ndryshe: verdikti kundër Shqipërisë. Në dhjetor të vitit 1990, ky verdikt u shkel me këmbë e u thye. Fjalët “e duam Shqipërinë si Evropa”, ishin të parat që gjëmuuan në trajtën e një himni, e një programi të ri. E bashkë me to, disa javë më pas, shtatorja e njeriut më antievropian që kishte njohur ky vend, u thye e u zvarrit gjithashtu. Që nga ajo kohë Evropa, më saktë Evropa atlantike nuk pushoi së qeni xanxa kryesore për shqiptarët. Më 1997, kur për turpin tonë, shteti shqiptar ra, ishte Evropa që na u gjend në fatkeqësi. S’na erdhi ashtu siç e kishim pritur: me viza, para dhe, Zoti e di çfarë, por me armë dhe topa, për të na pajtuar me njëri-tjetrin. Përpara se Evropa me NATO-n të merrnin këtë vendim të madh, disa herë u ngrit dyshimi se mos shqiptarët e ndërkyer, ashtu të armatosur siç ishin, të qëllonin trupat ndërhyrëse. Për fat të mirë, kjo nuk ndodhi. Midis marrëzisë, populli shqiptar e bëri së paku një gjë të mençur. Në vendin ku mosprekja e kufirit prej çizmes së ushtarit të huaj, ishte kthyer në mit, asnjë armë, qoftë edhe për zakon, nuk u shkreh kundër ushtrisë euroatlantike. Ishte hera e parë që në historinë shqiptare ndodhte një gjë e tillë. Ajo ishte një dëshmi e madhe: dëshmi prekëse, se atë ushtri që po zbarkonte nga deti dhe nga ajri, shqiptarët e quajtën si të tyren. Vetvetishëm midis kaosit, pa retorikë integruese, pa u shtyrë prej askujt, shqiptarët treguan qartë se ndiheshin evropianë. Ata nënshkruan kështu një akt monumental: rigjetjen e Evropës së humbur. Dy vite më pas, si një përgjigje e mirëkuptimit, ndodhi e pabesueshmja. E njëjta ushtri euroatlantike, me avionë,

raketa e bombardime, ndërhyri për çlirimin e Shqipërisë së jashtme, Kosovës. U duk sikur kontinenti mëmë, i penduar për harresën e gjatë, po kujtohej më në fund për popullin e braktisur.

2

Nëse marrëdhëniet e Evropës me më trillanin e tre gadishujve të saj jugorë, Ballkanin, mund të thuhej se ishin kundërthënëse, ato me shtetin e vogël shqiptar, e kapërcenin çdo përfytyrim. Përpara se të kujtojmë tepër shkurt kronikën historike, le të sjellim ndër mend vitet e tranzicionit, ato që i mbajnë mend të gjithë. Fill pas dehjes së parë për Evropën, madje mu midis dalldisjes për të, nuk u bë e qartë asnjëherë se çfarë e shtyu qeverinë e parë demokratike të bënte një lëvizje kundërthënëse. Krejt si një shpend i verbër, një dërgatë shqiptare fluturoi me avion për në Xhedal, fluturim pas të cilit Shqipëria u gdhi në Ligën Islamike. Opozita e majtë bëri njëfarë zhurme, kundërshtuese, që u quajt me të drejtë e pasinqertë, ngaqë kur ajo vetë erdhi në pushtet, nuk bëri asgjë për ta rishqyrtuar anëtarësimin ende të paratifikuar në Parlament. Kjo u shpjegua dymënyrash. E para, se opozitës, së akuzuar, për shkak të liderëve të saj, si grekofile, i interesonte një ngjyrim i tejshquar islamik për t'u mjegulluar filogreqizmi i saj. E dyta, hotelet e shtrenjta të Dubait, të shoqëruar, ndoshta, nga dhurata të shtrenjta, ishin mjaft joshëse gjithashtu për të majtën. Kur u duk se, pas kësaj turbullire, njëfarë konsensusi u arrit midis dy krahëve kryesorë politikë, të djathtës dhe të majtës, lidhur me Evropën, kur u duk se u kapërcye disi edhe xhelozia e secilës palë, që futjen në Evropë ta kryente ajo e kurrsesi pala tjetër; shkurt, kur u duk më në fund se dritëza e shumëpritur në anën tjetër të tunelit po shfaqej, në vend të kthjellimit të strategjisë politike shqiptare, ca re të zeza e mbuluan horizontin. Ishin ca hamendje përherë e më shqetësuese, ca si mëdyshje kinse filozofike, kinse hamletiane: jemi apo s'jemi evropianë. Të jemi a të mos jemi të tillë. Është Shqipëria Evropë, a s'është Evropë. Është Lindje à Perëndim. Është më shumë Perëndim se Lindje. Është më shumë myslimane se e krishtere. Është edhe ashtu edhe kështu. S'është as ashtu, as kështu etj., etj. U dukën si përçartje komike në fillim. Ndërkaq, hamendjet e hamletizmat sa vente shtoheshin. Le ta themi më mirë haptas atë që kemi fshehur. Përse të hiqemi ata që s'jemi? Përse, hiqemi si evropianë, kur dihet që s'jemi të tillë? Shkurt, përse të na vijë turp nga

identiteti ynë evropian? Sa më shumë që nënshkrimi i marrëveshjes së Shqipërisë shtetërore me Evropën afrohej, aq më fort ndiheshin murmurimat. Sa më shumë që afrohej caktimi i statusit të Kosovës, me fjalë të tjera, besimi i Evropës e i Amerikës se Kosova mund të hynte si shtet i pavarur në familjen kontinentale, aq më këmbëngulëse bëhej krrokama se shqiptarët ishin si mish i huaj, pra i padashur, për Evropën. S'ishte mbushur as java e fillimit të bisedimeve të Vjenës për statusin e Kosovës, e s'kishin kaluar veç disa orë që avioni i kryekomisionerit evropian Baroso, ishte ulur në aeroportin e Tiranës, kur murmurimat disi kaotike u shtuan. Ato u shfaqën madje edhe atje ku priteshin më pak, si për shembull, në ndonjë deklaram të akademikut nga Kosova, Rexhep Qosja. Thelbi i shkrimit të tij "Identiteti kombëtar dhe vetëdija fetare", është përpjekje për të treguar se shqiptarët vetëm përgjysmë i përkasin qytetërimit evropian. Sipas Qosjes shqiptarët s'kanë pse të shtiren si evropianë, ngaqë ata "i takojnë qytetërimit islamik hiç më pak se qytetërimit të krishterë". I turbullt, i cekët dhe i pasaktë, akademiku bie në kundërshtim me veten dhe shkrimet e tij të mëparshme ku ai me të drejtë, ka qenë ithtar i vendosur i tezës se atdheu është një, e fetë janë tri, pra, nuk janë fetë ato që kushtëzojnë identitetin por tjetër gjë. E megjithatë, kur vjen puna për të vërtetuar evropianizmin e munguar shqiptar, Qosja përdor pikërisht fjalët "islamk" dhe "i krishterë" thua se një shqiptar i krishterë mund të jetë evropian, por një shqiptar mysliman, kurrsesi! Por keqkuptimet në shkrimin e Qosjes nuk janë vetëm këto. Përveç nervozizmit të papërligjur ndaj asaj tradite kulturore që ka qenë lidhur me katolicizmin e hershëm shqiptar, nervozizëm që nuk lë pa prekur mbajtjen e portretit të Nënë Terezës në institucionet e Kosovës, në këto shkrime spikat diçka e errët dhe e rrezikshme: ndarja e identitetit shqiptar.

Muzika ngjan si e njohur.

Askush nuk mund të jetë aq naiv sa të mos e kuptojë se një identitet i ndarë është një komb i ndarë. Askush s'mund të jetë aq i ngathët nga mendja që të mos e kuptojë se përjashtimi i gjysmës ose shumicës së kombit shqiptar nga identiteti evropian, do të thotë përjashtim nga Evropa. Dhe përjashtimi nga Evropa nuk është larg dëbimit nga Evropa. Ky nuk është as përfundim teorik e as filozofik. Kombi shqiptar, përpara se ta lexojë në libra e ka ndier në mishin e tij këtë lemeri. Shpërnguljet me dhunë kanë hyrë në vetëdijen e traumatizuar

të disa brezave shqiptarë. Këto shpërngulje nuk ranë si rrufe në qiell të pastër. Ato ishin përgatitur për një kohë të gjatë nga zyra kriminelësh, nga ushtarakë sadistë, nga akademikë të zinj si Vasa Çubrulloviçi, nga mendësia e një popullsie të tërë të dehur prej etheve shoviniste. Në këtë përgatitje, po ta hulumtosh tani do të gjesh paradigmat e vjetra: Njëra prej tyre është identiteti joevropian i shqiptarëve. Shqiptarët, turq të ardhur nga Anadulli. Shqiptarët, myslimanë, mish i huaj për Evropën e krishtere. Shqiptarët, rrezik për qytetërimin evropian. Shqiptarët duhen mbajtur të tkurrur, të thyer në mes. Na lini ne ta bëjmë këtë punë. Gjithë strategjia e Millosheviçit për të marrë dritën jeshile nga Evropa për zhbërjen e së paku gjysmës së kombit shqiptar, atij “që s’kishte identitet evropian”, domethënë të shqiptarëve më besim mysliman, bazohej në besimin e tij të verbër se Evropa do të binte në këtë kurth gjenocidar. Ne e dimë ç’ndodhi. Evropa dhe SHBA-ja nuk ranë në kurth dhe kjo është një nga aktet më të ndritshme të qytetërimit perëndimor.

3

Përpara se t’i kthehemi tezave për identitetin e përgjysmuar shqiptar, le të hamendësojmë një çast se ndoshta mbrojtësit e tyre kanë të drejtë. Me fjalë të tjera të shtrojmë pyetjen se mos vallë gjithë këto vite, madje disa shekuj me radhë nuk e paskëshim ditur ç’kemi qenë? Ose e kemi ditur gabim? Mos na kanë gënjyer poetët, nga De Rada te Naim Frashëri, që të kujtojmë se jemi ata që s’jemi? Dhe prapë mund të vazhdonim. Mos vallë më 1990, kemi lëshuar britmën e gabuar “E duam Shqipërinë si Evropa?” Mos vallë ajo duhej të ishte: “E duam si Evropa, por e duam edhe si Azia”, ose “Hiç më pak se Azia?” Shkurt mos jemi ata që s’jemi? E gjithë kjo nuk është aspak për të qeshur. Përçartje të tilla, në prag të afrimit të portave të Evropës, përpara se të ishin komike, janë thellësisht tragjike. Si të tilla, ato kërkojnë një përgjigje të qartë, serioze dhe pse jo, të prerë. Në raste të tilla parimi kryesor është se një popull është ai që është dhe s’ka nevojë as për pudër zbukurimi e as për blozë përçmuese.

Letrat e Shqipërisë janë të qarta.

Populli shqiptar nuk ka identitet gjysmak, të shtirë apo të fshehur pas lajlelulesh mashtruese. Identiteti i tij është gjithashtu i qartë, pavarësisht se dikush nuk dëshiron ta shohë, e dikujt nuk i intereson ta

shohë. Gjeografia, gjëja më kokëfortë në botë, dëshmon e para evropianitetin shqiptar. Zelli i atyre që me çdo kusht duan ta zbehin disi edhe këtë fakt kokëfortë, arrin disa herë të krijojë përshtypjen se Shqipëria është në skaj të Evropës dhe fill pas saj nis Turqia, ose Azia. Ndërkaq, kur hedh sytë në hartë vëren se gjer në atë kufi shtrihen së paku tri shtete të tjera: Maqedonia, Greqia dhe Bullgaria. Për të mos përmendur atë që quhet “Turqia evropiane”. Popullsia shqiptare, ashtu si e gjithë kontinentit evropian, është e bardhë. Ashtu si gjuha, ajo quhet, në rastin më të favorshëm, pasardhëse e ilirëve, në më të pafavorshmet, e trako-ilirëve. Historia e Shqipërisë, ashtu si e gjithë gadishullit, gjer në pushtimin otoman, është pjesë e kronikës mesdhetare evropiane. Së paku tri qytete kryesore të saj, me jetë të pandërprerë, Durrësi, Shkodra dhe Berati, kanë afërsisht një moshë me Romën. Lidhjet ekonomike e ushtarake, ligjet rregulluese (statutet) e qyteteve, të rrugëve e porteve detarë janë të një natyre me ato të kontinentit. Gjurmët arkeologjike greko-iliro-romake, teatro e amfiteatro gjenden gjithashtu kudo. Historia e mesjetës shqiptare sipas veprës monumentale të Milan Shuflait, jepet në një tablo të plotë me principatat, kryezotët, aleancat, krushqitë e natyrisht grindjet e pashembullta, tradita e të cilave ka mbërritur e pazbehur aspak gjer në ditët tona. Gjergj Kastrioti Skënderbeu, heroi kombëtar shqiptar, përmendja e të cilit ishte e ndaluar në Shqipëri për pesë shekuj, për shkak të sundimit otoman, u bë së pari një mit evropian, (mbi një mijë vepra historike e artistike, të shkruara për të), përpara se Evropa t’ia rikthente Shqipërisë në shekullin XX. Letërsia e hershme shqipe, letërsi dygjuhëshe, shqip e latinisht, si në shumicën e vendeve evropiane, u zhvillua në të njëjtin nivel për gati tre shekuj. Emra të mëdhenj të saj si Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani i botonin veprat e tyre dygjuhëshe në kryeqendrat kulturore evropiane, për t’i sjellë fshehtazi në Shqipëri, ku shkrimi dhe shtypshkrimi shqip ishin të ndaluara. Në kushtet dramatike të ndalimit, më 1908, një komision i kryesuar nga Gjergj Fishta dhe Mithat Frashëri, me shpalljen e alfabetit latin si alfabet zyrtar të shqiptarëve, dhanë një kumt të qartë të evropianizmit shqiptar. Kjo ndodhte në prag të agut, pas një nate të gjatë pesëshekullore, kur mendjet ishin ende të turbullta, dhe alfabeti latin në Ballkan ishte tepër i rrallë. Me këtë mall tragjik për Evropën e humbur, Shqipëria mbërriti në vitin 1912, vit i lirisë së saj. Më 28 nëntor u shpall pavarësia, dhe nga zgafellat e kombit u nxor flamuri i moçëm

mbretëror me shkabë dykrenore, një nga emblemat e mëdha, e cila, prej botës romako-bizantine i kishte kaluar Evropës e kishte zënë vend në qendër të heraldikës së saj. Kontinenti nënë, në një vrull fisnikërie ua njohu atë shenjë shqiptarëve. Por gjestet e Evropës do të ishin më pas tepër të kursyera për ta.

4

Ishte e natyrshme që krahas kësaj historie filoevropiane, e kundërta e saj do të rrugëtonte paralelisht me të: kundërevropianizmi. Ai ishte i pashmangshëm sidomos gjatë pushtimit pesëshekullor osman. Programi kryesor i perandorisë, misioni i saj i shpallur ishte pushtimi dhe shkatërrimi i Evropës mbarë. Merrej me mend se sa e egër do të ishte kjo perandori me trojet e porsapushtuara të kontinentit armik. Dhe egërsia nuk vonoi. Pas nënshtrimit fizik nisi ai shpirtëror. U lanë në këmbë kishat, por u ndaluan shkollat dhe gjuha e shkruar. Me sa duket qysh atëherë u kuptua se kishat, duke qenë dylllojëshe, katolike dhe ortodokse, ishin më pak të rrezikshme se gjuha, e cila ishte një. Shumë shpejt një besim i ri, do t'u shtohej të parëve, feja myslimane me xhamitë e saj. Por gjuha do të ishte prapë një, ashtu siç ishte identiteti i popullit. Ky i fundit, qysh atëherë, natyrshëm e zuri vendin e vet mbi tre besimet kryesore të shqiptarëve. Qëllonte që brenda një familjeje të gjëllinin përbri besimi katolik dhe mysliman, të ndarë midis vëllezërve. Nisur nga kjo, s'duhej ndonjë filozofi për të kuptuar se fetë mund të ishin të ndryshme, por identiteti, ashtu si lidhja gjinore, mbetej gjithmonë një. Kishim pasur një atdhe për të tre besimet dhe kjo s'do të ndryshonte, dhe kjo s'mund të ndryshonte kurrë. Nostalgjikët e sotëm të perandorisë otomane duket se e kanë harruar ç'ka ndodhur në atë kohë. Edhe sikur shtypje e plojë të tmerrshme të mos kishte pasur, do të mjaftonte tragjedia e ndalimit të shkollave për disa shekuj rresht, për të kapur përmasat e së keqes. Shqipëria, ashtu si gjithë vendet e gadishullit, u dëmtua rëndë. U dëmtua e u tret trupi i saj, por po aq i lemerishëm ishte gjymtimi i trurit nga terri i gjatë i padijes. E veç kësaj ndërprerjeje ogurzezë do të mjaftonte të kujtonim nxënësit dhe mësuesit e masakruar, kur kapeshin duke mësuar shkrim e këndim, në bodrumet e fshehta, për të kuptuar se përse gjuha shqipe u ngrit më pas në statusin e martirit dhe përse zuri vendin e një tempulli. Lufta për zbehjen e identitetit shqiptar dhe zëvendësimi me atë otoman, ishte e lodhshme dhe e

përditshme. Perandoria, ashtu si kudo në Ballkan, u përpoq të krijonte të tjera zakone, stil, vese, arkitekturë, veshje, muzikë dhe letërsi. Diku ia dilte e diku kurrresi. Letërsia e bejtexhinjve, për shembull, njëfarë brumi i përzier shqiptaro-turk, u thye përfundimisht, si një sajese prej qerpiçi prej murit hijerëndë e monumental, ndonëse të ftohtë, të traditës së letërsisë dygjuhëshe shqiptaro-latine. Gjatë kohës së komunizmit u bënë shumë përpjekje për ta rehabilituar këtë letërsi, me qëllimin meskin për t'ia kundërvënë letërsisë tradicionale mesjetare, sidomos asaj katolike, që regjimit nuk i pëlqente kurrresi. Mirëpo kur studiuesit e morën nëpër duar, e panë se përveç që ishte qesharake për nga niveli, ajo ishte thellësisht e pamoralshme. E paraqitur kinse si letërsi me probleme shoqërore-klasore e erotike (me gjasje tepër e guximshme për kohën), u pa se si ana shoqërore, si ajo erotike, ishin tepër të dyshimta. Kjo e fundit, për shembull, s'ishte aspak erotizëm normal, por i mbushur me motive ashikësh e dylberësh. Gjer këtu edhe mund të pranohej, madje mund të quhej tepër e përparuar, për të mos thënë që Shqipëria mund ta paraqiste sot si dëshmi të habitshme të vizionit të saj të emancipuar për homoseksualizmin, dy shekuj përpara Evropës së sotme! Por kjo punë ishte më e ndërlikuar. E ashtuquajtura letërsi erotike, në një pjesë të madhe të saj s'ishte gjë tjetër veçse bejte dhe lavde për pedofilinë. Ne i dëgjojmë këto këngë ende sot, por shtiremi sikur nuk i marrim vesh ç'thonë. Ato gjëmojnë disa herë nëpër lokalet e natës, madje, në programet televizive, e ne prapë shtiremi se nuk i kuptojmë. Mjafton njëfarë përqendrimi në këto tekste e këto melodi, mjaftojnë dëshmitë e shkruara të kohës, për të kuptuar se cili është thelbi i kësaj nënkulture, të futur kontrabandë, nën pasaportën e artit popullor. "Çunat e vegjël", adoleshentët, dylberë me shallvare mëndafshi e vetulla të hequra, nga njëra anë dhe ashikët e moshuar, "lalët" me mustaqe, që psherëtinin të dergjur për ta, nga ana tjetër, ishin personazhet kryesore të këtyre idileve të neveritshme.

Ende nuk dihet nga kishte buisur kjo kundërkulturë, që jo vetëm me shqiptarët, por me asnjë popull ballkanas s'kishte lidhje. Në thelb ajo bartte brenda saj një program të fshehur zhburrërimi e zvetënimi moral të pashembullt. Nuk duheshin veç disa breza "çunash" e "lalësh" të tillë që jo liria, por vetë ideja e lirisë të perëndonte përgjithmonë. Kundër kësaj lyre që s'dije ç'emër t'i vije, u ngrit Rilindja Kombëtare Shqiptare. Me programin e saj të qartë evropianist, me

kthjelltësinë e mendimit, strategjinë burrërore dhe idetë iluministe, ajo e mënjanoi si një rreckë atë kinse kulturë që po rrihte t'i zinte frymën Shqipërisë. Pas tërheqjes së shtetit osman nga gadishulli, lufta midis identitetit të lodhur shqiptar dhe këtij kinse identiteti lëngaraq, u duk se do të përfundonte shpejt. Ky i fundit s'e kishte më përkrahjen e shtetit pushtues, kurse identiteti shqiptar, si një luan i zgjidhur nga zinxhiri, dukej se mund të fshinte çdo pengesë që do t'i dilte përpara. Por nuk ndodhi ashtu.

Fill pas ardhjes së mbretit gjerman Vilhelm Vidit, i dërguari protestant i Evropës, në vendin me tri fe, rebelimi i Haxhi Qamilit ishte një ogur i keq. I nisur si mllef kundërevropian ai përfundoi në tërbim antishqiptar. Nën daullet dhe klithmat "Dum Babën!", që do të thoshte, as më pak as më shumë: "Duam robërinë!" hordhitë e haxhiqamilistëve digjnin flamurin shqiptar, mbyllnin shkollat shqipe, masakronin nxënës e mësues, si dikur. Ky rebelim egërshan u shfaq kështu befas si krah i armatosur i asaj dergjijeje të përgjumur shallvaresh e psherëtimash, që shqiptarët nuk e kishin marrë seriozisht.

5 Nga burrat e shtetit, mbreti Zog ishte një ndër ata që më së shumti u shqetësua nga një përsëritje e mundshme e haxhiqamilizimit. Përpjekjet e tij, shpeshherë të dëshpëruara, për një shtet shqiptar evropian, binin ndesh me fytyrën reale të Shqipërisë. Shqipëria ishte e vonuar. E përveç vonesës, ajo kishte një pengesë tjetër. Ndërsa në vendet e tjera feja zotëruese e krishtere ndihmonte për ndarjen nga tradita otomane, në Shqipëri, ajo traditë mund të strehohej pikërisht pas fesë zotëruese, myslimanizmit. (Parazitë të shumtë do t'i ngjiteshin kësaj feje, sidomos në shekullin e njëzetë, duke përfshirë edhe të fundit, atë më të rrezikshmin, terrorizmin.) Por jemi ende në fillim të shekullit. Faik Konica, qysh pa u përmbysur perandoria, u drejtoi një thirrje "muhamedanëve shqiptarë". Thirrja ishte profetike: otomanët po rrëzoheshin, ç'do të bënin myslimanët shqiptarë? Konica dhe gjithë mendjet e ndritura të kohës e kuptonin se çështja e myslimanizmit shqiptar, ishte në të vërtetë çështja e ekzistencës së Shqipërisë. Vetëm me të krishterët Shqipëria nuk mund të bëhej. Ndaj programi i një Shqipërie evropiane, ishte i pandarë nga ai i një myslimanizmi kombëtar e njëherësh evropian.

Shqiptarët ishin familjarizuar ndërkaq me idenë se identiteti shqiptar, duke qenë një, qëndronte vetvetiu mbi të tre besimet e tyre. Të tre ata ishin njëlloj të ligjshëm dhe çdo fryrje e njërit në dëmtim të tjetrit, do ta prishte drejtpeshimin historik. Pra do të kishte tre përbërës të një identiteti dhe jo një identitet i ndarë më tresh. Natyrisht që kjo çështje e zgjidhur parimisht e filozofikisht, gjatë kohës kur ende Shqipëria nuk ekzistonte si shtet më vete, paraqitej më e ndërlikuar në kushtet e pavarësisë. Mbreti Zog, i cili u ndesh me të, do ta kuptonte se një shtet shqiptar në Evropë nuk mund të mbahej në këmbë jashtë zakoneve të kontinentit: aleancave, traktateve e gjeostrategjisë, me fjalë të tjera, jashtë kushtëzimit evropian. Për ta përshtatur vendin me këto zakone të reja, ai e quajti të ngutshme nxjerrjen e ligjeve dhe dekreteve që rregullonin marrëdhëniet e të tre besimeve me shtetin.

Merrej me mend që një vend të rëndësishëm do të zinin çështjet e besimit mysliman. Ndër to, kryesorja ishte ndarja e tij me çmërsin e shtetit të perënduar osman. Kështu ai nxori dekrete që disa herë u dukën tejet të guximshme e të parakohshme, si ai për ndalimin e qylafit turk për burrat, ose të ferexhesë për gratë. Dekreti i tij më befasues ishte ai i ndryshimit të lutjes në gjunjë. Duke u nisur nga një nyje e Kanunit të moçëm, që ndalonte rreptësisht rënien në gjunjë të burrave, e që një burrë të gjunjëzuar e quante të vdekur moralisht, mbreti, nëpërmjet Bashkësisë Islame, urdhëroi myslimanët shqiptarë të faleshin këndeje e tutje pa e ulur dinjitetin shqiptar, domethënë në këmbë!

Dhe ashtu u bë. Mund të dukej se mbreti Zog, në përpjekje për krijimin e “myslimanit evropian”, po kryente ca bëma që mund të dukeshin donkishoteske. Por s’ishte fare ashtu. Në të njëjtën kohë afërsisht, sado e habitshme të dukej, në Turqi, në bërthamën e ish-perandorisë së rroposur, po përparonte ideja e një “Turqie evropiane”. Po vërtetohej ideja e rilindësve se myslimanizmi shqiptar nuk do të ishte pengesë për rrugëtimin e Shqipërisë drejt Evropës. Ndërkaq, në hapësirën shqiptare, që kishte mbetur jashtë kufijve shtetërorë, po ndodhte një zhdrivillim i kundërt. Rrethet shoviniste në vendet fqinje, kryesisht në Jugosllavi, e kuptuan shumë shpejt se mund ta shfrytëzonin myslimanizmin kundër identitetit shqiptar. Si vende të krishtera që ishin, do të ngjante e logjikshme që ato të përpiqeshin të dobësonin myslimanizmin te shqiptarët. Por, për një paradoks të madh, ato bënë të kundërtën. Dukej qartë se ajo që i shqetësonte ata

nuk ishte myslimanizmi, por identiteti shqiptar. Ndaj në mënyrë të ethshme shpresonin që me anë të fesë t'i merrnin frymën identitetit. Strategjia e tyre ishte afatgjatë. Sa më shumë që shqiptarët të ngjanin jo si shqiptarë me besime të ndryshme, por thjesht si myslimanë pa komb, aq më të huaj do të dukeshin në sytë e Evropës. Dhe kështu, Evropa, e mësuar me zakonet e mbrapshtë që popujt myslimanë t'i përftonte më lehtë si koloni, se sa si popuj sovranë, të tillë do t'i përftonte dhe shqiptarët, gjersa t'i harronte. Shqipëria zyrtare ndërkaq ishte pengesë për këtë harrim. Mbreti Zog sikur ta ndiente të keqen, vazhdonte me dëshpërim evropianizmin e ngutshëm të vendit. Por një ngjarje e beftë do të ndërlikonte gjithçka: pushtimi italian. Nga dëshpërimi dhe zia si një ngushëllim i papritur do të ishte bashkimi i Kosovës me Shqipërinë. Por hareja për këtë s'do të vazhdonte gjatë. Pushtimin fashist do ta zëvendësonte diktatura komuniste, më saktë një diktaturë dyfishe; shqiptare dhe serbe, e para mbi vendin amë, e dyta mbi Kosovën. Procesi i evropianizimit jo vetëm u ndërpre, por urrejtja kundër Evropës, u bë baza e strategjisë komuniste. Kjo urrejtje ishte dhurata më e çmuar që komunizmi shqiptar u bëri jugosllavëve. Shqipëria u nda përsëri nga Evropa, këtë herë edhe më tragjikisht. Më 1947-ën, Enver Hoxha, të vetmen "sprovë historike" që shkroi ia kushtoi himnizimit të Haxhi Qamilit. Urrëjtja kundërevropiane u shkri me atë kundërshqiptare si trupi me hijen e vet. Ëndrra jugosllave po njëmendësohej nëpërmjet Enver Hoxhës. Dhe ndodhi ajo që pritej, Evropa e harroi Shqipërinë. Me duar të lira tashmë, jugosllavët iu turrën identitetit shqiptar.

6

Rretheve shoviniste në Jugosllavi dukej se iu erdhi dita. Armiqësimi i Shqipërisë komuniste me Evropën ishte argumenti më i mirë për ta, për t'i paraqitur edhe shqiptarët e Jugosllavisë si kundërevropianë. Thelbi i strategjisë jugosllave mbetej i pandryshuar: të tkurrej, të shkonte drejt tretjes shtati i këtij populli, që edhe pa këtë, ishte mpakur pa pushim. Ai nuk po e kapërcente dot shifrën fatale, një milion, në kohën që popujt e tjerë ishin katërfishuar e disa herë tetëfishuar.

Pra, thelbi mbetej statusi i gjymtuar i Shqipërisë.

Njëfarë gjenocidi i ftohtë, i vazhdueshëm. Pyetja, a ka shqiptarë normalë, thënë ndryshe shqiptarë që ishin vërtet shqiptarë, kishte përgjigje mohuese. Nga jugu, nga rrethet shoviniste greke vinte ideja e

mbrapshtë se ortodoksët në Ballkan, përveç sllavëve, ishin të gjithë grekë, pra rrjedhimisht nuk kishte, madje nuk mund të kishte shqiptarë ortodoksë. Ata që hiqeshin të tillë, nuk ishin veç grekë, që rastësisht kishin mbetur brenda kufijve të Shqipërisë dhe që flisnin gjuhën shqipe, natyrisht përkohësisht!

Të dehur nga kjo ide, jugosllavët po josheshin nga një neps edhe më i madh: t'i shkëputnin kombit të vjetër, një copë më të madhe: myslimanët. Ndryshe nga mënyra greke, që kujtonin se marrëzinë e tyre mund ta arrinin me ca shpallje e ca mallkime shkronjash, si dikur, sllavët e kuptonin se procesi do të ishte i gjatë dhe i mundimshëm. Meqenëse s'dukej asnjë shpresë se shqiptarët do ta zëvendësonin identitetin e tyre me atë sllav, e vetmja mënyrë mbetej ajo e tërthorta, përdorimi i një identiteti të tretë. Pas heqjes së ortodoksëve dhe myslimanëve, trupit skeletik të kombit, nuk do t'i mbetej veçse pakica katolike, e vetmja për të cilën ndonjë fqinj tjetër, ta zëmë Italia, nuk po tregonte ndonjë padurim gllabërimi. Por pakicës, sado rrënjëse të ishte do t'i gjendej zgjidhja. E bashkë me të do të përfundonte kështu problemi shqiptar. Për të njëmendësuar ëndrrën e tyre makabre, jugosllavët kishin nevojë për përvojën otomane. Kështu qysh në vitet '50, ata filluan programin e shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve drejt Turqisë. E bënë këtë si një test në sytë e Evropës dhe të kampit socialist, pa u shqetësuar prej askujt, madje as prej atij që hiqej si miku i shqiptarëve e që në të vërtetë ishte armiku i tyre më i madh, Stalinit. Zëvendësimi i gjuhës shqipe prej turqishtes po nxitej edhe më fort, e bashkë me të, pakësimi i shkollave për shqiptarët. Politika e vjetër osmane: mjaft i keni xhamitë, s'ju duhen shkollat, po përparonte si në ethe. Krahas gjuhës, i gjithë ngjyrimi kombëtar po zbehej me shpejtësi. Muzika po orientalizohej më fort se më parë, veshjet e famshme tradicionale, ato që edhe gjatë periudhës së gjatë otomane ishin ruajtur, po zëvendësoheshin, jo prej veshjeve të kohës si kudo, por me petka arabe që nuk ishin njohur kurrë në këtë vend. Jugosllavia, kjo primadonë e "botës së tretë", po i ofronte kësaj bote popullsinë më të padëshiruar të saj, shqiptarët. Ajo përpiqej që këta të ngjanin sa më pak evropianë e aq më shumë afrikano-veriorë e aziatikë. Kështu, kur të vinte çasti fatal, që ajo e përgatiti me aq kujdes, t'i thoshte Evropës, se ajo nuk po zhbënte një popull normal të këtij kontinenti, por një nënpopull. E gjithë kjo ethe shkombëtarizimi shoqërohej nga propaganda për rrezikun e krijimit të një pyke të myslimanizmit në

brinjët e Evropës. Parashikoheshin skenarë ogurzinj me trekëndësia islamikë, me qendra terroriste, fundamentaliste, me xhihad version ballkanik etj., etj.

E gjithë kjo në pritje të çastit fatal, kur rebelimi shqiptar do të shpërthente. Ai rebelim do të paraqitej si luftë për islamin, e jo si luftë për liri. Si luftë kundër krishterimit serb e jo kundër krimit serb.

Shkurt, si luftë kundër qytetërimit evropian, në emër të një tjetër qytetërimi.

Nuk ishte e lehtë për shqiptarët e Kosovës t'u shmangeshin këtyre kurtheve. Por ata ia dolën dhe kjo ishte një meritë e tyre e jashtëzakonshme. Ata i treguan gjithë botës se luftonin në radhë të parë për liri. Dhe prapë për liri. Ata i treguan Evropës se s'kishin asgjë kundër krishterimit serb, e aq më pak atij evropian, ngaqë krishterimi ishte gjithashtu besim i tyre, vëllam i vjetër i myslimanizmit, madje krishterimi shqiptar ishte më i moçëm se ai sllav. Në çaste të vështira, popujve u ndriçohet mendja në mënyrë të ethshme. Një shekull më parë, në ag të shkëputjes nga osmanët, Rilindja Shqiptare e flakëroi mendimin shqiptar, duke hedhur idenë e harmonisë fetare në interes të lirisë e të kombit. Një shekull më pas, kundër propagandës serbe që këmbëngulte t'i jepte shqiptarët si turq apo aziatikë të ardhur vonë në Ballkan, dhjetëra-mijëra të rinj myslimanë shqiptarë më 1981-shin e 1991-shin, kërkuan rrënjët e krishterimit të hershëm shqiptar, aspak për arsye fetare, por thjesht për të treguar se populli i tyre kishte qenë ngulitur në Kosovë shumë shekuj përpara sllavëve. Gjëmimi i bombave sipër Jugosllavisë ishte njëkohësisht një lajm i madh. Një lajm nga ata që i vinin Shqipërisë një herë në një mijë vite, e Evropës vetë, një herë në shekull. Ishte lufta e parë e Aleancës Atlantike, e njëkohësisht e para luftë për shkaqe morale, në kontinent. Dhe s'ishte vetëm kaq. Ishte hera e parë që koalicioni i madh euroatlantik, që identifikohet së shumti si krahu i armatosur i qytetërimit të krishterë perëndimor, kishte hyrë në luftë për mbrojtjen e një populli me shumicë myslimane, kundër një tjetri që kërkonte të përlligjte krimin pas kryqit. Evropa dhe SHBA-ja nuk i kërkuan popullit shqiptar as ndërrim feje dhe asgjë tjetër të kësaj natyre. E mbrojtën ashtu siç ishte, shqiptar në radhë të parë, trefetarësh pastaj. Me këtë luftë, që ndiqej ditë pas dite e orë pas ore nga mbarë planeti tokësor, Evropa atlantike po emanciponte, veç të tjerash, vetveten. Të gjendur befas në qendër të

historisë evropiane, a mund të thuhet se shqiptarët i kapën përmasat e asaj që po ndodhte?

Vështirë të thuash “jo”, por po aq vështirë të thuash “po”.

7

Në kohën e tanishme, viti 2006, çështja e raporteve të shqiptarëve me kontinentin nënë, është ende në zhvillim e sipër. Të ndërgjegjshëm për një pjesë të gjërave, shqiptarët paraqiten po aq të pandërgjegjshëm për të tjerat. S’është fjala vetëm për mosmirënjohjen që shfaqet aty-këtu. Për qirinjtë e shuar fill pas kapërcimit të tmerrit dhe për nervozizmin kundër katedrales, që askush nuk ua kërkoi si shpërblim për asgjë. E bashkë me katedralen, murmurima e panjerëzishme kundër Rugovës të porsaikur, që me funeralin e tij i bëri një shërbim të fundit Kosovës. (Ka gjasë që prania e fuqishme evropiane në këtë mort të ketë rizgjuar ca demonë të vjetër.) Është folur shpesh për atë pjesë të Shqipërisë që, ndonëse s’guxon të dalë haptas, është kundër Evropës. Është folur për mafien dhe krimin e organizuar, që duke mos njohur komb e atdhe, s’kanë si të çajnë kryet për to. Është folur për politikanë të korruptuar, që ashtu si mafia tmerrohen nga ligjet e demokracisë e nga standardet e Ballkanit evropian. Është folur për fjalimet antiamerikane në parlamentin shqiptar më 1997-ën, që kanë shkaktuar, me siguri, lot nostalgjikë, në sytë e stalinistëve shqiptarë. Janë të njohura udhëtimet gjysmë të fshehta të politikanëve shqiptarë të të dy krahëve, në vende, disa herë të cilësuar si terroriste, me qeveri të dyshimta, që s’i duan as popujt e vet, e me të cilat s’na lidh asgjë. Të gjitha këto dihen. E keqja është se kujtesa e politikës shqiptare është e shkurtër dhe, veç kësaj, disa nga politikanët tanë, dinakërinë e tyre e kujtojnë për zgjuarsin.

Është e kuptueshme që dhe haxhiqamilizmi dhe komunizmi shqiptar do të linin pas vetes një frymë të sëmurë kundërevropiane. Është e kuptueshme që shumë njerëz do të ndihen keq në familjen e sotme të popujve. Problemi i mirëkuptimit ose moskuptimit shqiptar me kontinentin, është në thelb mirëkuptimi ose moskuptimi me vetveten. Raportet me Evropën s’mund të jenë veçse të qarta e pa dyfytërsi. Mesazhi i Evropës më 1997-ën dhe 1999-ën, ishte i qartë. Ajo na quante të vetët ashtu siç ishim, me atë identitet që kishim. E vetmja kërkesë e saj ishte ajo që iu bë gjithë popujve të tjerë të ish-Lindjes komuniste: emancipimi, demokracia. Trillet, nazet dhe dyshimet nuk janë pa një burim. Një pjesë vijnë nga keqkuptimet tona të vjetra, një pjesë nga

dredhitë e sotme. Ende disa vite më parë ishin të kuptueshme. Por në pranverë të këtij viti, ato janë të tepërta. Pengesat që s'na lënë, ose na duket se s'na lënë, t'i afrohem Evropës, përpara se t'i kërkojmë jashtë, duhet t'i kërkojmë brenda nesh. Nuk është pengesë asnjëra nga fetë, e sidomos nuk është myslimanizmi ndaj të cilit dyshimi ngjan më i lehtë. Është thënë me të drejtë se të tri besimet janë të barasligjshëm në Shqipëri. Duke mos qenë pengesë asnjëri, po aq mund të thuhet se asnjëri s'është lokomotivë që na tërheq drejt Evropës. Në pengojnë, ata pengojnë të tre bashkë, e, në tërheqin, këtë e bëjnë të tre njëloj.

Një shqiptar mysliman, është po aq i natyrshëm si shqiptar dhe si evropian, sa një katolik, e po aq sa një ortodoks. Në acarimet e shpesh në përpjekjet me turqit osmanë, shqiptarët myslimanë ishin në vijën e parë. Feja e njëjtë me pushtuesin, nuk ua mjegulloi idenë e lirisë. Bilbilentë, ata që në mënyrë aq të padenjë u përgojuan në Kuvendin shqiptar më 2006-ën, ishin një nga familjet martire, 13 djem oficerë të së cilës u varën brenda ditës nga pushtuesi me të njëjtën fé. E njëjta gjë ka ndodhur me shqiptarët ortodoksë. Martirët e vijës së parë kundër trysnisë mizore të shovinizmit fqinj, ishin pikërisht ata. Papa Kristo Negovani, At Stath Melani, Petro Nini Luarasi, janë vetëm disa nga emrat e mëdhenj që feja e njëjtë me kundërshtarit nuk ua zbehu për asnjë çast idenë e lirisë. Rexhep Qosja ka të drejtë kur thotë se nëse shqiptarët do të kishin ruajtur besimin fillestar, rikthimi i tyre në Evropë do të kishte qenë më i lehtë. Por kjo keqardhje e tij, nëse mund ta quanim kështu, bie ndesh me këmbënguljen se gjysma jonë i përket ndërkaq qytetërimit lindor. Me këtë pranohet ngadhënjimi i vonuar i shtetit osman. Me këtë pranohet se në gjithë gadishullin ballkanik i vetmi popull që u thye, qoftë edhe përgjysmë, ishim ne. Në qoftë se kjo do të ishte e vërtetë, ne do të ishim të detyruar ta pranonim. Por kjo, për fat, nuk është kurrsesi ashtu.

Siç u tha më lart, kombet nuk ndryshohen as nga pushtimet e as nga konvertimet.

Nostalgjia e tërthortë që po shfaqet sot tek ne për otomanizmin nuk është vetëm e habitshme. Ajo është në radhë të parë poshtëruese. E po ashtu fantazma e Haxhi Qamilit, që përherë e më shpesh shfaqet në trojet shqiptare. Shtatorja që iu ngrit në qendër të Tiranës, më 2001, një shefi otoman, i shpallur si kinse themeluesi i qytetit, ka qenë fyerja më e madhe për kryeqytetin e shtetit, për historinë dhe ndërgjegjen shqiptare. Vetëm një popull që nuk e meriton lirinë mund t'i ngrejë

shtatore pushtuesit të vet. Bashkia e Tiranës, e drejtuar në atë kohë “nga haxhi qamilët”, siç i cilësoi me të drejtë arkitekti Maks Velo, e ngriti atë shtatore natën dhe pa lajmëruar askënd, si keqbërësit. Banorët e pallateve rreth sheshit ku ajo ende ngrihet sot, e mbajnë mend njeriun që printe vallen rrotull shtatores atë natë. Ky njeri mban një nga postet më të rëndësishme në qeverinë e sotme. Kjo shtatore është mishërimi i korrupsionit politik dhe moral të shkallës më të errët. Historianët e kanë shpallur të rremë këtë kinse themelues. Emri i Tiranës si vend vendbanimi, është shumë më i vjetër se koha e këtij pashai.

Klisheja krejtësisht e gabuar e përftimit të Shqipërisë si vend ndërmjetës, një sanduiç midis Lindjes dhe Perëndimit, një qytetërim as ashtu, as kështu, thënë ndryshe një “vend i as-as-it”, s’na bën kurrfarë nderi. Së pari, sepse nuk është e vërtetë, së dyti, sepse të lakmosh një cilësim të tillë, është njëlloj si të vetëshpallesh “gjysmak”, që në shqip midis të tjerash do të thotë “tarrallak”. Ideja e përhapur andej-këndej, dhe fatkeqësisht e përkrahur nga Qosja, se “fati ynë historik është i paracaktuar për të sendërtuar zbutjen e kundërshtimeve midis Lindjes dhe Perëndimit”, të kujton një nga njollat historisë shqiptare, kapardisjen e Shqipërisë komuniste për kinse misionin e saj planetar për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Ide të tilla delirante, ato me të cilat, Shqipëria, për një kohë të gjatë, u bë gazi i botës, u kanë ardhur në majë të hundës shqiptarëve. Por jo politikanëve tanë. Me sa duket, reflekset e vjetra të zyrave të Enver dhe Nexhmije Hoxhës, iu vijnë në mendjet e tyre prej mitomanësh. Janë këto, me sa duket, që shkaktojnë çoroditjen kryesore në politikën shqiptare. Një pjesë e madhe e politikanëve flasin gjithë ditën për Evropën dhe Perëndimin, por mendjen, me sa duket, e kanë nga Lindja. Nga Lindja në të gjithë gamën që ajo ngërthen:

Lindja e Mesme, ish-lindja sovjetike, e po të mos mjaftojë kjo, edhe ajo kineze maoiste. Janë këto reflekse, që i shtyjnë këta politikanë, që, në vend që të përqendrohen në çështjet e ngutshme madhore përpara të cilave ndodhet kombi shqiptar: mirëqenia, hyrja në Evropë dhe statusi i Kosovës, fillojnë e joshen nga fantazira pa kuptim, për të cilat nuk kanë as mundësi, as shtat e as tagër moral nga populli i vet. Të brengosesh se si do të pajtohet Perëndimi me Lindjen, të kinse ndërhysh, për shembull, në kinse rolin e ndërmjetësit, në mosmarrëveshjet SHBA - Iran, për energjinë bërthamore, kjo, në rastin

më të thjeshtë quhet ëndërr në diell, kurse në rastin më të keq, e ka emrin korrupsion politik. Misioni i shqiptarëve në këtë planet, fati apo e thënia e tyre, është një dhe i pandryshueshëm:

mbrojtja e interesave të vendit të tyre, që quhet Shqipëri dhe i popullit të tyre që mban emrin shqiptar. Programi i çdo populli të qytetëruar është ky dhe vetëm ky. Miqësitë, aleancat, strategjitë, kanë lidhje me të dhe vetëm me të. Ky nuk është etnoegoizëm. Kur çdo popull në mënyrë të natyrshme, njerëzore e demokratike e kryen këtë mision ndaj vetes, ai e ka kryer atë ndaj gjithë njerëzimit.

Ky është **thelbi i idesë evropiane**, fundaja mbi të cilën ngrihet Bashkimi Evropian, ai që ndryshe quhet Evropa e Kombeve.

Ne nuk e kemi shpikur Shqipërinë, ashtu siç kanë dashur të na mbushin mendjen disa. Ne nuk e kemi shpikur as ngulitjen e saj në Evropë, siç kanë dashur të na mbushin mendjen ca të tjerë. Humbja dhe rigjetja e kontinentit nënë, nuk të bën më pak evropian se të tjerët. Përkundrazi, ajo të bën më shumë. Në mbyllje të kësaj sprove, le të përpiqemi ta shohim atë që ka ndodhur, nga një kamera e largët, nga ato që të japin mundësi t'i skajosh gjërat në një tablo sa më të përgjithshme. Është një kontinent që shekuj më parë është quajtur Evropë. Është një gadishull jugor i saj, ai më i ndritshmi dikur, dhe më i errëti pastaj, me emrin Ballkan. Ishte një perandori që u shfaq përbri, perandoria osmane, me një program e një ëndërr të mbrapshtë: të zhdukë nga faqja e dheut Evropën. Ndodh kacafytja e madhe midis të dyve. Gjatë saj, perandoria e re i shkëlqoi së vjetrës gadishullin ballkanik, djepin e qytetërimit të saj. Pesë shekuj më pas, gadishulli në fjalë, në mes të të cilit ndodhet Shqipëria, shpëton nga kthetrat e osmanëve. Perandoria e tyre bie. Kthimi i Ballkanit te kontinenti nënë është i gjatë, i mundimshëm.

Dhe ja epilogu: popujt e Ballkanit, janë vënë në radhë përpara Portave të Evropës. Përbri, është Turqia, bërthama e dikurshme e perandorisë së tmerrshme. Për pesë shekuj ka kujtuar se popujt ballkanas, pasi ia ka zhvatur Evropës, po i çon si trofe, drejt kontinentit të vet. Por ç'po na shohin sytë? Një gjë tejet të pabesueshme. Ka vërtet një trofe, por jo ashtu siç është kujtuar. S'janë popujt ballkanas që Turqia po i çon si robër drejt Azisë, por përkundrazi, janë ata, që po sjellin si trofe një hanëme të vjetër: Turqinë. Natyrisht që Turqia nuk është robinë, në kuptimin e mirëfilltë. Natyrisht që ajo po e kërkon vetë, madje me këmbëngulje të pranohet në Evropë. Natyrisht që ajo, ndërsa lëshonte

kërcënime e mallkime kundër Evropës, fshehtazi joshej prej saj. Dhe ky ka qenë ngadhënjimi i madh i Evropës.

Ana e fshehtë e historisë, shfaqet këtu në formën më tronditëse. Pyetja: kush u thye prej kujt, ngrihet me gjithë peshën e saj. Dy rrjedha të historisë kanë ecur paralelisht. Në atë të jashtmen, perandoria osmane, godiste, fitonte, robëronte. Por në një rrjedhë të brendshme, të fshehtë, ajo goditej, humbte, robërohej. Popujt e Ballkanit bashkërisht ishin aktorët e kësaj lufte. Ishin ata që, vit pas viti e shekull pas shekulli, bashkë me energjinë e tyre, bashkë me zyrtarët e lartë, gjeneralët, guvernatorët dhe aventurierët, që ia dhanë pa kursim, i ngjitën perandorisë joshjen evropiane. Historia e pushtuesit të pushtuar, si në rastin e Romës me Greqinë, në njëfarë mënyre u përsërit.

Rrjedhimisht, asnjë nga popujt e Ballkanit nuk u thye.

E aq më pak shqiptarët. Nëse ka pasur për ta një fat historik të paracaktuar, ai është i ndryshëm nga ai i ndërmjetësit. Popujve ballkanas, e midis tyre shqiptarëve, pa e ditur as ata vetë, madje pa e ditur as Evropa, fati u caktoi të jenë komando të Evropës, mu në qendër të botës osmane. Si të tillë ata kanë qenë përherë, ndonëse me dhembje, në rrënjët e Evropës. E qenia me dhembje nuk është kurrë një mungesë, përkundrazi.

ÇETA E PROFETNEVE: TJETËRQYSH*

Dr. Noel Malcolm

Cuneus prophetarum i Pjetër Bogdanit, i botuar në Padovë më 1685, për një kohë të gjatë është i njohur si punim i një rëndësie të jashtëzakonshme në historinë e kulturës shqiptare. Ky nuk ishte teksti i parë i shtypur në shqip, mirëpo ishte shkrimi i parë origjinal i konsiderueshëm i përgatitur dhe i shtypur në këtë gjuhë.

Punimi i Bogdanit është studiuar me kujdes nga linguistët. Është studiuar po ashtu edhe nga historianët, të cilët e theksuan rolin e rëndësishëm që Pjetër Bogdani e kishte në historinë e trevave veriore shqiptare - mbi të gjithat, rolin e tij si organizator i rezistencës së armatosur kundër autoriteteve otomane më 1689, vit ky i fundit i jetës së tij.² Mirëpo, vetë teksti është, pa dyshim, një traktat fetar; ndaj natyra dhe konteksti fetar i tij nuk janë shqyrtuar më hollësisht nga autorët paraprakë. Në këtë ligjëratë do të doja të përqendrohem në natyrën e projektit të Bogdanit - domethënë në çështjen çfarë lloj libri fetar ai ishte duke u përpjekur të shkruante, për çfarë lloj qëllimi fetar - si dhe në kontekstin në të cilin ky u shkrua. Sepse, më duket se këtu janë disa enigma të cilat kanë nevojë të zbardhen. E para ka të bëjë me vendimin e Bogdanit që librin ta botonte në Padovë, dhe jo në Romë. Tjetra është enigma që del lidhur me natyrën fizike të librit. E dimë se qëllim kryesor i Bogdanit ishte ta shkruante një tekst që do të mund të shpërndahej në mesin e anëtarëve të grigjës së tij në tokat veriore shqiptare. Ato pak tekste të tjera në gjuhën shqipe që tashmë ishin

* Titulli është i redaksisë. Ky tekst është ligjëratë inauguruese e studiuësit dhe historianit anglez Noel Malcolm (autor i librit "Kosovo- A short history"), të mbajtur më 20 mars 2006 në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si anëtar i saj i jashtëm.

shtypur për këtë qëllim ishin vëllime të vogla që mund të barteshin nëpër xhepa dhe, po të ishte nevoja, të kontrabandoheshin apo të fshiheshin; mirëpo *Cuneus prophetarum* i Bogdanit ishte një vëllim i konsiderueshëm i një formati të madh, i punuar shkëlqyeshëm dhe i zbukuruar deri në hollësi. Ky po ashtu i përmbante disa pasuse të shtypura në armenishte dhe siriakishte — gjuhë këto pa ndonjë relevancë të mundshme për banorët e Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë. Dhe, në dy pjesë të tëra të librit, të gjitha citimet nga Dhjata e Vjetër (Bibla Hebraike) nuk janë të dhëna vetëm në latinishte dhe shqipe, por janë po ashtu të shtypura edhe në hebraishte dhe arabishte; kjo përsëri shtron pyetje enigmatike rreth publikut të cilin libri e synonte dhe për qëllimet fetare të cilave ai ishte menduar t'u shërbente. Mirëpo enigma mbase më e madhe ka të bëjë me mënyrën në të cilën Pjetër Bogdani e trajton Islamizmin. Edhe pse nuk ka ndonjë trajtim sistematik të kësaj çështjeje, ka pasuse të shpërndara në punim në të cilat Bogdani jep komente negative për doktrinën islamike dhe për vetë Profetin Muhamed. Ajo që Bogdani kishte pikëpamje negative për Islamizmin nuk është aspak befasuese: këto ishin, fare thjesht, pikëpamjet e natyrshme të çdo teologu të krishterë gjatë kësaj periudhe. Mirëpo ajo që mbetet tejet befasuese është se ai qëndrimet e tilla i shpreh aq haptas në një libër që kishte për qëllim të shpërndahej përbrenda Perandorisë Otomane. Ai duhej ta kishte njohur fare mirë që *modus vivendi* i pakëndshëm i Krishtërit përbrenda Perandorisë varej nga respektimi i rregullave të caktuara, dhe njëra nga rregullat më të rëndësishme ishte ajo që të krishterët nuk bënin ta denigronin haptas Profetin Muhamed apo vetë Islamizmin. Më 1687, vetëm dy vite pas botimit të *Cuneus prophetarum*, njërin nga priftërinjtë e vetë Bogdanit, Dom Ndre Kalamashin, e arrestuan autoritetet lokale në Gjakovë dhe ai u mbyt (ashtu siç raportoi vetë Bogdani) 'sepse e ofendoi Muhamedin'.³ Bogdani i dinte këto kushte përsosmërisht mirë. Kështu që, çfarë ai mendonte se ishte duke bërë, gjatë shkrimit të një libri — për qarkullim brenda Perandorisë Otomane - e në të cilin Profeti Muhamed kritikohet haptas? Mendoj se çështja e qëndrimit të Bogdanit ndaj Islamizmit duhet të studiohet me kujdes, ashtu që të arrihet një kuptim i duhur i natyrës së librit të tij - megjithëse, ashtu siç do të argumentoj, të kritikuarit e Islamizmit nuk kishte qenë qëllimi i tij parësor, por vetëm një dytësor apo madje edhe tretësor. Kjo

çështje mbetet e rëndësishme meqë është aq për së afërmi e lidhur me kontekstin historik në të cilin Bogdani shkruante. Kjo ishte një periudhë konfliktesh të mëdha midis shteteve të krishtera dhe Perandorisë Otomane. Në pjesë të mëdha të jetës së rritur të Bogdanit, shteti Otoman ishte në luftë me një apo më shumë nga fuqitë katolike; më e rëndësishmja, nga viti 1683 e deri më 1699 (dhjetë vjet pas vdekjes së Bogdanit), Perandoria Otomane ishte në konflikt me 'Lidhjen e Shenjtë' të Austrisë, Venedikut dhe Papatin, si dhe me disa shtete të tjera të krishtera. Në këto rrethana, mund të jetë tundosëse të thuhet se feja veproi, thjesht, si një pretekst për Realpolitik: Austria i kishte arsyet e veta gjeopolitike për të dëshiruar t'i mposhtë osmanët, dhe kjo vetëm e ngjalli Krishterimin si një shkas ashtu që t'i arsyetonte politikën e veta, dhe për t'i inkurajuar fuqitë e tjera katolike që ta përkrahnin me njerëz dhe me para. Mirëpo ky është po ashtu një interpretim i njëanshëm; feja shërbeu, jo vetëm si kamuflim për politikën, por po ashtu si motivim i mirëfilltë për veprim.

(Ta japim vetëm një shembull: murgu karizmatik kapuçin italian Marco d'Aviano, i cili bënte predikime entuziazmuese ku kërkonte një kryqëzatë të re për t'i dëbuar osmanët jashtë Evropës, pati ndikim të qartë në mendimin e Leopoldit I dhe të qarqeve udhëheqëse të Vjenës.)⁴ Në rastin e vetë Bogdanit, do të ishte po ashtu gabim që të gjithat të reduktoheshin në motivimet politike apo laike. Sikur 'çlirimi kombëtar' nga një fuqi pushtuese perandorake të kishte qenë interesimi i tij i vetëm, ai logjikisht nuk do ta mirëpriste atë lloj pushtimi që do të mund të shpinte në atë që territori i tij të bëhej pjesë e Perandorisë Austriake apo asaj të Venedikut. Mirëpo, ai kishte ëndrra për një pushtim të këtij lloji; dhe arsyet pse mendonte aq ndryshe për një fuqi pushtuese të krishterë ishin, natyrisht, fetare. Qëndrimi negativ i Bogdanit ndaj Islamizmit nuk mund të veçohet nga konteksti i tij politik; mirëpo, në të njëjtën kohë, ky nuk mund të reduktohet në një çështje vetëm të politikës. *Cuneus prophetarum* është tekst fetar. Me qëllim që këtë ta kuptojmë duhet të fillojmë duke pyetur cilave qëllime fetare ai synonte t'u shërbente. Qëllimi kryesor, në mënyrë evidente ishte ta ofronte një përshkrim panoramik të mësimëve të Krishterimit në një trajtë e cila mund të kuptohej nga anëtarët e grigjës së Bogdanit. Organizimi i tërësishëm i librit përgjithësisht i përgjasonte rregullimit të Biblës së Krishterë, me ndarjen e vet në Dhiatën e Vjetër dhe të Re: kështu pjesa e parë e *Cuneus* e

përshkruante Krijimin, natyrën e Zotit, Rënien e Adamit, dhe radhën e 'profetëve' fjalët dhe veprat e të cilëve janë të regjistruara në Dhiatën e Vjetër (Mojsiu, Davidi, Solomoni, etj.), ndërkohë që pjesa e dytë e përshkruante jetën e Jezu Krishtit, duke përfunduar (si dhe vetë Dhiata e Re) me një përshkrim të ardhjes së ardhshme të Antikrishtit dhe të Gjykimit të Fundit. Rëndësia e një teksti të tillë për bashkësinë katolike shqiptare e cila nuk e kishte një version të Biblës në gjuhën shqipe, nuk bën të nënçmohet. Nga faza e hershme e punës së tij si klerik katolik në Shqipërinë Veriore, Bogdani, në raportet e tij Romës, e theksonte rëndësinë e asaj që grigjën e tij ta furnizonte me tekste që do t'i paraqisnin parimet themelore të Krishterimit; mbi të gjithat, ai e theksonte nevojën që tekstet e tilla të furnizoheshin në gjuhën e vetë shqiptarëve.

Në vitin 1675 Pjetër Bogdani u tregoi së pari autoriteteve në Romë që kishte shkruar një tekst fetar në shqip - versioni origjinal i pararendësit të Cuneus - dhe kërkoi leje ta shtypte atë. Në letrën në të cilën e përshkruante punimin e vet, Bogdani deklaronte që 'Shqipëria e kishte një mungesë të skajshme, pothuaj të plotë, të librave në gjuhën shqipe', që rezultonte në atë që 'jo vetëm që njerëzit rrjedhimisht jetonin, të verbuar nga injoranca, në mesin e një numri të pafundmë të gabimeve dhe të keqtrajtimit - por, po ashtu, meqë ky komb ndodhet midis turqve, grekëve dhe serbëve, ky është vazhdimisht duke e humbur gjuhën e vet'. Për këto arsye, ai thoshte se ishte i nxitur ta shkruante një libër 'në gjuhën shqipe, në gjuhën e tij amtare [d.m.th. të Bogdanit], për ardhjen e Mesisë, për t'i mënjeluar, mbi të gjitha, ato gabime të cilat kishin gjarpëruar deri në mesin e njerëzve'.⁵ Titulli i tij, thoshte ai, ishte 'Flavissae Prophetarum de Adventu Messiae Epirotice congestae ubi de Vita et ejus legitima potestate soli Petri tradita abunde consulitur': 'Thesaret e profetëve të ardhjes së Mesisë, të grumbulluara në shqip, në të cilën janë të shqyrtuara tërësisht, jeta e Mesisë, dhe pushteti i tij legjitim, të dhëna vetëm Pjetrit'.⁶ Këto hollësi tregojnë se ndërkohë qëllim kryesor i Bogdanit në shkrimin e tekstit i cili u shndërrua në Cuneus prophetarum, ishte që grigjës së tij t'ia mësonte doktrinën e krishterë, ai po ashtu e kishte edhe një qëllim dytësor: mënjanimin e 'gabimeve' të cilat ishin duke 'gjarpëruar deri' në mesin e njerëzve. Këto gabime i përfshinin edhe pretendimet e Kishës Ortodokse: përmendja në titullin e vitit 1675 e autoritetit të Krishtit 'të dhënë vetëm Pjetrit' në mënyrë evidente synonte ta

pohonte pozitën katolike kundër pretendimeve të grekëve dhe serbëve. Mirëpo, ndonëse teksti ashtu siç e kemi tash e përmban po ashtu një pjesë që e mbron parësinë e Pjetrit dhe të vijuesve të tij, ky i kushton fare pak vëmendje Krishterimit Ortodoks.⁷ Një rol shumë më të spikatur e kanë 'gabimet' e Islamizmit: jo vetëm besimet popullore (të tilla si ideja që 'ylli në rënie' e shënon vdekjen e një qenieje njerëzore), por po ashtu edhe besimet fetare të cilat ai ia mvishte Islamizmit (të tilla si besimi që larja me ujë do t'i hiqte mëkatet), dhe doktrinat e mirëfillta islamike që e kërcënonin besimin e krishterë (mbi të gjithat, pohimi që edhe dikush tjetër pos Jezusë kishte vdekur në kryq).⁸ Komentet rreth këtyre 'gabimeve' (edhe ortodokse, edhe myslimane) janë armiqësore, mirëpo armiqësia është kryesisht defensive, jo ofensive: interesimi kryesor i Bogdanit është që grigjën e tij ta mbronte nga ai lloj 'gabimesh' të cilat mund t'i nxitnin njerëzit ta braktisnin Kishën Katolike dhe në vend të saj t'u bashkoheshin të krishterëve ortodoksë apo myslimanëve. Ashtu siç e shprehu në një letër të vitit 1669, ai bënte përpjekje të mëdha që grigjës së tij t'ia mësonte doktrinën e mirëfilltë të krishterë, ashtu t'i bënte që t'i shihnin 'hijet e mashtrimit në të cilat ajo ndodhej, për shkak të kontakteve të saj të vazhdueshme me një Babilon të sekteve - mbi të gjithat, myslimane dhe ortodokse'.⁹ Në të vërtetë, gjatë kësaj periudhe kishte fare pak konvertime nga katolicizmi në ortodoksizëm (e që mund ta shpjegojë pse Bogdani i kushton krahasimisht më pak vëmendje doktrinave ortodokse). Mirëpo, konvertimet në Islamizëm ishin të shpeshta. Kjo, në të vërtetë, ishte ndër problemet kyçe me të cilat ballafaqohej Kisha Katolike, ashtu siç e dëshmojnë shumë nga vetë letrat dhe raportet e Bogdanit. Pra: nëse qëllimi parësor i *Cuneus prophetarum* ishte që thjesht t'ia mësonte doktrinën katolike bashkësisë katolike, qëllim dytësor i tij ishte t'i parandalonte ata katolikë të rrëshqitnin në Ortodoksizëm apo në Islamizëm, duke i kritikuar 'gabimet' e këtyre dy besimeve. Kjo e përfshinte, siç e thashë, një lloj armiqësie defensive. Mirëpo, është e domosdoshme që kësaj liste t'i shtohet një qëllim tretësor, konvertimi i njerëzve në Krishterimin Katolik nga Ortodoksizmi apo Islamizmi; dhe këtu mund të thuhet që strategjia shndërrohej në ofensive. Ajo që Bogdani po ashtu e kishte edhe këtë lloj qëllimi në mendjen e tij sugjerohet nga një koment që ai e bëri në letrën e tij të vitit 1675, kur e informoi Romën për herë të parë për '*Flavissae Prophetarum*' të tij: ai shkroi që

ky libër do t'i 'kënaqte nevojat e lartpërmendura [të grigjës së tij] duke u ofruar një mënyrë të qëndrueshme të forcimit të të krishterëve në Besimin e Shenjtë, dhe konvertime të panumërta të malësorëve myslimanë'.¹⁰ Ajo që konvertime të tilla ndodhnin gjatë kësaj periudhe dëshmohet nga disa pasuse në letrat e Bogdanit. Disa elemente të një qasjeje konvertuese vërtet mund të gjenden në tekstin e *Cuneus prophetarum*. Për shembull, në një vend Bogdani shprehet: 'Më mirë të jesh një i krishterë, bir i një turku, se të jesh një turk, i biri i një të krishteri'.¹¹ (Si gjithnjë në shkrimet e krishtera të kësaj periudhe, 'turk' këtu përdoret në kuptimin 'mysliman'.) Dhe pikërisht në faqen e fundit të punimit, ai ngulmon se ndonëse personi i papagëzuar i cili e ka kaluar një jetë përsosmërisht të virtytshme do të shkojë në Limb, dhe jo në Ferr, dhe në këtë mënyrë nuk do të vuaj ndonjë dënim të mirëfilltë, e njëjta nuk vlen edhe për myslimanin, 'ndonëse nuk ka bërë kurrë vepër të keqe, po t'i bëjë edhe të gjitha të mirat e botës'. Natyrisht, është e vështirë të bëhet ndonjë ndarje e qartë këtu midis argumenteve të përpiluara për t'i dekurajuar të krishterët të konvertohen në Islamizëm, dhe argumenteve që e synojnë inkurajimin e myslimanëve për t'u konvertuar në Krishterim: qasjet defensive dhe ofensive, në praktikë rëndom do të përfundojnë duke i paraqitur të njëjtat argumente. Megjithatë, është një fakt i habitshëm që libri i Bogdanit nuk e përcjell strukturën e teksteve standarde anti-myslimane, të cilat argumentimet e tyre rëndom i rregullonin në katër kategori kryesore: një mbrojtje e autenticitetit të Biblës së Krishterë, një paraqitje e doktrinës së Trinisë, një paraqitje e doktrinës të karakterit hyjnor të Krishtit, dhe, përfundimisht, një denoncim i jetës së Muhamedit dhe i doktrinave të Islamizmit.¹² Libri i Bogdanit nuk është i organizuar në këtë mënyrë polemike: rregullimi i tij thelbësor është ai i një paraqitjeje të doktrinës së krishterë lexuesve të krishterë. Në këtë pikë do të doja ta parashtroj një sugjestionim paksa spekulativ për mënyrat në të cilat teksti i Bogdanit mund të ketë ndryshuar gjatë rreth një dekade para botimit të tij. Ashtu siç e thashë, teksti për herë të parë përmendet në verë të vitit 1675, kur Bogdani kërkoi leje për ta shtypur atë dhe e mori përgjigjen që autoritetet duhet që së pari ta shihnin atë në përkthim në italisht. Pas kthimit të tij në Shkodër, më vonë gjatë atij viti, Bogdani njoftoi se ishte duke punuar shumë në përkthimin në italisht.¹³ Për ta kryer këtë punë mund të kenë mjaftuar mbase disa muaj, apo madje edhe një vit a dy;

prapëseprapë, u nevojitën tetë vite para se versioni i plotë i librit, edhe në shqip edhe në italisht, të ishin të gatshëm. (Materialet hyrëse të *Cuneus prophetarum* e përfshijnë pohimin nga xhaxhai i autorit, Ndre Bogdani, që ai i kishte lexuar dhe krahasuar tekstet në shqip dhe italisht më 1683.)¹⁴ Kjo e sugjeron që, gjatë atyre viteve, Bogdani nuk ishte vetëm duke përkthyer, por edhe duke i shtuar mjaft punimit të tij. Referimet e tij të hershme në të (në letrat e tij të vitit 1676) atë e përshkruajnë si 'Jeta e Krishtit Shpëtimtarit'; kjo mund ta sugjerojë që teksti origjinal i korrespondonte kryesisht asaj që, në versionin e shtypur, u shndërrua në pjesën e dytë të punimit, 'De vita Iesu Christi salvatoris mundi' - 'Mbi Jetën e Jezu Krishtit, Shpëtimtarit të Botës'.¹⁵ Shumë nga pasuset që e përmbajnë prozën më të gjallë përshkruese dhe rrëfyese të Bogdanit gjenden në këtë pjesë të dytë të *Cuneus* - për shembull, pasusi dramatik në të cilin Bogdani e përfytyron Marinë duke dalë nga Tempulli në Jerusalem dhe duke e parë në largësi turmën e cila e përcillte të birin e saj të gozhduar në kryq.¹⁶ Këto ishin teknika predikuese, mjete stilistike që shfrytëzoheshin nga predikuesit për ta ruajtur vëmendjen e dëgjuesve të tyre; prandaj, do të doja të sugjeroj që 'Jeta e Krishtit' e Bogdanit, e para nga pjesët nga të cilat u ndërtua *Cuneus*, ishte e sajuar deri në një masë nga materialet e predikimeve të cilat ai vite me radhë ia mbante grigjës së tij. Prandaj, në trajtën e vet më të hershme, *Cuneus* e përfaqësonte mësimin që një pastor i krishterë ia jepte bashkësisë së vet të krishterë. Është e vështirë të thuhet se a përbëhej 'Flavissae prophetarum' vetëm nga ajo që tash e kemi si pjesën e dytë të *Cuneus*, apo mos ndoshta tashmë kishte edhe elemente në zanafillë të pjesës së parë. Nëse ka qenë ndonjë pjesë paraprake, atëherë do të sugjeroja që gjatë pjesës së vonë të viteve 1670 dhe heret në të 1680-at, kjo u zgjerua në mënyrë të konsiderueshme, duke u shndërruar në fund në pjesën e parë të *Cuneus prophetarum*. Dhe mund të jetë që ishte gjatë këtij procesi të zgjerimit të tekstit të tij, kur Bogdani shtoi më tepër material që ishte relevant për mospajtimet e tij me Islamizmin. Kështu, pikërisht pas 'ligjëratës' së parë të pjesës I të *Cuneus*, i gjejmë dy ligjërata të rëndësishme për doktrinën e Trinisë - temë kjo që ishte një nga katër kategoritë bazike të traktateve të krishtera anti-myslimane të kësaj periudhe.

Ideja që argumentimet kundër Islamizmit u rritën për nga rëndësia pasi që Bogdani tashmë e kishte shkruar versionin origjinal të tekstit

të tij përkrahet po ashtu nga dëshmitë e letrave të tij të vitit 1675, në të cilat ai e kërkonte një kopje të përkthimit trevëllimësh të Biblës në arabisht të cilin Propaganda Fide e kishte përkthyer kohët e fundit. Në njërën nga to, të shkruar në fundin e vitit 1675, ai thirrej në përkthimin e 'Flavissae prophetarum' në italisht, duke thënë, 'tërë kohën jam duke punuar shumë në të', dhe më pastaj vazhdon: 'Dhe për shkak se, me qëllim që t'i prapësojmë të pafetë më tërësisht, është plotësisht e domosdoshme t'i kemi tekstet për profecitë në arabisht, me përlje e lus Kongregacionin e Shenjtë [de Propaganda Fide] të jetë aq bujar që të ma japë Biblën arabishte; do të jetë po ashtu e dobishme në diskutimet paqësore, që myslimanët janë duke u mësuar gjithnjë e më tepër t'i kenë me mua lidhur me çështjet e fesë'.¹

Megjithatë, edhe pse Bogdani e kërkoj këtë Bibël arabishte, dhe, edhe pse pasuse të saj në fund u shtypën në Cuneus prophetarum, duhet të dyshohet nëse ai vetë e kishte ndonjë njohje të arabishtes. Në një letër të vitit 1674 ai shkruante se do të ishte në gjendje të argumentonte kundër Islamizmit 'në turqishte dhe ilirishte [d.m.th. serbo-kroatishte]; po ashtu, di të lexoj dhe të shkruaj në shkrimin e fundit [d.m.th. serbo-kroatishte], dhe veç kësaj, jam në gjendje ta flas të parën [d.m.th. turqishten] fare mirë'.¹⁸ Kjo e lë të kuptohet që ndonëse dinte të fliste turqisht, ai nuk dinte ta lexonte apo ta shkruante atë - me fjalë të tjera, ai kurrë nuk e kishte zotëruar shkrimin arabisht.¹⁹ Komentimet e bëra për Islamizmin në Cuneus prophetarum gjithsesi sugjerojnë që Bogdani asnjëherë nuk e kishte lexuar Kuranin. Njohja e tij e tërësishtme e Islamizmit, në të vërtetë, duket të ketë qenë mjaft e turbullt, dhe kjo në dukje ishte e përfutur nga një kombinim i burimeve të shtypura, të shkruara nga teologët e krishterë dhe i informatave gojore nga informatorët lokalë, disa nga të cilët i kishte kuptuar gabimisht. Gabimi i tij më themelor, pohimi që myslimanët 'e adhurojnë' Muhamedin, ishte natyrisht një gabim i përbashkët për të gjithë shkrimtarët e krishterë të kohës.²⁰ Por ai po ashtu e bëri pohimin e çuditshëm që myslimanët dhe çifutët 'ndiqen idhujt: Muhamedin, Surullahin e Talmudin', dhe në këtë pjesë të tekstit italisht ai Muhamedin, Surullahin e Talmudin i përshkroi si tre 'hereziarkë', udhëheqës të sekteve heretike.²¹ Më vonë, në tekst, duke e dhënë një listë të vargut të individëve më të dalluar që e kishin persekutuar Krishterimin, ai përsëri i dha emrat e Muhamedit dhe të Surullahut.²² Shpjegimi më me gjasë për këtë emër enigmatik është

që ky është një shtrembërim i shprehjes arabishte 'Sirr Ullah', 'Sekreti i Zotit' - një shprehje kjo e përdorur për Aliun, dhëndrin e profetit sipas shkrimeve bektashiare.²³ Këtu mbase e kemi një detaj që Bogdani e mblodhi nga bisedat e tij me myslimanët lokalë; mirëpo duket që ai fare pak e kuptonte atë që i ishte kallëzuar. Besoj që njohja e Bogdanit e Islamizmit vinte kryesisht nga shkrimet e teologëve të krishterë. Në veçanti dy tekste mund të identifikohen burime që u përdorën nga ai. Më 1651 ai kërkoi nga Propaganda Fide t'ia dërgonte një kopje të 'Apologia pro Christiana Religione': ky ishte një traktat anti-mysliman i botuar më 1631 nga dijetari italian Filippo Guadagnoli, i cili ligjëronte në vetë Kolegjin e Propaganda Fides.²⁴ Dhe në një letër të vitit 1674, duke i diskutuar bisedat e tij me myslimanët lokalë, Bogdani shkroi që 'kundër Kur'anit, në shumë pika, unë i shfrytëzoj etërit Malvasia dhe Guadagnoli': 'Malvasia' këtu ishte një prift tjetër italian, Bonaventura Malvasia, i cili më 1628 e kishte botuar një traktat të ngjashëm anti-mysliman, të titulluar Dilucidatio speculi. 5 Në Cuneus prophetarum mund të gjenden disa gjurmë të ndikimit të të dy shkrimtarëve. Për shembull, Guadagnoli e kritikon pohimin e qartë në Kur'an që kur Dielli perëndon, ai zbret në një burim apo pellg të ujit (shprehja që ai e përdor është 'një burim të ujit të valë'). Ai e tall këtë ide, duke e vënë në dukje që Dielli duhet të jetë një trup qiellor i vendosur prapa Hënës, meqë përndryshe nuk do të mund ta kalonte eklipsin.²⁶ Bogdani, ngjashëm, e sulmon idenë që Dielli e kalon natën në 'një krua shumë të nxehtë me ujë', dhe paraqet shpjegime, me diagrame, të eklipsit të Diellit dhe të Hënës. Edhe më e rëndësishme, i tërë shqyrtimi i Bogdanit i natyrës së Trinisë duket të jetë i ndikuar fuqishëm nga shkrimet e Guadagnolit dhe Malvasias. Që të dy këta shkrimtarë e paraqitën një mbrojtje filozofike të Trinisë, duke argumentuar që kjo vijoi medoemos nga vetë-kuptimi dhe vetë-dashuria e Zotit, dhe duke shfrytëzuar analogji të nxjerra nga intelekti njerëzor; Bogdani e bën të njëjtën, duke shfrytëzuar analogjinë e kujtesës, intelektit dhe vullnetit (të shfrytëzuar nga Guadagnoli) dhe duke e shtuar analogjinë e Diellit, dritës dhe nxehtësisë së tij (të shfrytëzuar nga Malvasia).²⁸ Malvasia e vuri po ashtu një theks të fuqishëm në pasuset në Dhjatën e Vjetër që dukej ta përmendnin Trininë (për shembull, shprehjet e përsëritura në formë të trefishtë, të tilla si 'Shenjtëri, shenjtëri, shenjtëri'); një pjesë e madhe e këtij materiali po ashtu shfaqet në 'ligjëratën' e tretë të Cuneus prophetarum. Malvasia dhe Guadagnoli nuk citohen në

mënyrë eksplicite në tekstin e librit të Bogdanit. Në të vërtetë, këtu përmenden vetëm dy autorë të shekullit shtatëmbëdhjetë. Njëri është teologu italian, Gioseffo Ciantes, i cili citohet si autoritet për pohimin se shkrimtarë të ndryshëm rabinikë e kishin pranuar doktrinën e Trinisë. Punimi i përmendur këtu është *De sanctissima trinitate* i Ciantesë, një traktat i vogël në pesë kapituj, i botuar në Romë, më 1667: Bogdani huazon material nga kapitulli i parë, dhe e përmbledh të dytin dhe të tretin.³⁰ Ciantes, një dominikan nga Roma, ishte i famshëm për konvertimin e çifutëve në krishterim, gjatë periudhës së tij si 'katekist' i çifutëve në atë qytet (1624-40); pas periudhës si peshkop në Italinë e jugut, ai pjesën e fundit të jetës së tij (midis viteve 1656 dhe 1670) e kaloi në Romë duke ia kushtuar veten përsëri konvertimit të çifutëve - detyrë kjo të cilës libri i tij i vogël ishte menduar t'i shërbejë.³¹ Shkrimtari tjetër është teologu françeskan portugez, Francisco Macedo, *Scholae theologiae positivae* (Romë, 1664) e të cilit citohet nga Bogdani lidhur me temat e Ferrit, Limbit dhe Purgatorit.³² Macedo shërbeu profesor i Teologjisë Kontraverse (d.m.th. ai tip i teologjisë që merret me argumentimin kundër të pafeve dhe përçarësve) në Kolegjin e Propaganda Fide në Romë midis viteve 1656 dhe 1667; ai më pastaj kaloi në Padova, ku u bë profesor i Filozofisë Morale, dhe ku vdiq më 1681.³³ *Scholae theologiae positivae* e tij përfshinte sulme kundër luteranëve dhe kalvinistëve, mirëpo caku i tij kryesor ishte Kisha Greke. Duke e patur parasysh natyrën e lidhjeve të afërta të vetë Bogdanit me Propaganda Fide, duket shumë e mundshme që ai ishte njohur me Macedon gjatë njërës nga vizitat e tij në Romë (më 1660 apo 1665). Në të vërtetë, është po ashtu e mundshme që ai mund ta ketë takuar Ciantesin në Romë gjatë atyre vizitave. Bogdani, me aq sa dimë, nuk ishte aktiv në konvertimin e çifutëve në Krishterim, mirëpo ai pa dyshim e kuptonte që disa nga argumentet që mund të përdreshin për bindjen e çifutëve do të mund të përdreshin edhe te myslimanët. Duhet po ashtu të jetë domethënëse që më 1683, Propaganda Fide ia dërgoi Bogdanit (me sa duket me kërkesë të tij) një kopje të një libri tjetër të përgatitur për konvertimin e çifutëve: *Via della fede mostrata a 'gli ebrei* të Giulio Morosinit, që ishte shtypur në Romë po atë vit nga vetë Propaganda Fide.³⁴ Ky tekst përmbajtësor ishte shkruar nga një çifut venedikas i cili ishte konvertuar në Krishterim dhe kishte kaluar në Romë; në Parathënie për Lexuesit, Morosini shkroi që ai i kishte kaluar gjashtë

vite në punimin e librit të tij, dhe që ai e kishte patur një ndihmë pothuaj ditore nga Giovanni Pastrizio, Ligjërues i Teologjisë Dogmatike në Kolegjin e Propaganda Fides.³⁵ Ky ishte një referim në teologun dalmat dhe dijetarin çifut Ivan Pastric, një anëtar me ndikim i Propaganda Fide dhe njëri nga udhëheqësit e bashkësisë 'ilirike' në Romë.³⁶ Vëllai i tij, Jeronim Pastric (Girolamo Pastrizio), ishte meshtar i San Girolamo degli Illirici, kishës së kësaj bashkësie, dhe shok i afërt i Pjetër Bogdanit; letra në të cilën Bogdani falënderohej për kopjen e librit të Morosinit ishte e adresuar për Jeronim Pastricin, dhe në fund të letrës ai po ashtu kërkonte nga Jeronimi t'ia përcillte përshëndetjet e tij të përlura vëllait të tij Ivanit, 'patronit tim më të dashur'.³⁷ Nga ky grup i vogël, por i rëndësishëm i emrave, fillon të shfaqet diçka si një kontekst intelektual dhe fetar i zhvillimit të punimit të Bogdanit. Temë e përbashkët është konvertimi: Macedo synonte t'i konvertonte ortodoksët; Ciantes dhe Morosini punonin për t'i konvertuar çifutët; Ivan Pastric e përkrahte po ashtu këtë projekt. Bogdani mund t'i ketë njohur të gjithë këta njerëz personalisht. Gjatë vizitave të tij në Romë, institucioni qendror kah i cili kthehej ishte Propaganda Fide (ku punonte Pastrici); në Kolegjin e këtij institucioni ligjëronin edhe Malvasia edhe Guadagnoli, dhe është mjaft e mundshme që Bogdani ta kishte hasur Guadagnolin aty gjatë viteve të tij studentore. Propaganda Fide në fakt ishte themeluar me qëllim të dyfishtë: t'i mbante bashkësitë ekzistuese katolike në territoret që sundoheshin nga fuqitë jo-katolike, dhe të fitonte të konvertuar të rinj në Katolicizëm.³⁸ Mirëpo edhe pse, në shumicën e aspekteve praktike (dhe gjithsesi nga aspekti numerik) i pari ishte shumë më i rëndësishëm se i dyti, ishte qëllimi i dytë - konvertimi - ai i cili i mbërthente imagjinimet e atyre që punonin për Propaganda Fide, dhe e mbizotëronte etikën dhe mentalitetin e këtij institucioni. Pra edhe pse qëllimi kryesor i vetë Bogdanit ishte ta mësonte dhe ta mbronte vetë grigjën e vet, nuk është për t'u befasuar që ai duhet të ketë qenë i ndikuar, deri në një masë, nga entuziazmi i konvertimeve që ekzistonte në institucionin të cilit ai i nënshtrohej gjatë tërë karrierës së tij. Nëse kjo është e vërtetë për botën e Propaganda Fides, të cilën Bogdani duhet ta ketë hasur gjatë vizitave të tij në Romë, kjo është edhe më e vërtetë për qarkun e Kardinalit Gregorio Barbarigo në Padova, ku Cuneus prophetarum u shtyp së fundi. Ky prelat energjik, i cili ishte peshkop i Padovës nga viti 1664 deri në vdekjen e tij më 1697,

kishte lidhje të fuqishme me Romën, pasi që kishte studiuar atje si i ri; dhe pikërisht në Romë, në vitin 1665, Bogdani u njoh me të.³⁹ Familja e Barbarigos (një nga familjet fisnike të Venedikut) kishte interesa në Dalmaci; ai ishte emëruar 'Mbrotjtës i Kombit Ilir' më 1663, dhe e mbajti një letërkëmbim të gjatë dhe tejet miqësor me Ivan Pastricin.⁴⁰ Mirëpo energjitë intelektuale dhe fetare të Barbarigos ishin të orientuara, jo vetëm kah tokat 'ilire', por në të gjitha territoret në të cilat, qoftë Ortodoksia Lindore, qoftë Islamizmi, e luanin ndonjë rol: sepse, ai e kishte obsesion projektin e konvertimit, qoftë të grekëve apo të turqve, ose, veç kësaj, të çifutëve. Seminari ekzistues në Padova gradualisht u transformua nga ai, gjatë viteve 1670 dhe pjesës së hershme të atyre 1680, në një institucion kryesor të projektuar, jo vetëm për përgatitjen e priftërinjve lokalë, por po ashtu edhe për ushtrimin e misionarëve.⁴¹ Me inkurajimin e Papatit, ai aty e fliti studimin e gjuhëve orientale (hebraishtes, arabishtes, turqishtes dhe persishtes); synimi i tij, shkruante, ishte t'i ushtronte priftërinjtë ta predikojnë besimin katolik 'kudo që të mund të dërgohen nga Selia e Shenjtë dhe Kongregacioni de Propaganda Fide'.² Vetë Barbarigo ishte bërë anëtar i Kongregacionit de Propaganda Fide më 1678.⁴³ Dhe, ashtu siç Propaganda Fide e kishte shtypshkronjën e vet në të cilën ajo i prodhonte materialet misionare në shumë gjuhë dhe shkrime të huaja, Barbarigo e zhvilloi një 'Stamparia' në Seminarin e vet në Padova, duke bërë përpjekje (dhe shpenzime) të mëdha për t'i siguruar, apo prodhuar, shkronjat e greqishtes, hebraishtes, arabishtes dhe të gjuhëve të tjera.⁴⁴ Qëllimi i tij nuk ishte t'i bëhej rival Propaganda Fides, por ta ndihmonte atë - dhe ajo, më tutje, me kënaqësi i ndihmoi atij, duke ia dërguar matricat e shkronjave greke nga rezervat e veta.⁴⁵ Prandaj, nuk ka asgjë të keqe apo të dyshimtë në faktin që libri i Bogdanit u shtyp nga shtypshkronja e Seminarit në Padova, në vend se nga Propaganda Fide në Romë. Nuk ka arsye të supozohet që Bogdani në këtë mënyrë ishte duke i shpëtuar ndonjë lloji të kritikizmit apo censure nga autoritetet romane (ashtu siç Injac Zamputi një herë e pat sugjeruar); fakti që ata fillimisht kërkuan ta lexojnë tekstin në përkthimin italisht para se ta lejonin atë ishte përsosmërisht i natyrshëm, meqë vështirë se do të mund të pritej që ata do ta lejonin një punim të cilin nuk e kishin lexuar.⁴⁶ Me gjasë, duke i patur parasysh kërkesat e shumta nga shtypshkronja e vetë Propaganda Fides, autoritetet në Romë ishin të lumtur që ky punim i

konsiderueshëm ishte marrë nga duart e tyre. Dhe kardinali Barbarigo me gjasë ishte po ashtu i lumtur që këtë ta merrte vetë, meqë ky vinte në kohën kur ai e kishte siguruar një grumbull shkronjash orientale, të cilat priste me padurim t'i përdorte. *Cuneus prophetarum* u shndërrua në të vërtetë në një botim për vitrinë të shtypit padovas: ky ishte libri i parë në të cilin padovasi e demonstroi aftësinë e tyre për të shtypur në një mori shkrimesh orientale. Afër fundit të pjesës së dytë të librit, ata e përfshinë një grumbull profecish për Krishtin që me krenari përshkruheshin të ishin në 'tetë gjuhë': latinisht, greqisht, italisht, shqip, hebraisht, arabisht, armenisht dhe siriakisht.

Dhe, në fund të librit, ata e përfshinë edhe një dhënie tabelare të alfabeteve të gjuhëve të panjohura me udhëzime për shqiptimin.⁴⁸ Edhe pse disa dijetarë bashkëkohorë në bazë të kësaj kanë supozuar që vetë Bogdani e kishte një njohuri të siriakishtes dhe armenishtes, nuk ka argumente të tjera që e dëshmojnë këtë pohim; më parë duket që punimi i tij ka qenë i shfrytëzuar për qëllime të vetë-reklamimit të shtypit padovas. Në të vërtetë, deri në një masë e njëjta mund të jetë e vërtetë për shtypin në librin e tij të civateve nga Dhiata e Vjetër në hebraishte dhe në arabishte: ky ishte, tekefundit, botimi i parë në të cilin padovasi i përdorën shkronjat arabishte të siguruara rishtas.⁴⁹ Siç e pamë, është mjaft e dyshimtë nëse Bogdani ishte në gjendje të lexonte arabisht fare. Lidhur me hebraishten, ai mund të ketë patur një njohuri themelore të gjuhës. Është e mundshme që ai ta ketë mësuar pak si student, dhe komentimet e herëpashershme mbi etimologjinë e emrave hebraikë mund të jenë dëshmi të një farë njohjeje të gjuhës (ndonëse këto mund të jenë marrë nga punime dytësore); mirëpo përshkrimi i tij i 'Talmudit' si një 'idhull' dhe 'hereziark', dhe referimi i tij në 'Bereshit Raba, dijetar hebraik' (Bereshit Rabba është, në fakt, emër i një teksti, jo i një personi), e bëjnë të duket me fare pak gjasë që ai ishte një dijetar hebraik.⁵⁰ Kur Bogdani i shkroi Sekretarit të Kongregacionit de Propaganda Fide në Nëntor 1685, pasi që libri ishte shtypur, ai njoftoi që 'profecitë janë dhënë po ashtu në arabishte dhe hebraishte, për hir të dy kombeve të jobesimtarëve'; mirëpo, duke e patur parasysh mungesën e çfarëdo përmendjeje të konvertimit të çifutëve në raportet e Bogdanit nga tokat veriore shqiptare, mund të supozojmë se ai vetëm shkonte krahas synimit konvertues që ishte imponuar në libër nga miku dhe patroni i tij padovas.⁵¹ Libri i tij, deri në një masë, ishte marrë.

Shqyrtime të ngjashme mund të ndihmojnë për të shpjeguar pse ky libër, që fillimisht ishte menduar si diçka që do të mund të qarkullonte në mesin e një popullate të varfëruar në tokat shqiptare, në fakt u prodhua si një libër i bukur i formatit të madh: përsëri, qëllimet vetë-reklamuese të Seminarit ishin të parat. Natyrisht, si edhe çdo autor, Bogdani mund të ketë qenë i kënaqur ta shohë punimin e tij të prodhuar aq bukur; dhe në një mënyrë ai ishte në gjendje t'i shfrytëzonte këto rrethana, duke i futur disa ilustrime me madhësinë e faqes së plotë. Në njërin nga to ishin të vizatuara (siç e tha në letrën e tij Sekretarit të Propaganda Fides) Profetet 'të veshura në stilin shqiptar dhe serb, me qëllim që t'i inkurajoj këta njerëz të gjorë dhe t'i ngushëlloj sa më mirë që të mundem'.⁵² Mirëpo, duhet përkujtuar sa kopje të këtij libri arritën në tokat veriore shqiptare. Është e vërtetë që Bogdani njoftoi, në një letër dërguar Propaganda Fides nga Venediku në janar 1686, se 'dëshira ime më e madhe dhe më e zjarrtë është ta marr me vete në Kishën time, ashtu që tekstet e Besimit të Shenjtë të mund të shpërndahen sa më larg të jetë e mundshme në mesin e atyre njerëzve'.⁵³ Mirëpo, dy muaj më herët ai e kishte informuar Sekretarin e Propaganda Fides që një libërshites në Venedik e kishte shprehur dëshirën t'i blinte të gjitha kopjet e librit.⁵⁴ Edhe pse shtypi padovas asnjëherë nuk ishte menduar si një ndërmarrje tregtare, shkalla deri në të cilën shpenzimet e tij tejte të mëdha duhej të ndihmoheshin financiarisht nga fondet e dioqezës u shndërrua vrullshëm në një problem për Barbarigon.⁵⁵ Bogdani, që ishte fare mirë i vetëdijshëm për falënderimin që ia kishte borxh kardinalit, ofertën e libërshitesit e përshkroi si një 'mrekulli' dhe tha se ishte i sigurt që kjo do ta kënaqte shtypshkronjën.⁵⁶ Ai nuk e emërtoi libërshitesin; mirëpo kandidati më bindës është libërshitesit Girolamo Albrizzi, i cili e ribotoi librin e Bogdanit në Venedik, më 1691. Ky rëndom është përshkruar si një botim i ri apo një shtyp i ri; mirëpo përshkrimet e tilla janë jo të sakta. Ky ishte vetëm një ribotim, duke e përdorur një rezervë të të njëjtave fleta të shtypura që ishin prodhuar në Padova, më 1685. Më 1691 Albrizzi e shtypi një ballinë të re (duke e quajtur librin *L'Infallible verita della cattolica fede*); ai po ashtu e shtypi një letër përkushtuese të veten për kardinalin Francesco Maria de' Medici, dhe e la jashtë pjesën më të madhe të materialeve hyrëse që ishin të përfshira në botimin origjinal.⁵⁷ Më 1702 Albrizzi e ribotoi librin, duke i përdorur përsëri fletat nga shtypi i parë, me ballinën që e kishte datën e re dhe pa

letrën përkushtuese. Larg nga ajo që të ishin dy botime të reja që do të mund të ishin dëshmi e shitjes së suksesshme të librit, këto ribotime janë dëshmi që një rezervë e madhe e kopjeve (të palidhura) të shtypit të parë kishin mbetur të pashitura, në Venedik. Kështu duket sikur oferta e libërshitesit më 1685, si është përmendur nga Bogdani, ishte pranuar. Sikur shtypi në Padova të mos kishte shpenzuar aq shumë kohë dhe të holla duke e prodhuar një produkt aq luksoz, Bogdani mund të mos ishte ndjerë nën një obligim të tillë që të lejonte që kopjet të shiteshin ashtu që të shpaguheshin disa nga shpenzimet; prandaj, në mënyrë paradoksale, vendimi i Barbarigos që ta merrte shtypjen e këtij libri - që Bogdanit duhej t'i ishte dukur si një fat i mrekullueshëm - siguroi që, në fund, fare pak kopje t'u shkonin njerëzve për të cilët ai vërtet ishte menduar. Dëshmi të tjera për mënyrat në të cilat projekti i Bogdanit u mor nga kërkesat dhe aspiratat e Barbarigos mund të gjenden në materialet hyrëse të shtypura në botimin e vitit 1685. Këtu është e domosdoshme të mbahet në mend, jo vetëm entuziazmi i përgjithshëm i Kardinalit për konvertimin e 'të pafeve', por po ashtu ndjenja e një pritjeje të zjarrtë me të cilën ai e ndiqte zhvillimin e luftës Habsburgo-Otomane pas vitit 1683. Ai i studioi raportet e lajmeve të luftës me një interesim të madh, dhe vetë korrespondenca e tij ishte përplot me referime në të.⁵⁸ Pas mposhtjes së otomanëve në Vjenë, ai i shkruante Dukës së Madh Cosimo III të Tuskanit që shpresonte se Meshja së shpejti do të kremtohej përsëri në Aja Sofia në Konstantinopojë; dhe në verën e vitit 1648 ai pohoi që 'unë gjithnjë kam besuar se marrja e Konstantinopojës është jashtë mase e lehtë dhe jashtë mase e realizueshme'.⁵⁹ Ai besonte që një pushtim i tillë ishte vërtet i afërt, dhe ai ishte në kontakt me shumë njerëz që e kishin të përbashkët këtë besim. Njëri ishte një françeskan nga Loraini, 'Nicolo Arnu' (Nicolas Arnoux, apo Harnoux), i cili e ligjëronte metafizikën në Universitetin e Padovas; një nga gjërat e para që u shtypën nga shtypshkronja e Seminarit ishte një libër i vogël në të cilin Amu i dha interpretimet e veta të një vargu të profecive (kryesisht biblike, por që po ashtu i përfshinin edhe një profeci turke dhe një orakull profetik) duke demonstruar se si Venediku dhe aleatët e tij ishin afër pushtimit të Perandorisë Otomane.⁶⁰ Një person tjetër i tillë ishte Marco d'Aviano, një kapuçin karizmatik; kur d'Aviano ishte në Austri më 1686 Barbarigo kishte letërkëmbim me të, pasi që, me gjasë, ishte njoftuar

me të në Padova, më 1682.⁶¹ Besimi entuziast në fitore të tilla të aferta në luftën Habsburgo-Otomane, natyrisht që mbartte me vete disa implikime politike, si dhe disa fetare: Barbarigo ishte fuqishëm në favor të Lidhjes së Shenjtë, e cila dukej t'i kishte tejkaluar armiqësitë e vjetra midis Vjenës dhe Venedikut, dhe midis Venedikut dhe Romës. Më 1689 d'Aviano do ta përshkruante Barbarigon si besnik ndaj Perandorit; dhe dy vite më vonë d'Avianos ju kishte qasur një peshkop që dëshironte të bënte fushatë që Barbarigoja të bëhej Papë i ardhshëm, në bazë të asaj që ai do t'ua jepte austriakëve përkrahjen e plotë të papatit.⁶²

Parashikimet e qarkut të Barbarigos për fitore të plotë kundër otomanëve munden madje t'i shpjegojnë disa nga tiparet e tjera enigmatike të librit të Bogdanit. Është e mundshme që ai ka qenë i inkurajuar të përfshinte kritika të singerta të Islamizmit, të një lloji që kanë mund të marrin dënime të ashpra nga autoritetet otomane, duke u mbështetur në atë që brenda një kohe të shkurtër ato nuk do të ekzistonin edhe më tutje. Dhe është e mundshme që formati i madh i librit ishte përgatitur po ashtu duke e patur ndër mend skenarin e fitores: një herë pasi që Ballkani të jetë pushtuar, nuk do të ketë edhe më tutje ndonjë nevojë për kontrabandim të fshehtë të vëllimeve të vogla. Ato linja të shpjegimit janë, medoemos, spekulative. Mirëpo, të paktën, mund të thuhet me siguri më të madhe, që zjarri i qarkut të Barbarigos, dhe entuziazmi i tij i veçantë për përpjekjen luftarake të Habsburgut, e ofron kontekstin për disa nga gjërat e shtypura në materialet hyrëse të *Cuneus prophetarum*. Këto përfshijnë, për shembull, një vjershë në serbo-kroatishte nga 'Pettar Riceiardi' (Petar Ricardi), të shkruar në Vjenë; Ricardi, që me prejardhje ishte nga Dubrovniku, ishte bërë komandant i regjimentit kroat në ushtrinë austriake.⁶³ Kjo vinte me një vjershë të shkurtër latine nga Pavao Ritter Vitezović, një shok dhe adhurues i Ricardit i cili i ishte bashkuar regjimentit të Ricardit, më 1683.⁶⁴ Njëri nga kontributet më të gjata ishte një vjershë në italisht nga Dr Silvestro Antonii, i cili ishte Drejtori i parë i shtypshkronjës së Seminarit në Padova: e tërë vjersha ishte mbi shkatërrimin e afert të Perandorisë Otomane, dhe konvertimin e të gjithë myslimanëve, përmbushjen e të cilit libri i Bogdanit do ta ndihmonte. 'Në fund,' Antonii e thoshte me zë të lartë, 'gjysmëhëna do të kthehet në kryq, xhamitë jobesimtare do të kthehen në kisha, dhe sarajet në manastire.'⁶⁵ Përsëri fitohet përshtypja që qëllimet

konvertuese, që për vetë Bogdanin kishin qenë, më së shumti konsiderata dytësore, nga ata rreth tij janë ngritur në qëllimin kryesor të librit. Kjo ligjëratë solli prova që Pjetër Bogdani kishte filluar me një grumbull mjaft të ndryshëm prioritetesh, dhe se zhvillimi i tekstit të tij, nga plani i tij i parë e deri në botimin e shtypur përfundimtar, ishte proces që ndodhi nën lloje të ndryshme të ndikimit apo shtypjes, edhe intelektuale, edhe fetare (dhe, madje, politike). Megjithatë, është e qartë se njëri ndër elementet e projektit të tij fillestar (edhe pse, besoj, vetëm një element shtesë) ishte përpjekja për t'i konvertuar myslimanët në Krishtërim; ashtu siç shkroi më 1675, ai shpresonte të bënte 'konvertime të panumërta të myslimanëve malësorë'.⁶⁶ Në përfundim, do të doja vetëm t'i shtoj disa komente të shkurtra për mënyrën në të cilën ai i qasej kësaj detyre. Shprehjen që këtu e theksova 'myslimanëve malësorë' ishte Turchi montagnoli'; mirëpo mund të vërehet që në disa vende në *Cuneus prophetarum* Bogdani thjesht i referohet 'malësorëve tanë' ('i nostri montagnoli' në versionin italisht). Kështu në një vend ai shkruante 'për të pajtuar mendimet e malësorëve tanë për atë çka thonë epijureijt dhe makiavelistët'; në një vend tjetër ai i lavdëronte 'malësorët tanë' për shëndetin dhe fuqinë fizike të cilën ata e merrnin nga mënyra e tyre e thjeshtë e jetës.⁷ Është e mundshme që fjala e tij 'tanë' këtu i tregon të krishterët në krahasim me myslimanët; mirëpo mënyra e jetës, natyrisht, ishte e përbashkët për të dyja palët. Në paraqitjen e tij të teologjisë së krishterë ai e theksonte që Jezuja u kishte dhënë ndihmë paganëve, njësoj si dhe çifutëve, dhe që mesazhi i krishterë ishte në këtë mënyrë përfshirës, jo përjashtues.⁶⁸ Ai e theksonte po ashtu që disa nga të vërtetat themelore të teologjisë janë krijuar nga paganët (për shembull, nga grekët e lashtë).⁶⁹ Dhe ai jepte një vëmendje të veçantë profetëve, që kishin marrë pjesë në zbulesën profetike të krishterë edhe pse këto vetë nuk ishin të krishtera. Në të gjitha këto mënyra, ai përpiqej ta ndërtonte argumentin e vet, jo përmes denoncimit të feve të tjera, por përmes dëshmimit të fushave të përbashkëta midis të krishterëve dhe jo-të-krishterëve - në veçanti aty ku ishte çështja e malësorëve të tij të dashur. Megjithatë, argumentet kryesore të librit ishin të vëna, jo në nivelin e qenieve njerëzore si të tilla, por në nivelin e atyre qenieve njerëzore që e pranonin trashëgiminë e përbashkët të zbulesës profetike. Me fjalë të tjera, Bogdani e kishte në mendje, ato që i merrte të ishin supozimet e

përbashkëta të të krishterëve dhe të myslimanëve (dhe çifutëve). Metoda e tij kryesore e argumentimit e përfshinte kërkimin e profecive. Ai e dinte që shumë nga figurat e Dhiatës së Vjetër përmbaheshin po ashtu në besimin islamik: në një vend ai i përmend myslimanët që thirreshin në shembujt e Abrahamit, Davidit dhe Solomonit.⁷ Si shumë shkrimtarë të krishterë të kësaj periudhe, duket se ai kishte besuar që i tërë teksti i Dhiatës së Vjetër ishte pranuar disi si i vlefshëm nga myslimanët, dhe se detyra e teologut të krishterë ishte që ata të bindeshin që Dhiata e Vjetër, e interpretuar drejt, shpie kah Krishterimi dhe jo kah Islamizmi. Argumenti i tij ishte detyrimisht anti-islamik, meqë, si një i krishterë, ai e mohonte që Muhamedi ishte profeti i vërtetë. Mirëpo, në të njëjtën kohë, ai ishte duke e strukturuar argumentimin e tij në një asi mënyre për të cilën shpresonte se do të ishte e pranueshme për myslimanët - duke e përdorur idenë e përbashkët të profecisë, dhe duke u thirrur në trashëgiminë e përbashkët të dy feve abrahamike. Në këtë mënyrë, argumenti nga profecia, të cilin ai e përpiloi para së gjithash për t'i siguruar sërish lexuesit e krishterë dhe për ta forcuar besimin e tyre, mund të përdorej po ashtu për t'i sjellë në atë besim ata 'malësorët myslimanë' për të cilët, duket, Pjetër Bogdani asnjëherë nuk i pushoi lutjet e veta.

FUQIA E FJALËS SË SHKRUAR

Nikollë Berishaj

Apo tri raste konkrete nga letërsia jonë: Migjeni, Vaso Pasha dhe Fishta

Gjithmonë, e veçanërisht në raste kritike të historisë së një kombi provohet të bëhet njëfarë uniteti, qoftë ai i vërtetë apo i rrejshëm. Në ato raste opinioni publik është i kthyer në atë drejtim që ta miratojë orjentimin e përgjithshëm të kombit. Natyrisht, garnitura udhëheqëse e kombit, garnitura në pushtet, mbledh rreth vetes papagallë që vend e pa vend i përsërisin frazat “e pranuar” nga të gjithë. E krejtë makineria propagandistike është e drejtuar në prodhimin e klisheve zi e bardhë, pa nuanca, pa shije dhe pa elementa, që medoemos duhej të gjendeshin diku ndërmjet.

Intelektualët, kryesisht ata “kokëfortit”, që nuk e pranojnë lojalitetin e pakusht ndaj “idesë udhëheqëse”, kanë mundësi t’i zgjedhin alternativat: ose të futën në lëvozhgën e arrës, duke pritur kohën e vet, e atëherë të paraqiten qoftë edhe me memoare; ose në anën tjetër të luftojnë luftën donkishotiane kundër mullinjve të erës.

Të dy këto alternativa i kanë anët e veta, si pozitive, ashtu edhe negative:

- E para i ofron intelektualit qetësi e paqe fizike, e atëherë atë në jetën e rrethit të ngushtë, që deri atëherë ishte për të, ndoshta, tejet e ulët; e në anën tjetër vetë rrethi e akuzon si frikacak, gjë që është e barabartë me diagnozën e vdekjes intelektuale klinike.

- E dyta ka si pasojë të kundërtën. Ai vetë gjen qetësi intelektuale, shpirtërore e morale, i bindur se popullit po ia tregon rrugën më të mirë, rrugën e vetme afatgjate, por në anën tjetër vështirësohet rruga e tij jetësore fizike, sepse kundërshtarët e mësuar në “mendjemprehtësinë” aktuale “bardhë-zi” e akuzojnë për tradhtar, janë të gatshëm edhe për inkuizicion klasik në turmën e druve. Sepse, ‘ai është shkatërrues i idilës së njëmendësisë së tërësishme’. Ai i takon

anës së kundërt, ai është “spiun”, “i paguar”, “i shitur”, ai është...

Në fund, pasi të kalojë furtuna, pozita e tyre është sërish duale.

I pari mundohet të përfitojë nga rasti, duke trumbetuar se “qëndrimet e pastra i kishte që në fillim”. Mundohet të bëhet edhe më rrënjësor për ta treguar pastërtinë e tij.

I dyti, në shumicën e rasteve fizikisht i rraskapitur nuk ka më as forcë as vullnet të eksponohet, mbetet përsëri kritik i përditshmërisë.

Kryesisht, më së shumti ka asish që deri në momentin e fundit janë në anë të drejtë (me partinë në pushtet), për të kaluar përsëri në momentin e fundit në anën e drejtë (me partinë e re në pushtet).

Nëse të gjitha këto ndodhin në kohëra disi më normale, nuk çojnë peshë aq të madhe, mbeten të shkruara, por me kohë opinionin publik i tejkalon (të mos themi i harron) ato.

Me raste të tilla është e mbushur plot e përplot historia dhe letërsia jonë kombëtare, por edhe aktualiteti ynë shqiptar.

Interes të posaçëm për këtë shkrim zgjojnë intelektualët e tipit të dytë. Ata që nuk heshtin as nuk e lëmojnë pushtetin. Mënyra se si e shprehin ata një kundërshtim me njëmendësinë aktuale e cakton edhe pozitën e tyre të mëvonshme, qoftë edhe pas vdekjes.

T'i marrim tri raste konkrete, të njohura në letërsinë tonë, për ta shpjeguar tërë këtë mozaik. Ta tërheqim një paralele midis poemës “O moj Shqypni” të Vaso Pashës, “Legjendës së misrit” të Migjenit dhe satirës “Metamorphosis” të Atë Gjergj Fishtës. Me qëllim po i ballafaqojmë këto të tri krijime artistike, ngase e qesin në pah më së miri idenë tonë.

Përderisa Migjeni në mes të pasqyrës ideale të malësorit (...shembull i pamposhtmërisë, rezistencës, nderit...) dhe dukjes reale të tij (...qenie pakurrizore që numëron të rrahurat e kamxhikut duke u përkulur para përfaqësuesit të pushtetit për një gjysmë thesi misër) zgjedh këtë të dytën, duke e gjetur edhe shkakun për këtë (goja e uritur e fëmijëve që presin bukë).

Ai aspak nuk dyshon se shkrimi i tij do të keqkuptohet, pa marrë parasysh se një shkrim i tillë e shkatërron paragjykimin ideal të formuar në opinion për malësorin, si në komb ashtu edhe jashtë tij. Është kjo gjë njerëzore e kuptueshme prej të gjithëve. E pra, Migjeni na çfaqet aty si heretik i pashoq ndaj “religjionit kombëtar”! E pra, Migjeni si heretik then pasqyrën ideale “të dhënë nga Zoti”, sepse

“shqiptari s’është i tillë”! E pra, Migjeni si heretik duhet djegur në turmën e druve. Ai, jo vetëm se nuk e beson idealen, por edhe e zhveshë atë cullak, e shkatërron dhe e lufton atë me çdo qelizë të intelektit të vet.

Për fat, Migjeni mbetet i gjallë me shkrimet e veta!

Ndërkaq, Vaso Pasha shkon edhe më tutje. E përgjithëson idenë e Migjenit me tezën “Shqiptarë, sot s’ka shqiptarë!...” E pse, pra Vaso Pasha mbetet në piedestali, ku e vendos vetë kritika letrare?

Pse nuk çohën të gjithë shqiptarët ta dënojnë atë për akuzën - shpifjen që bëri? A thua me këtë nuk e meritoi zgjimin e ndjenjës neroniane të shqiptarët, që ta ndezin turmën e druve nën autorin e kryqëzuar?

Përgjithësimi i la të fjetura ndjenjat individuale, sepse, si duket, asnjëri personalisht nuk e gjet veten drejtpërdrejt të akuzuar. Në vend të klithjeve “vdekje autorit!” u dëgjuan dhe dëgjohen “rroftë autori!”

Dhe, mirë që autori mbetet në vendin e merituar!

Shumë intelektualë dhe “intelektualë” të sotëm me Atë Gjergj Fishtën u takuan tepër vonë, por një thënie të tij e kanë të ngulitur si thumb në trurin e tyre. Thumb ky që nxit shumë pyetje, shpesh pa përgjigje. Shumë dyshime të pashpjegueshme janë të lidhura me vargjet e tij aq shpesh të parafrazuara “*le ta dijë tan bota mbar / se un mâ nuk jam shqiptar*”.

Nuk jam i denjë, e as që kam nevojë ta mproj Fishtën dhe atdhetarizmin e tij, por dëshiroj ta jap një vështrim timin lidhur me satirën Metamorphosis, në të cilën gjenden këto vargje!

Ndoshta do të ishin shpjegim i mjaftueshëm i veprës së tij “Anzat e Parnasit” dhe satirës në fjalë, që është pjesë e veprës, dy moto që i zgjedh vetë autori:

“*Qeshem për punë të njerzvet veç pse s’muaj me kja*” për veprën, dhe “*Tros Tyriusue mihi nullo discrimine habentur*”, për satirën. Apo ndoshta do të ishte shpjegim i mjaftueshëm vetë definicioni: “**Satirë-a** f. (lat. Satira, satura – përzierje) 1. ironi e hidhur, therëse e fshikulluese, qëndrim që shpreh një ironi të tillë; 2. lit. Vepër letrare ose shkrim që fshikullon të metat, veset dhe anët e dobëta të njerëzve dhe të shoqërisë”. Mikel Ndreca, Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve të huaja, Prishtinë 1986, 624.

E si vjen zemërimi i brendshëm i Fishtës në atë stadium, që t’i “pështyjë” në letër këto fjalë? A thua se Homeri i shqiptarizmës iu

nënshtrua ndikimit të fuqive antikombëtare dhe u bë sahanlëpirës i tyre?

Nëse e pranojmë tezën se me citate të shkëputura edhe Biblën mund ta paraqesim si libër heretik, do të mund të përgjigjemi pozitivisht në këtë pyetje. Ja vargjet që do të mund të ishin pikënisje për një shtjellim të tillë:

*"Se vjershtarët sa janë n'këtë jetë
Gjithmonë luftë kanë me kuletë!"*

Por Fishta si mjeshtër i vargut dhe si kolos i mendimit që është, nuk e lejon asnjë dyshim. Jo veç se satirën e vet të shkruar më 1907 e fillon me moton e Virgjilit që përmendëm, por në strofën e parë të tij anatemon kohën në të cilën jeton, si dhe rrethin e tij:

*"Qe besa, or burra
Nuk dij kah t'çajë
Mbasi do t'thirret
Sot derri dajë..."*

Nuk e cekëm kot vitin e lindjes së satirës. Ishte viti kur Fishta gjindej gati në kulmin e veprimtarisë së tij atdhetare në përgatitjen e alfabetit gjithëkombëtar shqip. Kundërthëniet, që i paraqet duke krahasuar veten, që dirgjet *"për atme të vet"* duke u *"kacagjelue"* me armiq të Shqipërisë, me disa të tjerë që:

*"... për dhé t'parvet
S'u bjen ndërmend
Me sa për kpurdha
Qi bijnë n'dervend"*

Janë aq të parafytyrueshme, sa që lexuesit i duket se është vetë i thurur në vargje.

Me cinizëm, që është karakteristik vetëm për intelektualët e rangut më të lartë, Fishta godet *"kujdesin"* e shoqërisë për pishtarët e kulturës dhe të kombit, por njëkohësisht ajo shoqëri i dhuron ata:

*"që me i gut'n Morgen
A kalimera
Me i dobra veçer
A Buona sera"*

*Të gjitha punët
U shkojnë për filli
E edhe morrizi
U çelë drandafili*

Të gjitha këto i di Fishta, e mu për këtë edhe më tepër eksplodon pranë varreve që s'kanë ndryshim në epitaf, përveç, ndoshta në pamje të jashtme. Pasi poetët e atdhetarët tërë jetën e shkrinë për "Atme" nuk u mbet asgjë për rrasë të varrit, kurse atyre që "u lodhën prej vjamit" e që ndërruan jetë "për sherr të Adamit", në rrasë të varrit, me shkronja të arta u shkruan epitafe shokët e tyre:

*"Ktu njaj fatbardhi
Ësht tue pushue
Për Fé e për Atme
Qi pat jetue"*

Fishta këtë dukuri e përgjithëson edhe më skajshmërisht. Duke i parë të gjitha që ndodhin në Shqipëri, me ironi e cinizëm pyet:

*"A thue është vorri
Bash i Spartanvet
Qi n Thermopila
Banë ball Persjanvet?..."*

Pas të gjith këtyre, Poeti shpërthen:

*"Ta dijë Shqypnija
Pra e sheklli mbarë
Se mâ mbas sodit
Un s'jam shqyptar"*

Dhe për këtë thënie Fishta edhe sot akuzohet, pa marrë parasysh se kjo është satirë, pa marrë parasysh shtjellimin e shkëlqyeshëm që i bën thënies paraprakisht, pa marrë parasysh veprimtarinë e tij të atëbotshme dhe të mëvonshme, si dhe vlerat artistike – atdhetare të kësaj dhe veprave të tjera të tij.

Për vargjet në poezinë Gjuha shqipe:

“Pra mallkue njaj bir shqyptarit

qi këtë gjuhë të përëndisë

trashigim të lanë prej s’parit

trashigim qi s’i le fmisë...”

ai çohet në pedestal, por gjithmonë pa ia harrua (më mirë duke ia përkujtua) mëkatin mortor të ‘*moskënit shqyptar*’.

E ç’dallim kanë në thelb novela e Migjenit, poema e Vaso Pashës dhe satira e Fishtës, përpos gjinive të ndryshme letrare të cilave u takojnë.

Shikuar nga këndvështrimi i kuantitetit, thënia e Fishtës “*se un mâ nuk jam shqyptar...*” është e nivelit më të ulët. Ai e “bën” vetëm vetvetën “*joshqiptar*”. Migjeni e zgjeron akuzën, duke i “nënçmuar” malësorët, kurse Vaso Pasha e përgjithëson në krejtë shqiptarët – krejtë kombin “*shqiptarë, sot s’ka shqiptarë...*”. Por, siç thamë, lexuesi ia “merr për të madhe” vetëm Fishtës.

Nëse këtë e analizojmë psikologjikisht dallimi qendron tjetërkund: konkretizimi ka peshë më të madhe se përgjithësimi.

Konkludim logjik që del nga kjo analizë:

Veta e tretë e njënësit (*malësori i Migjenit*) dhe veta e tretë e shumësit (*joshqiptarët e Vaso Pashës*) nuk prekim askënd individualisht, ngase çdo përgjithësim ka përjashtime (kështu secili malësor, e për analogji me të, secili shqiptar ia bën vendin vetes në anën e kundërt të prototipit migjenian, gjegjësisht të atij të Vaso Pashës me qendrimin “*kjo nuk vlen për mua dhe mirë po ua bën atyre të tjerëve*”, është, pra, vetëm inspirim letrar i autorit).

Në anën tjetër, veta e parë e Fishtës (“*Un s’jam shqyptar...*”), pa marrë parasysh ironinë e plotë satirike të autorit në vetë psikën e lexuesit konkretizon diçka si dyshim, si pyetje, si diçka të pasqarueshme. Duket si heqje e perdes përmbi shtresat më të thella të ndërdijes të secilit prej nesh, që e bën të mundshme të zbulohet e vërteta. Deshte s’deshte, thënia mbetet më e ngulitur në tru. E veçanërisht nëse ajo thënie duhet recituar publikisht!

Duhet pranuar edhe ana tjetër, ajo e kundërta. Edhe sikur Fishte ta kishte shprehur këtë qendrim me tërë seriozitetin e *ratios*, do të duhej nderuar karakteri i tij si dhe guximi ta shpallë atë, e jo më ta qesë në letër. Në fund të fundit *Scripta manent*. E shkruara, pra, mbetet për të gjitha kohërat dhe për të gjithë lexuesit.

Elife Luzha – Dedaj

MIKESHA IME SLOVENE

(shoqes time te ngushte)

Qete qete me shtrinë dorën
Me bene pritje miqësore
Si motër me puth ne faqe
Me pamje gazmore

Mikesha ime sllovene
Sa here e takoj
Me rrit dashuri ne zemër
Vuajtjet mi lehtëson

Tre fëmijët e saj
Si tre pëllumba rreth meje rrinë
Kur unë flas me mall
Pe fëmijët e vendit tim

Herë i ngrehin vetullat
Herë t'vretur si retë rrinë
Bëhen sikur dëgjojnë
Përrallat e xhaxhit Grime

Dhe mikesha ime sllovene
Fshin lotët nder faqe
Bene lutje për fëmijët
Ben lutje për paqe

NGJYRAT E DASHURISË

Sikur te mundja te ngjyrosja dashuri
C' ngjyre do te jepja se di fare
Ngjyre vuajtje e trishtimi
Shume te rrinë
Por unë gjithsesi
Do te jepja tjetër fare

BIRI IM VIOLINIST (djalit Arbrit)

Dore e vockël me hark ne violine
Luan notat e Moxartit
Tek Shogeni ndjen gjallërinë
Biri im kur luan sonatën.

Ne salle ndihet arome muzike
Biri im me shpirt artisti
Kur luan vallen e Mazurkës
Paganin te këput shpirtin

Luan biri kosovar
N'vend te huaj s'ndjen shqetesim
Është një note për te tanë
Me duartrokitje merr shpërblim

Dhe urimet si mungojnë
Artistit t'vogel nga Kosova
Biri im si Paganin
Lavdi shpërndanë trojeve tona

NARODNA IN UNIVERZITETNA KNJIŽNICA

403 668/2006



920064505,2

COBISS 0

